

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7620 E martë 14 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**

**F**jala reformë, në çdo fushë, përfshi edhe atë të drejtësisë, përdoret si sinonim i fjalës "përmirësim", d.m.th nëse flasim për reformë në drejtësi kemi parasysh...

Vijon në faqen 21

Nga ELVIS ZAIMI

Vetingu, shëmtia dhe rimëkëmbja e drejtësisë shqiptare



**Opinion** **Ditës**

Nga PËRPARIM KABO

Qyteti dhe shëndeti publik...

Sepse më është fiksuar një fakt që dua ta them. Duke lexuar mbi jetën e një laboristi të shquar, anglezit Gordon Brawn, ish-ministrit të Financave dhe ish-kryeministrit... Vijon në faqen 20-21



Flet diplomatja Suela Janina: Interesat e Bashkimit Europian

## Negociatat, ambasadorja e Shqipërisë pranë BE-së: S'ka vend për zhgënjim. Ja lëvizjet diplomatike

"Në fund të muajit, Rama mbledh në Durrës kryeministrat e rajonit"

Nga DARINA TANUSHI

Ambasadorja e Shqipërisë pranë Bashkimit Europian, Suela Janina mendon se, "ndonëse një vendim për hapjen e menjëhershme të negociatave do të mund të na kishte gëzuar më shumë jo vetëm ne, por edhe 25..."

**FATOS MALAJ: KATEGORITE QE MUND TE PERFITOJNE**




**Ndërmjetësi në Drejtorinë e Emigracionit: Shtyhet atati i aplikimeve për nënshtetësinë greke**

Në faqen 10

## BANESAT E NDERTUARA PARA VITIT 1991, APLIKIMI PER PRONESINE NIS NE SHTATOR

# TAPI PER 60 MIJE SHTEPI, DOKUMENTET E PROCEDURÁ

Qeveria miraton vendimin për të zhblokuar ngërçin e pronësisë. Përfshihen në proces dhe banesat në lagjet mesjetare të qyteteve...



(Në foto) Foto ilustruese

**MASAKRA E SELENICES**

Lihet në burg autori, Rama: Ndodhi të tilla ekstreme ndodhin kudo. Tushi: Si ndalohe

Në faqen 6-7

**ISH-KRYEMINISTRI**

Frymëzohet nga Rumania, Berisha: Revolucion popullor, në shtator përmbysim narkoshtetit

Në faqen 4

**KOMPENSIMI**

Buxheti, 15 mld lekë për pronarët, 5 mijë përfitues në të gjithë Shqipërinë, lista e IV

Në faqen 18-19

**SUMMERPAGES**

Enris Qinami: I jam falënderues Zotit, ja si e kanë pritur muzikën me sharki

Suplement

## Ngjarja e 10 gushtit, viktima u akuzua për vrasjen e Kurmemajt në 2011-ën

# "Ekzekutimi i kunatit të Lul Kullës nga vrasës me pagesë"

Policia: Në atentatin ndaj Fatbardh Licit morën pjesë 3 persona, rolet

**SHKODËR** - Pak ditë pas atentatit të ndodhur në lagjen "Guerrile" të Shkodrës, ku mbeti i vrarë me 15 plumba automatiku Fatbardh Lici, policia ka zbar-dhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen e rëndë që tronditi banorët e këtij qyteti. Burime pranë grupit hetimor dje bënë



me dije se në ekzekutimin e 53-vjeçarit dyshohet se janë përfshirë tre persona. Bëhet fjalë për atentatorin dhe dy bashkëpunëtorë të tij. Sipas hetuesve të çështjes, dyshohet se autorët e ngjarjes së rëndë të ndodhur në orët e para të mëngjesit të së premtes...

Në faqen 9

## NEGOCIATAT INTERVISTA

Suela Janina "zbulon" lëvizjet diplomatike të qeverisë deri në qershor 2019

# Negociatat, ambasadorja e Shqipërisë pranë BE-së: Nuk ka vend për zhgënjim

Në fund të muajit, Rama mbledh kryeministrat e rajonit

Darina Tanushi

**A**mbasadorja e Shqipërisë pranë Bashkimit Europian, Suela Janina mendon se, "ndonëse një vendim për hapjen e menjëhershme të negociatave do të mund të na kishte gëzuar më shumë jo vetëm ne, por edhe 25 vendet anëtare që e kërkuan me bindje këtë hap, nuk ka vend për zhgënjim në vendimmarrjen e qershorit të Këshillit Europian". Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Janina shprehet: "Muajt në vijim do të jenë mjaft të rëndësishëm, ne tashmë po hyjmë në një fazë që sa më përpara të ecim, aq më kërkuese dhe e vështirë do të jetë lëvizja, por që pa dyshim është një udhëtim që ia vlen çdo përpjekje". Ajo zbulon edhe projektet apo lëvizjet diplomatike që do të fillojnë në muajt në vijim, me qëllimin final që qeveria shqiptare t'i mbushë mendjen Brukselit se e meriton hapjen e negociatave. Ambasadorja shqiptare në Bruksel tha se Shqipëria është dhe do të jetë proaktive edhe në axhendën rajonale. Për këtë pritet do të ketë një takim të kryeministrave të rajonit në fund të këtij muaji, të organizuar për herë të dytë radhazi nga kryeministri Rama, ku do të jetë i pranishëm edhe komisioneri Hahn. Ndërkohë, "gatë muajt shtator një projekt zhvillimi për një nga zonat natyrore më të bukura të rajonit, atë të Prespës, do të jetë në fokus të bashkëpunimit ndërmjet tri vendeve që prek liqeni i Prespës dhe Komisionit Europian, për t'i dhënë një dimension të ri zhvillimit të qëndrueshëm, ekoturizmit dhe përpunimit ekonomik të kësaj zone".

**Znj.ambasadore, ky ka qenë një vit i vështirë sa i përket lobimit për çeljen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian.**

Është e vërtetë që ky vit ka qenë veçanërisht intensiv për arritjen e objektivit të hapjes së negociatave të anëtarësimit me BE. Në fillim të vitit, aksioni ynë diplomatik u përqendrua në marrjen e rekomandimit të pakushtëzuar nga Komisioni Europian, i cili konfirmoi me publikimin e strategjisë së zgjerimit në prill se vendi ynë i ka përmbyshur kushtet për fillimin e bisedimeve dhe më tej me vendet anëtare për mbështetjen e këtij rekomandimi dhe marrjen e vendimit politik për fillimin e negociatave. Ndonëse një vendim për hapjen e menjëhershme të negociatave do të mund të na kishte gëzuar më shumë jo vetëm ne, por edhe 25 vendet anëtare që e kërkuan me bindje këtë hap, nuk ka

vend për zhgënjim në vendimmarrjen e qershorit të Këshillit Europian. Ky vendim ka shumë elementë pozitivë, që ne duhet t'i shfrytë-

### REFORMIMI

Diskutimi për reformimin e BE nuk është një temë e re, ajo e ka bashkëshoqëruar rritjen e BE prej vitesh. Pranohet gjerësisht se, që BE të jetë më e fortë, më e qëndrueshme ndaj sfidave të shumta të kohëve tona, kërkesave të qytetarëve të saj dhe një aktor global, duhet të reformohet, ndonëse mënyrat, mjetet dhe fotografitë e BE-së të së ardhmes ende nuk është e qartë.

zgjurmë deri në qershorin e vitit të ardhshëm për të mbërritur në vendimin përfundimtar për uljen në tryezën e bisedimeve. Referuar edhe precedentëve të mëparshëm me vendet e anëtarësuar së fundmi dhe të atyre që aktualisht po negociojnë, vendimmarrja me hapja të ndërmjetmë nuk është një strategji e re, që aplikohet për herë të parë në rastin tonë dhe të Maqedonisë. Dinamika e zhvillimeve të brendshme të BE dhe debatet për të ardhmen e saj

### ANËTARËSIMI

"Ne e kemi të qartë se sot nuk jemi gati për anëtarësim, por kemi nevojë për një strategji të qartë të BE-së për të përgatitur vendet tona për anëtarësim. Në këtë debat ne duhet të jemi të gatshëm të provojmë se anëtarësimi i vendeve të rajonit nuk do ta dobësojë BE. Ne duhet të kapërcejmë perceptimin e të qenit pjesë e problemit, por të kontribuojmë për të qenë pjesë e zgjidhjes", u shpreh ambasadorja në Bruksel.

disa muaj para zhvillimit të zgjedhjeve europiane nuk favorizuan mesazhe më kurajozë për zgjerimin. Në një analizë profesionale, përtej emocioneve politike, unë mendoj se vendimi i Këshillit është vendimi më pozitiv që mund të merrnim në kushtet aktuale. Këshilli mbështeti me shënime inkurajuese progresin e ev-



it është e qartë se muajt në sistemin e kohëmatjes së këtij procesi janë ditë, prandaj ne nuk kemi luksin të kemi zhgënjime, por duhet të ndjemi të inkurajuar që muajt në vijim t'i shfrytëzojmë maksimalisht për të intensifikuar ritmin e reformave në drejtimet e evidencuara në vendimin e qershorit dhe për të organizuar strukturat negociuese që kjo kohë të na gjejë të përgatitur në mënyrën më të mirë për të filluar fazën impenjuese të bisedimeve të anëtarësimit.

**A ka qenë për ju e vështirë kjo periudhë lobimi, e cila realisht nuk ka përfunduar, por do të vijojë edhe në këto muaj deri në qershor vitin që vjen?**

Posti diplomatik në Bruksel për vetë specifikat e punës që mbulon ka një ngarkesë të veçantë dhe në prag të vendimeve të rëndësishme është normale që ritmi i punës të intensifikohet përtej të zakonshmes. Ka pasur edhe raste kur përveç ngarkesës fizike të orëve të zgjatura të punës, të jemi përballur edhe me sfida jo të lehta, por që falë punës së stafit tim në Bruksel dhe mbështetjes së drejtuesve të MEPJ dhe kolegëve në Tiranë, kemi arritur bashkë-

risht t'i kapërcejmë vështirësitë dhe të synojmë të bëjmë më të mirën për përfundimin e vendit. Muajt në vijim do të jenë mjaft të rëndësishëm, ne tashmë po hyjmë në një fazë që sa më përpara të ecim, aq më kërkuese dhe e vështirë do të jetë lëvizja, por që pa dyshim është një udhëtim që ia vlen çdo përpjekje.

**Tashmë është çelur edhe procesi i "screening". Si do të vijojnë kontaktet me Bruksel dhe qeverisë shqiptare në këtë fazë?**

Pas hapjes zyrtare të këtij procesi në Tiranë në 17 korrik, kontaktet intensive politike do të vijojnë ndërmjet Tiranës dhe Brukselit, por dhe me kryeqytetet e vendeve anëtare. Në planin teknik axhenda është konkrete, në bashkëpunim me strukturat e Komisionit Europian, po përgatisim kalendarin e takimeve shpjeguese për çdo kapitull të acquisit komunitare. Fillimisht do të nisët ky proces me kapitujt më të rëndësishëm 23 dhe 24, që prekin parimet e shtetit të së drejtës dhe sezoni i ri në shtator do të fillojë me parqitjen e legjislatonit të BE në këtë fushë për ekspertët tanë. Po ashtu, do të vazhdojë bashkëpunimi me BE në kuadër të instrumenteve ekzistues të procesit të stabilizimit asociimit; do të zhvillohen sipas planifikimit nënkomitetet në fusha të ndryshme, ecuria e të cilëve krahas procesit "screening", do të përforcojë përgatitjen tonë për të përfunduar vendin me standardet europiane në çdo fushë. Përveç aspekteve teknik, që mbase



Diplomatja e Shqipërisë në Bruksel: Dekorimi nga Rama, surprizë e bukur

# Janina: BE ska interes të kthejë vendet e Ballkanit në "vend parkimi" për refugjatët

"Duhet të provojmë se anëtarësimi i rajonit nuk do e dobësojë BE"

ynë në përbalimin e sfidave të përbashkëta është jo vetëm shprehje e detyrimeve tona, por edhe pasqyrim i vlerave më të mira që ne përfaqësojmë dhe me të cilat do të investohemi si anëtarë të ardhshëm të këtij Bashkimi të bazuar në solidaritetet dhe unitet.

**Ju e dini shumë mirë mendimin jo fort entuziast të disa vendeve të BE, në mënyrë të veçantë të presidentit francez, Macron, kundër zgjerimit të Unionit. A mendoni se në këtë situatë do të ketë një votë "pro" Shqipërisë vitin që vjen, pavarësisht realizimit apo jo të detyrave të ngarkuara?**

Në fakt, diskutimi për reformimin e BE nuk është një temë e re, ajo e ka bashkëshprehur rritjen e BE prej vitehesh. Pranohet gjerësisht se, që BE të jetë më e fortë, më e qëndrueshme ndaj sfidave të shumta të kohëve tona, kërkesave të qytetarëve të saj dhe një aktor global, duhet të reformohet, ndonëse mënyrat, mjetet dhe fotografiat e BE-së të së ardhmes ende nuk është e qartë. Ne, ndonëse nuk jemi ndikues aktivë në këto diskutime, i ndjekim me interes, sidomos në pjesën që na ndikon drejtpërdrejt: reforma e BE dhe zgjerimi, për të cilën presidenti Macron paraqiti qëndrimin e tij para Samitit të Sofjes. Në gjykimin tonë, reformimi i BE dhe reformimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor mund të ecin krahas për krahas, ato nuk kanë pse të përjash-



Ambasadorja e Shqipërisë pranë Bashkimit Europian, Suela Janina dhe ministri Ditmir Bushati

## SHQIPTARËT NË BELGJIKË

"Komuniteti shqiptar në Belgjikë është ndër komunitetet më të mëdha që kemi në Europë. Ai numëron rreth 60.000 shqiptarë të vendosur në këtë vend mikpritës prej fundit të viteve '50 dhe në vijim pas viteve '90. Ky komunitet është i mirëintegruar në shoqërinë belge dhe në tërësi gëzon respekt, me gjithë disa fenomene negative që vitet e fundit janë zbehur falë edhe një bashkëpunimi në rritje të agjencive ligjzbatuese të të dy vendeve tona", u shpreh ambasadorja Janina.

qënit pjesë e problemit, por të kontribuojmë për të qenë pjesë e zgjidhjes. Entuziazmi ynë për të qenë pjesë e këtij Bashkimi, me gjithë vështirësitë që kalon, është një element frymëzimi për të ardhmen e BE-së, si i vetmi projekt i suksesshëm paqejë e përparimi në kontinentin tonë. Unë besoj se pas zgjedhjeve europiane në gershor, ky debat do të ketë marrë një drejtim pozitiv dhe interesi i vetë BE për të konsoliduar sigurinë dhe stabilitetin e saj me rajonin tonë do të jetë gjerësisht i pranueshëm.

**Pas vendimit të Këshillit të Punëve të Përgjithshme të Këshillit Europian. Ajo çfarë vlerësoj më shumë është mesazhi i inkurajimit që na u përcoll se ka ardhur koha që puna të vlerësohet", tha Janina për nderimin që iu bë nga kryeministri, pas vendimit të BE.**

vendimit të Këshillit Europian. Ajo çfarë vlerësoj më shumë është mesazhi i inkurajimit që na u përcoll se ka ardhur koha që puna të vlerësohet dhe ndonëse aty u përmendën katër ambasadorë, unë besoj se ishte një mesazh pozitiv për të gjithë shërbimin e jashtëm, i cili ka fituar më shumë respekt dhe dinjitet për punën që bën në shërbim të vendit. Personalisht jam njaft mirënjohëse për këtë moment të veçantë, por edhe për të gjithë mbështetjen që kam pasur gjatë kryerjes së detyrës time. Të shërbesh për vendin dhe ta përfaqësosh atë në kryeqendret e Evropës është një privilegj i veçantë, për mua kjo shkon përtej detyrës, është një kontribut sado modest, që përpiqem ta jap për të ardhmen tonë në BE, pasi në këtë rrugë shikoj një të ardhme më të mirë për fëmijët e mi dhe brezin e tyre në vendin tonë.

**Znj. Janina, në Belgjikë jetojnë e punojnë shumë shqiptarë? Cili është opinioni i përgjithshëm për ta atje?**

Komuniteti shqiptar në Belgjikë është ndër komunitetet më të mëdha që kemi në Europë, ai numëron rreth 60.000 shqiptarë të vendosur në këtë vend mikpritës prej fundit të viteve '50 dhe në vijim pas viteve '90. Ky komunitet është i mirëintegruar në sho-

qërinë belge dhe në tërësi gëzon respekt, me gjithë disa fenomene negative që vitet e fundit janë zbehur falë edhe një bashkëpunimi në rritje të agjencive ligjzbatuese të dyja vendeve tona. Treguesi më konkret i aktivizimit të komunitetit shqiptar është edhe përfshirja e tyre në jetën shoqërore dhe politike të Belgjikës. Këtë vit në tetor zhvillohen zgjedhjet lokale dhe unë jam e inkurajuar të shoh një numër të madh të kandidatëve të tyre për përfaqësim në njësitë lokale dhe shpresoj që ata do ta rrisin në këtë rast praninë e tyre, duke ndikuar jo vetëm në përmirësimin e imazhit të vendit tonë në Belgjikë, por edhe përkrahjen ndaj komunitetit shqiptar. Jashtë çdo formalizmi, kam bindjen se çdo shembull suksesi bën diplomacinë më të mirë të mundshme për vendin tonë dhe pa u ndalur tek emrat e veçantë, Belgjika ka shembuj të tillë të shumtë në çdo fushë të jetës. Së shpejti, edhe me fokusin e veçantë që ka vendosur qeveria për diasporën, do të kemi zhvillime pozitive edhe në Belgjikë, duke e zgjeruar bashkëpunimin e ambasadës me komunitetin dhe forcuar praninë tonë me aktivitete jo vetëm për ruajtjen e identitetit kombëtar, por edhe mirëqenien e komunitetit shqiptar në Belgjikë dhe Luksemburg.

## Diskutimet



### REFUGJATËT

"Përtej diskutimeve tona të brendshme, pozicioni në Bruksel ka qenë i qartë, i përsëritur disa herë nga zyrtarët më të lartë, BE nuk ka asnjë interes të kthejë ndonjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor në "vend parkimi" për refugjatët. Çfarë Ballkanit Perëndimor ka bërë në kohë krizash, duke u shfaqur si partner i besueshëm i BE, është e vlerësuar në Bruksel", nënvizoi Janina.

← nuk do të thotë shumë për qytetarin, është e rëndësishme të përmendim se qëllimi ynë është që t'i japim frymë këtij procesi, që në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndikojmë në përmirësimin e përditshëm, duke inkurajuar dhe mbështetur projektet që kanë të bëjnë me ndërlidhjen, transportin, energjinë, digitalizimin, ekonominë, bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimet ndërmjet qytetarëve të rajonit. Shqipëria është proaktive në të gjithë këtë axhendë rajonale, e cila do të nxitet në një takim të kryeministrit të rajonit në fund të këtij muaji, të organizuar për herë të dytë radhazi nga kryeministri Rama, ku do të jetë i pranishëm edhe komisioneri Hahn. Gjatë muajit shtator një projekt zhvillimi për një nga zonat natyrore më të bukura të rajonit, atë të Prespës, do të jetë në fokus të bashkëpunimit ndërmjet tri vendeve që prek liqeni i Prespës dhe Komisionit Europian, për t'i dhënë një dimension të ri zhvillimit të qëndrueshëm, ekonomik dhe përparimit ekonomik të kësaj zone.

**Ju në fakt keni qenë**

**pjesë e takimeve të zhvilluara mes kryeministrit, ministrit të Jashtëm apo ministrave të tjerë të qeverisë shqiptare me drejtuesit e BE-së, e jo vetëm këtu në Bruksel. A ka pasur një kërkesë që Shqipëria të strehojë refugjatët që vijnë nga Siria?**

Më lejoni t'i jap një përgjigje të drejtpërdrejtë dhe të shkurtër kësaj pyetjeje: jo, në asnjë rast nuk është paraqitur një kërkesë e tillë. Përtej diskutimeve tona të brendshme, pozicioni në Bruksel ka qenë i qartë, i përsëritur disa herë nga zyrtarët më të lartë, BE nuk ka asnjë interes të kthejë ndonjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor në "vend parkimi" për refugjatët. Çfarë Ballkanit Perëndimor ka bërë në kohë krizash, duke u shfaqur si partner i besueshëm i BE, është e vlerësuar në Bruksel. Shqipëria gëzon veçanërisht një imazh mjaft pozitiv për qëndrimet në një linjë me qëndrimet e BE në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe politikës së jashtme. Interesat tona kombëtare përputhen tërësisht me ato të BE dhe në respekt të tyre. Kontributi

### MEDALJA

"Ishte një surprizë e bukur për të katërt ambasadorët, dhënia e medaljes së mirënjohjes nga kryeministri Rama në Tiranë, ku në fakt ishim nisur për të diskutuar mbi hapat e mëtejshme të punës pas vendimit të Këshillit Europian. Ajo çfarë vlerësoj më shumë është mesazhi i inkurajimit që na u përcoll se ka ardhur koha që puna të vlerësohet", tha Janina për nderimin që iu bë nga kryeministri, pas vendimit të BE.

tojnë njëra-tjetrën. Ne e kemi të qartë se sot nuk jemi gati për anëtarësim, por kemi nevojë për një strategji të qartë të BE-së për të përparuar vendet tona për anëtarësim. Në këtë debat ne duhet të jemi të gatshëm të provojmë se anëtarësimi i vendeve të rajonit nuk do ta dobësojë BE, ne duhet të kapërcejmë perceptimin e të

**hme të BE-së, ju u nderuat nga kryeministri Rama për punën që bëtë. Çfarë do të thotë kjo për ju?**

Ishte një surprizë e bukur për të katërt ambasadorët dhe medaljes së mirënjohjes nga kryeministri Rama në Tiranë, ku në fakt ishim nisur për të diskutuar mbi hapat e mëtejshëm të punës pas

# PROTESTAT OPOZITA

Ish-kryeministri frymëzohet nga protestat në Rumani: Gushti rumun dhe shtatori shqiptar

## Berisha: Revolucion popullor, në shtator përmbysim narkoshtetin

"Shqiptarë ngrihuni, shtatori muaj i historisë!"

Valentina Madani

Ish-kryeministri Sali Berisha iu drejtua dje qytetarëve të Shqipërisë në mbarë vendin me një thirrje të fortë për t'u ngritur në protesta deri në rrëzimin e qeverisë "Rama". Berisha i ftoi të gjithë qytetarët shqiptarë të ngrihen në një revolucion mbarëpopullor kundër qeverisë. Ish-kryeministri mori si shembull protestat e zhvilluara këto ditë në Rumani, duke shprehur se, "admirimin dhe solidaritetin më të madh për qytetarët rumunë dhe revolucionin e tyre, ftoj qytetarët shqiptarë të ngrihem edhe ne në një revolucion mbarëpopullor, për të përmbysur narkoshtetin dhe regjimin kleptokratik në Shqipëri". Në postimin e bërë në "Facebook", Berisha bën thirrje që, "ta shndërrojmë në shtatorin që vjen, në shtatorin më të madh të historisë sonë". "Të dashur miq, prej disa ditësh qytetarët rumunë janë ngritur në një revolucion të fuqishëm popullor në Bukuresht dhe mbarë Rumaninë, për përmbysjen e regjimit kleptokratik të majtë. Duke shprehur admirimin dhe solidaritetin tim më të madh për qytetarët rumunë dhe revolucionin e tyre, ftoj qytetarët shqiptarë të ngrihem edhe ne në një revolucion mbarëpopullor, për të përmbysur narkoshtetin dhe regjimin kleptokratik në Shqipëri. Le ta shndërrojmë në shtatorin që vjen, në shtatorin më të madh të historisë sonë", shkruan ish-kryeministri në "Facebook". Po dje, ish-kryeministri Berisha denoncoi se babai 70-vjeçar i Taulant Ballës paguhet 1 milion lekë në muaj, ose 3 herë më shumë se punëtorët të cilët nuk janë në moshë pensioni. Ish-kryeministri Berisha ka publikuar edhe fletë-borderonë e biznesit ku punon Kasem Balla. "Ja sa paguhet në moshën 70-vjeçare babai i dashur i Taulant Toyota Yaris! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital! Përsëritet Dr., po ju dërgoj borderonë e pagës prej 1



ml lekë në muaj tek ECF (fabrika e çimentos) të Kasem Ballës, vjeç 70, babai i Taulant Gjures apo 'Toyota Yaris'. Ai punon tek marketingu i ECF Elbasan, ndërkohë punëtorët jo në moshë pen-

sioni paguhen aty tri herë më pak", thuhet në denoncimin drejtuar z.Berisha. Një tjetër denoncim i bërë po dje nga z.Berisha ishte ai se: "Delvinjotët i varin teneqen Alket Hysenit. E përzënë me bisht

**THIRRJA**  
"Duke shprehur admirimin dhe solidaritetin tim më të madh për qytetarët rumunë dhe revolucionin e tyre, ftoj qytetarët shqiptarë të ngrihem edhe ne, në një revolucion mbarëpopullor, për të përmbysur narkoshtetin dhe regjimin kleptokratik në Shqipëri. Le ta shndërrojmë në shtatorin që vjen, në shtatorin më të madh të historisë sonë", deklaroi z.Berisha.

ndër shalë! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital: Delvina feston me emigrantët, takim brezash, organizuar nga shoqata 'Bashkimi Delvinjot' dhe nga Bashkia Delvine refuzuan dhe deputetin Alket



**NARD NDOKA**

"Na prij Lulzim Basha, që të gjithë të vijmë pas teje. Opozita të fillojë me veten, të mos presim radhën, por të çlirojmë vendin nga 'rilindasit' zgjebarakë dhe të pështirë. Shqiptarët e lënë veten të prekin fundin, por ngrihen dhe të marrin përpara. Unë kam shumë besim se kjo ditë ka ardhur. Zot na ndihmo të gjithëve; qeverinë të ikë, opozitën të ngrihet fuqishëm, qytetarët të ndërjegjësohen për fatet e tyre dhe të vendit!", shprehet kreu i PDK-së.

Hyseni që donte ta përdorte këtë festë për fushatë elektorale. Qyteti i Sulejman Delvinës nuk mund të jetë qyteti i Alket Hysenit, që dy herë e pati pushtetin partia e tij, dy herë e sakatepsi. Pas

'97-ës, Fatos Nano hoqi të gjitha institucionet nga ky qytet dhe në 2013-ën Rilindja e Alketit i hoqi territorin, sa sot ky qytet me histori quhet Delvina e vurgut dhe jo vurgu i Delvinës".

### "Tregu i bixhozit kontrollohet nga Olsi Rama"

## Denoncimi, PD: 500 mln euro dëm buxhetit nga interesat e familjes

Partia Demokratike përmes deputetit Endri Hasa denoncoi dje kontrollin e plotë të familjes Rama mbi tregun e bixhozit në Shqipëri, një biznes i cili gjerëron miliona euro fitime. Deputeti Hasa tha se pas katërfishimit të pikave të plane korruptiv i Edi Ramës për t'i dhënë të vëllait Olsi Rama miliona euro fitime nëpërmjet koncesionit të mbikëqyrjes së lojërave të fatit. Ai iu referua edhe të dhënave të KL.SH-së, sipas së cilës 1940 subjekte kanë ushtruar aktivitetin e tyre në këtë biznes pa licencë, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm prej së paku 500 milionë eurosh. Ai deklaroi se kryeministri Rama shtyn hyrjen në fuqi të ligjit që kompanisë koncesionare të të vëllait, t'i shtohet fitimi. Deputeti demokrat u shpreh se PD do anulohet çdo



ligj selektiv, çdo koncesion monopol dhe do rishikojë ligjin antimafia për sekuestrimin e çdo qindarkë dhe pasurive korruptive. "Edi Rama po e shtyn prej 3 vjetësh hyrjen në fuqi të zbatimit të ligjit për t'i dhënë mundësi bixhozit dhe pikave të basteve të zgjerohen dhe në këtë mënyrë, kompanisë koncesionare të të vëllait t'i shtohet fitimi. Partia Demokratike është e vendosur të anulohet çdo ligj selektiv, çdo kon-

**VENDIMI**  
"PD është e vendosur të anulohet çdo ligj selektiv, çdo koncesion monopol dhe çdo favorizim nga pushteti, që sot qeveris me krimin e organizuar dhe që sipas Departamentit të Shtetit, po pastrojnë paratë edhe nëpërmjet zgjerimit të tregut të bixhozit", tha deputeti Hasa.

cesion monopol dhe çdo favorizim nga pushteti, që sot qeveris me krimin e organizuar dhe që sipas Departamentit të Shtetit, po pastrojnë paratë edhe nëpërmjet zgjerimit të tregut të bixhozit. Rishikimi i ligjit antimafia nga Partia Demokratike do të sigurojë sekuestrimin e çdo qindarkë dhe pasurisë të vënë nëpërmjet krimin të organizuar dhe korupsionit qeveritar të lidhur me të", theksoi z.Hasa.



### Salianji me fermerët: Po paguani më shtrenjtë se vendet e BE, PD do heqë monopolet

Deputeti demokrat, Ervin Salianji akuzoi dje qeverinë se me aktet e saj po godet fermerët, duke i detyruar ata t'i hedhin prodhimet në kanal. Gjatë një takimi me fermerët e Korçës, Salianji u shpreh: "Qeveria është barra më e rëndë për fermerët, ju dëmton në prodhim dhe në shitje. Salianji tha se, "treg nuk ka për produktet, asnjë kompensim për dëme, asnjë subvencion dhe çdo blerje e kanë më shtrenjtë se çdo vend tjetër të rajonit si plehrat kimike, naftën apo farërat. PD do të heqë monopolet dhe do të mbështesë fermerët me subvencione". Në prodhim, fermerët paguajnë çmim më të shtrenjtë se Greqia për plehrat kimike, paguajnë çmime më të shtrenjta për farat, paguajnë çmim më të shtrenjtë për naftën se vendet e BE dhe Maqedonia, çmimi i energjisë dhe taksa e tokës po ashtu e rritur: Gjithçka sepse qeveria favorizon monopolet dhe bizneset e lidhura me të". Sipas tij, "subvencione janë zero për fermerët, ato shkojnë me miliona euro tek klientët e qeverisë. Produkti në shumicën e kohës hidhet nëpër kanale apo kalbet në magazina, sepse askush nuk kujdeset, qeveria i godet fermerët për të mbështetur bizneset e veta të shpërndarjes".

Aplikimi në shtator, banesat e ndërtuara para vitit '91 do të marrin dokumentin e pronësisë

# Tapi për 60 mijë shtëpi, dokumentet dhe procedurat

## Certifikata pronësie për ndërtesat e vjetra

Ornela Manjani

Qeveria ka miratuar një vendim, i cili synon të zhbllokojë ngërçin e pronësisë për banesat e ndërtuara para vitit 1991. Pronarët e shtëpive duhet të nisnin procedurat për pajisjen me tapi në shtator. Janë rreth 60 mijë banesa të ndërtuara para vitit 1991, për të cilat pronarët nuk kanë mundur të marrin dokumentin e pronësisë, duke përfshirë edhe banesat në lagjet mesjetare të qyteteve si Berati, Gjirokastra apo Shkodra. Arsyeja për këtë ngërç ka qenë neglizhenca e institucioneve, mungesa e dokumentacionit nga pronarët, por edhe procedurat burokratike. Duke filluar nga shtatori, të gjithë pronarët e këtyre banesave duhet të aplikojnë për marrjen e pronësisë në sportelet e ALUIZNI-t. Këta qytetarë duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet që zotërojnë dhe më pas e gjithë procedura deri në dhënien e pronësisë do të kryhet nga vetë ALUIZNI.

**VENDIMI**

Personat që kanë ndërtuar para vitit 1991 dhe që nuk kanë dokument pronësie si për ndërtesën, ashtu edhe për truallin do të pajisen me tapi. Janë në total 60 mijë ndërtime në të gjithë vendin që do legalizohen. Pronarët e këtyre ndërtimeve duhet të paraqiten pranë ALUIZNI-t dhe të plotësojnë formularin-tip, i cili publikohet sot në "Gazetën Shqiptare". Këshilli i Ministrave miratoi pak ditë më parë vendimin që i hap rrugë nisjes së procedurave, të cilat do të ndiqen nga ALUIZNI për pajisjen me dokument pronësie të këtyre pronave. Sipas vendimit, mësohet se ndërtimet e ngritura deri më 10.8.1991 dhe trojet funksionale të tyre, për të cilat nuk ka akte të fitimit të pronësisë do të pajisen me tapi. Vetëm nëse për truallin ka dokumentacion pronësie, procedurat e kalimit të pronësisë kryhen vetëm për ndërtesën. Vendimi përcakton se do të konsiderohen objekt i trajtimit të këtij vendimi ato ndërtime: a) të cilave u mungon akti i fitimit të pronësisë; b) të cilat, nga pikëpamja ndërtimore janë të përfunduara, me mure dhe me mbulesë; c) të cilat nuk janë ndërtime pa leje, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të nenit 3, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Ndërsa truall funksional konsiderohet sipërfaqja e tokës nën ndërtesë, së bashku me oborrin përreth saj, që posedohet efektivisht nga subjekti kërkues. Sipas këtij vendimi, ALUIZNI është institucioni i autorizuar për kryerjen e



Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame

**AFATI**

ALUIZNI brenda 10 ditëve nga miratimi i kalimit të pronësisë përcjell vendimin së bashku me genplanin, për regjistrim pranë ZVRPP-së, e cila është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda 10 ditëve nga administrimi i dokumentacionit.

me vendimin nr. 432 datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit". "Ky vendim është aplikuar në atë kohë në masë minimale në disa zona rurale dhe sikurse kuptohet nga vetë titulli, nuk e trajtonte problemin për të gjithë territorin e vendit, por ofronte një zgjidhje të pjesshme vetëm për fshatrat. Më pas është vijuar me VKM 608, datë 05.09.2012, që gjithashtu nuk e ka realizuar dot qëllimin e tij gjatë këtyre gjashtë viteve. Arsyet e dështimit të këtyre dy vendimeve të kaluara lidhen së pari me mungesën e kapaciteteve njerëzore, por në shumë raste edhe të vullnetit, apo neglizhencën e njësisë të qeverisjes vendore, të cilat kanë qenë organet e ngarkuara me kryerjen e këtyre procedurave. Së dyti, për sa i përket VKM nr. 608/2012, shkaqet lidhen edhe me burokratizimin e tepruar të procedurës dhe mbi të gjitha me qasjen jorealiste ndaj problemit", - bëri të ditur kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame, pas miratimit të vendimit.

**APLIKIMI**

Lehtësim i barrës së aplikuesit nga detyrimet dhe dokumentacioni i tepërt, (aplikuesi tanimë do të duhet të paraqesë vetëm kërkesën pranë ALUIZNI-t). Zgjidhja e të gjithë pamundësisë së deritanishme, për të provuar periudhën e ndërtimit (para datës 10.8.1991), gjë që ka penguar finalizimin e procedurës dhe kalimi i pronësisë së truallit të ndërtesës falas deri në 300 metra katrorë, si dhe mundësia për të blerë sipërfaqet mbi këtë masë janë tri risitë që parashikon vendimi. Lame evidentoj se numri i ndërtimeve që mendohet të trajtohen nga ky vendim është 40-60 mijë. "Duket theksuar - tha ai - se asnjëherë nuk është bërë një evidencim i plotë dhe i saktë i këtyre objekteve dhe si rrjedhim, shifra reale mund të jetë edhe më e lartë se ajo e mësipërme. Du muajt në vazhdim do të bëhet organizimi i stafëve dhe si rrjedhim pranë secilës drejtorie rajonale të ALUIZNI-t nga një sektor që do të merret ekskluzivisht me ndjekjen dhe zbatimin e kësaj VKM-je. Gjithashtu, do të përzgjedhim edhe stafet rajonale që do të merren me mbarëvajtjen e këtij procesi.

### Çfarë duhet të bëjnë qytetarët

Duke filluar nga shtatori, të gjithë qytetarët e interesuar për regjistrimin e banesave të tyre të ndërtuara përpara vitit 1991 do të mund të paraqiten pranë sporteleve tona për të aplikuar. Ndërkohë, mund të fillojnë grumbullimi i dokumentacionit për ata që posedojnë leje ndërtimi të vjetra, akte pronësie, skica genplane, akte shitblerjeje apo posedimi, vendime të vjetra të Këshillave Popullore, apo dokumente të tjera provuese të çdo lloji dhe kohe. Zbatimin e këtij vendimi dhe të gjithë procedurën përkatëse, qeveria ia ngarkoi ALUIZNI-t, qoftë për shkak të rrjetit ekzistues të punonjëses në terren, qoftë për shkak të eksperiencës operative dhe teknike të akumuluar nga ana e specialistëve. "Këtë funksion të ri ne e shohim edhe si besim të qeverisë se rezultatet e deritanishme të arritura prej gjithë këtij kolektivi punonjës", tha Lame. Zbatimi i këtij vendimi do t'u krijojë mundësi e mijëra pronarëve që përmes regjistrimit të pronës së tyre, të mund ta bëjnë atë të garkullueshme në treg, ta shesin apo ta japin me qira ligjërish, ta fusin në tregun e pasurive të paluajtshme, apo ta trajtojnë në tregun e kredimarrjes. "E kemi thënë që në fillim të mandatit të kaluar qeverisë së zgjidhja dhe stabilizimi i çështjes së pronësisë është një nga çështjet kyçe për qetësimin e të gjithë shoqërisë shqiptare dhe zhvillimin e ekonomisë", deklaroi kreu i ALUIZNI-t



procedurave administrative. Kalimi i pronësisë së ndërtimit dhe truallit funksional për sipërfaqet deri në 300 metra katrorë kryhet pa pagesë, nëpërmjet dokumentit, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi. Procedurat e kalimit të pronësisë, sipas këtij vendimi fillojnë: a) me kërkesë të subjektit/subjekteve, sipas modelit të kërkesës së miratuar me këtë vendim, pavarësisht nëse zona kadastrale i

është nënshtruar ose jo regjistrimit fillestar sistematik; b) gjatë procesit të regjistrimit fillestar apo përmirësimit/përditësimit të zonës kadastrale. Në këtë rast, me kërkesë të regjistruesit apo të çdo subjekti të ngarkuar nga kryerregjistruesi, njoftohet ALUIZNI për verifikimin e kushteve dhe vendimmarrjen, sipas këtij vendimi; c) me kërkesë të institucionit shtetëror, në rastet e shpronësimit për shkak të

**PËRCAKTIMI I SIPËRFAQES**

Në përcaktimin e sipërfaqes, ALUIZNI bazohet në kufijtë faktikë të sipërfaqes së poseduar, pa tejkaluar masën prej 300 metrash katrorë.

- 1.Për procedurën e ndjekur, subjekti përfitues paguan për llogari të ALUIZNI-t tarifën e shërbimit në vlerën 8 000 lekë për çdo kat ndërtimi, e cila përdoret për të përballuar shpenzimet e evidentimit në terren dhe shpenzimet e tjera të procedurës administrative. Kjo tarifë i njoftohet përfituesit menjëherë pas përfundimit të periudhës së afishimit, nëse përmbushen kushtet për të përfituar kalimin e pronësisë, sipas këtij vendimi.
- 2.Vendimi për kalimin e pronësisë miratohet në favor të subjektit kërkues dhe bashkëshortit/ës së tij, duke respektuar dispozitat e Kodit të Familjes për regjimet pasurore martesore. Në rast se subjektet nuk paraqesin dokument që provon regjim pasuror martesor të veçantë apo marrëveshje të posaçme noteriale për të drejtat mbi ndërtesën, vendimi miratohet në favor të të dy bashkëshortëve, duke prezumuar regjimin e bashkësisë ligjore.
3. ALUIZNI brenda 10 ditëve nga miratimi i kalimit të pronësisë përcjell vendimin së bashku me genplanin, për regjistrim pranë ZVRPP-së, e cila është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda 10 ditëve nga administrimi i dokumentacionit.

**REGJISTRIMI**

Për herë të parë, shteti shqiptar filloi procesin e regjistrimit të banesave në vitin 1995. Kjo u bë asokohe

**NJOFTIMI**

"INTERLOGISTIC SH.P.K.", distributori i autorizuar për Shqipërinë i markave të kompanisë ndërkombëtare "JOH.WILH. VON EICKEN GMBH", njofton se cmimi i shitjes me pakicë për produktet DENIM RED 210 lëkë/Paketë, DENIM BLUE është 210 lëkë/Paketë dhe COMPLIMET BLUE është 230 lëkë/Paketë.

## MASAKRA NË VLORË GJYQI

Zbardhet skema e krimit, autori : Më akuzonin që unë vdhja pulat

# Masakra me 8 të vrarë në Vlorë, lihet në burg Ridvan Zykaj

*I braktisur nga familja, 24-vjeçari nuk shfaq asnjë pendesë në gjyq*

Ina Allkanjari

VLORË

Ridvan Zykaj, i kon sideruar ndryshe si "monstra" e Selenicës, pasi ekzekutoi me kalashnikov 8 kushërinjtë e tij dhe më pas filloi skenën e krimit, doli ditën e djeshme përpara gjykatës së Vlorës për t'u njohur me masën e sigurisë. Gjatë seancës gjyqësore, e cila u zhvillua me dyer të mbyllura, me kërkesë të prokurorit të çështjes Saimir Smaka, gjyqtarja Esmeralda Habelaj dha masën e sigurisë "arrest me burg" për autorin e masakrës në fshatin Resulaj. Mbi 24-vjeçarin rëndon akuzat "Vrasje në rrethana cilësuese, ndaj dy ose më shumë personave", si edhe "armëmbajtje pa leje". I veshur me një bluzë të bardhë dhe të njëjtat pantallona që kishte ditën kur qëlloi mbi 8 kushërinjtë e tij, Ridvan Zykaj ishte i vetëm në sallën e gjyqit, i braktisur nga familjarët e të afërmit. Prej momentit të arrestimit e deri më sot askush nuk është interesuar për të, ndërsa ushqimi e veshjet janë siguruar nga strukturat e policisë. Ndërsa 15 avokatë refuzuan të marrin përsipër dosjen, për të kryer mbrojtjen. Me ndërmjetësimin e kreut të gjykatës së Vlorës, u zgjodh Renato Mehmeti, si avokat i zgjedhur kryesisht nga shteti.

**SEANCA GJYQËSORE**  
Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, 24-vjeçari Ridvan Zykaj, autori i masakrës së Selenicës, njeriu që ekzekutoi pa mëshirë 8 kushërinjtë e tij u paraqiti pranë gjykatës së Vlorës për t'u njohur me masën e sigurisë. Gjakoftë, pa shprehje në fytyrë, dhe pa shfaqur asnjë shenjë pendese, Zykaj mbërriti në gjykatë nën masa të rrepta sigurie. Përpara se të futej në sallën e gjyqit, 24-vjeçari



### I SËMURI MENDOR

VLORE - Një 50-vjeçar në qytetin e Vlorës është hedhur ditën e djeshme nga kati i 3 i spitalit psikiatrik duke pësuar vdekje të menjëhershme. Sipas policisë, 50-vjeçari M.K., i cili ishte me probleme mendore, ka mundur t'ua largohet shërbimeve. Pak sekonda më vonë, ai është hedhur nga kati i 3 dukë ndërruar jetë në moment.

## Masakra me 8 viktime në fshatin Resulaj, e hëna ditë zie në Selenicë

Masakra me 8 viktime në fshatin Resulaj të Vlorës, tronditi jo vetëm qytetin bregdetar por të gjithë Shqipërinë. Ditën e djeshme në Selenicë u mbajt ditë zie. Vendimi për ditë zie u mor nga Këshilli Bashkiak i Selenicës në nder të viktimave të vrara. Në një postim në 'Facebook', referuar masakrës, Bashkia Selenicë shkruan se secili prej nesh duhet të ndihet përgjegjës për këtë ngjarje të këtyre përmasave.

"Bashkia Selenicë në ditë zie! Ngjarja tragjike e tri ditëve më parë, ku hum-

u përball edhe me protestën e familjes Hoxhallari për vrasjet e ndodhura në familjen e tyre në Vlorë, të cilët me pankarta në dorë bënë thirrje për rikthimin e dënimit me vdekje. Autorin e ngjarjes tragjike e ulen në kafazin e të pandehurit, pa mbërritur trupa gjyqësore

dhe avokati, kohë kur gazetarët e pranishëm përfituan për t'i drejtuar një breshëri pyetjesh. "Pse e bëre?", "Po fëmijët pse i vrave?", "Jependuar?", kanë qenë pyetjet e para që gazetarët i kanë bërë Ridvan Zykajit, para se ky i fundit të marrë vendimin nga

gjyqtarët. Megjithatë autori i krimit makabër nuk dha asnjë reagim duke i parë drejt e në sy e duke mos i kthyer asnjë përgjigje gazetarëve. Përpara se të jepej masa e sigurisë "arrest me burg" për 24-vjeçarin, prokuroria rindërtoi skemën e krimit.

familjarët dhe njerëzit e afërt të të ndjerëve. Kurajo dhe forcë pjesëtarëve të familjes që pësuan tragjedinë. Le të prehen në paqe shpirtit dhe pafajshëm, të cilëve jetën ua preu në mënyrë mizore dora e një vrasësi, mbi të cilin drejtësia duhet të veprojë pa mëshirë. Kërkojmë mirëkuptimin e të gjithë banorëve të Bashkisë, institucioneve, bizneseve që operojnë në territorin e kësaj bashkie, të respektojnë në mënyrën më korrekte këtë ditë zie", -thuhet në postimin e Bashkisë së Selenicës.

gjyqtarët. Megjithatë autori i krimit makabër nuk dha asnjë reagim duke i parë drejt e në sy e duke mos i kthyer asnjë përgjigje gazetarëve. Përpara se të jepej masa e sigurisë "arrest me burg" për 24-vjeçarin, prokuroria rindërtoi skemën e krimit.

# 15

### AVOKATË

15 avokatë refuzuan të marrin përsipër dosjen, për të kryer mbrojtjen ndaj 24-vjeçarit Ridvan Zykaj. Me ndërmjetësimin e kreut të gjykatës së Vlorës, u zgjodh Renato Mehmeti, si avokat i zgjedhur kryesisht nga shteti.

### VIKTIMAT

- 1- Demir Zykaj, 75 vjeç (Vëllai i gjyshit të autorit)
- 2- Ferie Zykaj, 72 vjeçe, (Gruaja e Demirit)
- 3- Besim Zykaj, 42 vjeç (Djali i Demirit)
- 4- Vasilika Zykaj, (Gruaja e Besimit)
- 5- Sara Zykaj, 17 vjeçe (Vajza e Besimit)
- 6- Ledjon Zykaj, 6 vjeç (Djali i Besimit)
- 7- Azem Zykaj (Djali i Demirit)
- 8- Afërdita Zykaj (Gruaja e Azemit)

### SKEMA E KRIMIT

Sipas hetimeve të kryera nga policia thuhet se pak minuta pas mbarimit të drekës dhe largimit të të gjithë njerëzve nga shtëpia e Kujtim-it, shtetasit O. Hoxhaj në telefonin e tij celular në aplikacionin messenger i ka ardhur një video e dërguar nga Ridvan Zykaj në të cilën shfaqeshin dy persona të shtrirë në tokë në oborrin e banesës së shtetasit Demir Zykaj. Këtë video O. ia tregoi dajës së tij Bujar Zykaj dhe babait të tij Spartakut, të cilët pasi e panë këtë video u alarmuan. Shtetasi Spartak Hoxhaj i ka thënë djalit të tij ta fshinte pasi pamjet ishin të rënda. Spartaku me familjen e tij është nisur me automjetin e tij për të shkuar në shtëpinë e tij në fshatin Panaja dhe gjatë rrugës nusja e Spartakut ka komunikuar në telefon me Sadikun, në gjendje të rënduar psikologjike i ka pohuar asaj se djali i tij Ridvani kishte vrarë me armë zjarri shtetasit Azem dhe Afërdita Zykaj.

Bëhet me dije se komunikim telefonik ka patur dhe midis Sadik Zykajit dhe Bujar Zykajit ku sërisht Sadiku i ka pohuar të njëjtën faktë dhe atij. Në të njëjtën kohë Sadik Zykaj ka komunikuar në telefon dhe me policinë, të cilën e ka njoftuar për ngjarjen e ndodhur. I pyetur nga prokurori në prani të mbrojtësit të aktuar: i arrestuari Ridvan Zykaj e ka pranuar faktin penal dhe ka shpjeguar mekanizmin e ngjarjes. Nga shpjegimet e dhëna përpara prokurorit rezultoi se vrasja ka ndodhur për motive të dobëta, duke marrë jetën e shumë personave. Në përfundim të seancës gjyqësore, avokati Renato Mehmetaj, i cili pranoi ta mbronte 24-vjeçarin, vetëm pas ndërhyrjes së kryetarit të gjykatës, kërkoi ekspertimin psikik të autorit të masakrës që tronditi mbarë opinionin publik. Sakaq mësohet se do të ngrihet një komision mjekësh për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të 24-vjeçarit Zykaj.





Sociologu: Dënimi me vdekje nuk e zgjidh çështjen e kriminalitetit

# Gëzim Tushi: "Ritvanët" në shoqërinë shqiptare, si t'i ndalojmë

"Alarm social, merremi me kriminelin, jo me krimin"

Voltiza Duro

**K**rimi makabër në Selenicë të Vlorës që i mori jetën 8 personave, ka tronditur opinionin publik në vend, madje shumë qytetarë kërkojnë ndëshkimin me vdekje të autorit. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Gëzim Tushi, sociolog dhe "Mjeshtër i Madh" tregon se e keqja ka zaptuar shoqërinë shqiptare e liston të gjithë faktorët në intensifikimin e kriminalitetit. Më tej, sociologu sqaron se çështja nuk është Ritvani, por akti makabër që mund të përsëritet sërish, madje sipas tij krimi në shoqërinë shqiptare nuk dihet se ku mund të ndalet, çka e çon Shqipërinë në një situatë alarmante sociale.



Gëzim Tushi

**Masakra në Selenicë të Vlorës ku 24 vjeçari Ritvan Zykyk ekzekutoi 8 prej të afërmeve të tij, ka tronditur opinionin publik në vend. Cili është mendimi juaj si sociolog lidhur me këtë situatë?**

Mendoj që ngjarja e kohëve të fundit është me të vërtetë shumë shqetësuese. Sipas gjyqimit tim, kjo masakër i vuri "vulën" tipologjisë së krimin në shoqërinë shqiptare. Ishte ndoshta forma më flagrante, më e përbindshme, më e paimagjinueshme dhe kjo tregon që e keqja që ka zaptuar shoqërinë shqiptare, sidomos aspektet kriminale janë zgjeruar, intensifikuar e janë bërë shqetësuese për shoqërinë, për politikën për njerëzit dhe janë një kambanë alarmi për të gjithë.

**Ditët e fundit kemi parë shumë komente në rrjetet sociale që kërkojnë ndëshkimin e autorit me vdekje. A është kjo një zgjidhje?**

Problemi është që shoqëria shqiptare merret me kriminelin, dhe jo me krimin. Çështja nuk është Ritvani, por akti. Ne duhet të bëjmë veprimet e duhura për të zbutur situatën kriminale në shoqëri. Me Ritvanin do merret ligji, por krimi është demokratizuar, e kemi në familje, në shkollë, institucione, rrugë, kudo. Kjo është alarm social, nuk e di ku mund të shkojë e ku mund të ndalet krimi në shoqërinë tonë.

**Kohët e fundit në Shqipëri kanë ndodhur jo pak**

**IMPAKTI**  
Ngjarjet kriminale kanë impakt vetëm 3 ditë, mediatikisht dhe në rrjetet sociale dhe pastaj heshet sikur nuk ka ndodhur asgjë deri në ngjarjen e radhës. Kjo është një situatë shumë e keqe dhe kam përshtypjen se ilaçi që kemi zgjedhur për të mposhtur krimin është i gabuar.

gabuar. Më shumë shoqëria është në pritje të shtetit, dhe më pak të reageimeve qytetare për ta ndaluar krimin. Po! Shoqëria shqiptare po kalon një krizë dhe kjo ka humbur rolin edukativ. Ngjarja e fundit tregoi se faktorët që kanë rol në përballimin e krimin, ndeshjen me të e parandalimin e tij; janë copëtuar, fragmentarizuar dhe nuk veprojnë në sinkron. Kjo bën që të ekzagjerohen elementët që favorizojnë situatën kriminale të cilat janë bërë të shumta, të shpeshta e të pandalshme në shoqërinë tonë.

**Cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë kryerjen e krimeve të tilla makabre?**

Kjo ngjarje nuk është krenjtë pa shkak. Ka arsye që mund të jenë genetike, por ka edhe arsye sociale, këshu që duhet të bëjmë diagnoza diferenciale të shkaqeve të krimin në shoqëri. Është tjetër një krim që vjen për shkaqe patologjike, të trashëgimisë dhe kërkojnë një lloj trajtimi mjekësor (psikiatrike, psikosociale). Por janë ndryshe shkaqet e krimin që burojnë nga rrethanat e caktuara ekonomike apo sociale. Së pari, familja shqiptare që është "modernizuar" ka hequr dorë nga roli edukativ dhe përgjegjësitet e edukimit, shikojmë fëmijë që rriten me egoizëm, me vese e kur të rriten do i shfaqin më tej. Ritvanët krijohen në familje. Së dyti, edhe varfëria ndikon në rritjen e kriminalitetit e po ashtu edhe përdorimi i drogave, alkoolit e lëndëve të tjera. Një pjesë e madhe e krimeve bëhen nën efektin e kë-

tyre lëndëve që rrethojnë personalitetin e njeriut dhe e çajnë atë. Brenda njeriut endet kafsha dhe njeriu e nëse pjesa kafshërore mbizotëron mbi atë humane, atëherë njeriu bëhet "Ritvan" dhe të merr jetën. Vlen të theksoj se në shoqërinë shqiptare kanë humbur modalitetet e komunikimit social, ka shumë agresivitet, ka shumë konflikte me baza të ndryshme. Por një shoqëri të emancipuar konfliktet i zgjidh nëpërmjet komunikimit human. Në shoqërinë tonë ka komunikime të vrazhda, të sërta gati kafshërore që arrijnë deri në tragjizëm.

**A lind si domosdoshmëri forcimi i ligjit për ndëshkimin e krimeve?**

Demokracia u keqkuptua në shoqërinë shqiptare, solli lirinë por çliroi dhe kriminelët. Për shkak të nivelit edukativ e tranzicionit të hallakatur një pjesë e njerëzve kujtojnë se liria është çlirim nga morali, ligji dhe mund të bëjnë çfarë të duan. Policia shqiptare ka kohë që po lufton për ti dhënë një karakter komunitar policisë. Polici i komunës së Selenicës duhet ta dinte që Ritvani ishte një njeri asocial, nevrik, dhe tregonin që nesër mund të bëjë një kriminel me gjak të ftohtë, ashtu si ndodhi. Por kriminelin duhet ndëshkuar e për këtë duhen masa më të rrepta.

**Cila është zgjidhja për të frenuar dhe minimizuar kriminalitetin?**

Problemi është që në shoqërinë tonë mund të ketë Ritvanë të tjerë që mund të kryejnë masakra sikjo e nëse duam të përmirësojmë situatën duhet të bëjmë disa ndryshime thelbësore. Fenomeni i krimin në shoqërinë shqiptare është kompleks dhe duhet trajtuar në mënyrë komplekse. Faktorët që ndikojnë në parandalimin dhe mposhtjen e tij janë komplekse. Familja, shkolla, shoqëria, psikologu, sociologu, institucionet fetare, shteti duhet të luajnë rolin e tyre në parandalimin e krimin dhe të krijojnë një aleancë. Është i nevojshëm forcimi i stafit të institucioneve të mësipërme për të qenë njerëzit sa më humanë. Duhet të bëjmë analiza, studime, pasi dënimi kapital me vdekje, nuk e zgjidh çështjen e kriminalitetit që është shndërruar në një problem të madh social.



Rama: Ngjarje të tilla ekstreme ndodhin dhe në vende të zhvilluara

**P**as akuzave të shumta nga ana e opozitës se nuk ka denjuar të reagojë për masakrën e Resulajt, kryeministri Edi Rama, në fakt, e ka dhënë një përgjigje. Ai ka reaguar për herë të parë lidhur me ngjarjen e rëndë të ndodhur në Selenicë me 8 viktimat. Mendimin e tij për masakrën Rama e ka dhënë nëpërmjet një komenti drejtuar një qytetari rrjetin social 'Facebook', i cili i kërkon kryeministrit të ndër marrë masa për të ndaluar përdorimin e armëve. Në përgjigje, Rama shkruan se të tilla ngjarje ndodhin edhe në vendet më të zhvilluara demokratike, e nuk kanë asnjë lidhje me qeverinë! "Me fal, ti jeton në këtë botë, ndodhi të tilla ekstreme ndodhin edhe në vendet më të zhvilluara demokratike, e nuk kanë asnjë lidhje me qeverinë!", i përgjigjet Rama komentuesit.

**Puna e shqiptarëve, me produktivitetin më të ulët në Europë**

**BB: 40% e fuqisë punëtore ka ikur jashtë**

**PARALAJMËRIMI**

Ekspertët e Bankës lajmërojnë se produktiviteti është nën një kërcënim të mëtejshëm, pasi popullsia e Shqipërisë po plakët, e cila në afat të mesëm dhe të gjatë do të ushtrojë presion mbi rritjen e produktivitetit. Profili demografik i Shqipërisë është disi më i ri se ai i pjesës tjetër të Ballkanit Perëndimor, pasi popullsia nën moshën 30 vjeç përbën 41% të popullsisë së përgjithshme, krahasuar me 36% për vendet fqinje.

simuar ka emigruar në vendet e OECD deri në vitin 2010). Paralelisht, Shqipëria pati rritje të ulët të pagave. Por, emigrantët e kualifikuar nuk mund të zëvendësohen lehtë nga punëtorët e mbetur.

Përveç kësaj, edhe pse remittancat kontribuojnë në reduktimin e varfërisë, ato mund të dekurajojnë dëshirën për të punuar. Ekspertët e Bankës lajmërojnë se produktiviteti është nën

një kërcënim të mëtejshëm, pasi popullsia e Shqipërisë po plakët, e cila në afat të mesëm dhe të gjatë do të ushtrojë presion mbi rritjen e produktivitetit. Profili demografik i Shqipërisë është disi më i ri se ai i pjesës tjetër të Ballkanit Perëndimor, pasi popullsia nën moshën 30 vjeç përbën 41% të popullsisë së përgjithshme, krahasuar me 36% për vendet fqinje. Megjithatë, moshë mesatare po rritet. Ndërmjet viteve 1980 dhe 2015, pjesa e popullsisë nën 30 vjeç ra, ndërsa pjesa e popullsisë mbi 30 vjeç u rrit. Ek-



spertët e Bankës Botërore vënë në dukje se migrimi jashtë vendit është bërë një strategji e rëndësishme për punësimin, por kjo mund të ndikojë negativisht në rritjen e produktivitetit në Shqipëri në afat të gjatë. Iqjet e mëdha jashtë vendit nënkuptojnë se një pjesë e fuqisë produktive të punës është larguar. Banka Botërore evidenton se

numri i emigrantëve shqiptarë u rrit më shumë se trefish gjatë dekadave të fundit: nga 0.2 milionë në vitin 1990 në 1.05 milionë në vitin 2017, duke përfaqësuar pothuajse 40 për qind të popullsisë rezidente (statistikat e OKB-së 2018). Kjo shifër është më e larta në Ballkanin Perëndimor pas Bosnjë Hercegovinës.

**Buxheti afatmesëm publikon shifrat për ndërtimet e rrugëve, shkollave e ujësjesve**

Investimet publike në tri vitet e ardhme pritet të arrijnë një vlerë prej rreth 166 miliardë lekësh ose rreth 1.3 miliardë euro, sipas të dhënave nga Ministria e Financave. Më shumë se 40 për qind e kësaj shume është programuar për rrugët, me një vlerë investimesh prej 75 miliardë lekësh, ndërsa fonde të mëdha janë programuar në drejtim të ujësjes dhe zhvillimit rural. Në planet e qeverisë është parashikuar që investimet në rrugë të arrijnë në 75 miliardë lekë. Gjatë tri viteve në vijim përqendrimi i financimeve buxhetore do të shkojë për kompletimin e akteve të rëndësishme nacionale: Thumanë - Vorë - Kashar, Kashar - Rrogozhinë, Milot - Baldren, Orikum - Dukat dhe Kardhiq - Delvinë; si dhe 'bypass'-et e Fierit dhe Vlorës për shumën totale prej 75 miliardë lekësh për periudhën 2019-2021. Rritja e aksesit të popullsisë në shërbime cilësore, furnizimi me ujë dhe kanalizimet përmes financimit të projekteve të Ujësjes Kanalizimeve për periudhën 2019-2021 kanë një vlerë totale prej 32 miliardë lekësh. Sektori i ujit, i mbështetur nga modeli i financimit, i miratuar në vitin 2018 parashikon rritjen e investimeve çdo vit mesatarisht 4,3 miliardë lekë në vit për gjatë 2019-2021, gjithashtu parashikon edhe sistemin e granteve në bazë të performancës për të rritur përgjegjshmërinë dhe mbulimin e kostove të ndërmarrjeve të ujit.

**ARSIMI E SHËNDETËSIA**

Në arsimin parauniversitar do të finanohen me prioritet projekte për ndërtime të reja, rikonstruksion/rindërtimin apo shtesa në objektet aktuale për më shumë se 170 objekte arsimore të tjera, ose rreth 1500-1700 klasa/laboratorë mësimorë nga të cilët do të përfitojnë 50,000-55,000 nxënës dhe 3000-3500 mësues dhe edukatorë. Programi i investimeve në shëndetësi synon

**Investimet, si do të shpërndahen 1.3 miliardë euro për tri vite**

*Shëndetësia merr 3.4 miliardë lekë, rrugët 75 miliardë*



**INVESTIMET**

- ◆ Rrugët, 75 miliardë lekë investime
- ◆ Infrastruktura rurale, 48 miliardë lekë
- ◆ Ujësjes-Kanalizime, 32 miliardë lekë
- ◆ Arsimi, ndërtohen 170 objekte
- ◆ Shëndetësia, 3.4 miliardë lekë investime
- ◆ Bujqësia, 7,8 miliardë lekë

**Tatimet: Numri i bizneseve të reja në bregdet u rrit me 58%**

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka publikuar të dhënat më të fundit në lidhje me bizneset e reja të regjistruara në zonat turistike. Sipas të dhënave të Tatimeve, Saranda mban rekordin për numrin e bizneseve të reja të regjistruara. Në njëftim thuhet se Administrata Tatimore vazhdon të jetë e fokusuar me prioritet në zonat turistike, për të garantuar zhvillimin e konkurrencës së ndershme, rritjen e të ardhurave, si dhe reduktimin e shkallës së informalitetit, teksa sezoni veror është në kulmin e tij. Referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, numri i bi-



znesëve të reja të regjistruara në zonat turistike për periudhën 1 qershor-13 gusht ishte 1,531 ose 58% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Shifrat përkasin subjekteve të reja të regjistruara në Drejtorinë Tatimore Rajonale Durrës, Lezhë, Sarandë, Shkodër dhe Vlorë. DRT Sarandë, sipas të dhënave, shënoi rritjen me të lartë me rreth 44% të bi-

znesëve të reja, të hapura gjatë periudhës së marrë në analizë, duke vijuar më pas me DRT Lezhë me rreth 33% dhe DRT Vlorë me rreth 24%. Administrata Tatimore do të vazhdojë t'u vijë në ndihmë tatimpaguesve, në respektimin e detyrimeve ligjore, si dhe duke u kujdesur për të siguruar transparencën e kërkuar nga turistët.

rikonstruktimit e plotë të 200 qendrave shëndetësore (100 qendra çdo vit) për periudhën 2019-2020, me një vlerë të përlogarituar mesatarisht 450 milionë lekë në vit. Këto qendra do të mobilohen dhe kompletohen me pajisje mjekësore. Janë programuar të kryhen rikonstruksione të godinave spitalore me një vlerë 1.9 miliardë lekë për periudhën 2019-2021. Në këtë projekt përfshihen spitali Lushnje, spitali psikiatrik Elbasan, spitali Vlorë, Berat, Lezhë, Pogradec, Mat.

**BUJQËSIA**

Rritja e produktivitetit në fermat e mëdha do të vazhdojë të mbështetet me më shumë se 7.8 miliardë lekësh, të siguruar nga programi i PARD. Këto fonde do të përmirësojnë prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore për të rritur sasinë dhe sigurinë ushqimore të tyre. Do të vazhdohen investimet me

synimin "ujë në çdo parcelë" si dhe përmirësimi i kullimit përmes thellimit të decentralizimit dhe rritjes së investimeve në sektor. "Rilindja rurale" do të jetë programi i integruar i zhvillimit të qendrave të banuara, zonave me interes turistik, apo i zonave rurale në të cilat do të synohet përmirësimi infrastrukturës, vlerësimi i traditave dhe trashëgimisë kulturore, rritja e nivelit të shërbimeve publike, përmirësimi estetik i qendrave të banuara që u jep mundësi zonave të caktuara rurale të kenë një trend pozitiv zhvillimi ekonomik, të diversifikuar dhe të qëndrueshëm, duke krijuar njëherazi edhe premissat për zhvillimin e turizmit dhe agroturizmit. Për këtë qëllim do të investohen përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në programe zhvillimi dhe infrastrukturë rurale për periudhën 2019-2021 rreth 48 miliardë lekë.

Ngjarja e 10 gushtit për gjakmarrje, viktima u akuzua për vrasjen e Kurmemajit në 2011-ën

SHKODËR

# Ekzekutimi i kunatit të Lulzim Kullës, policia: Autorët, vrasës me pagesë

## "Në atentatin ndaj Fatbardh Licit morën pjesë 3 persona, ja rolet e 2 bashkëpunëtorëve"

Pak ditë pas atentatit të ndodhur në lagjen "Guerrile" të Shkodrës, ku mbeti i vrarë me 15 plumba automatiku Fatbardh Lici, policia ka zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen e rëndë që tronditi banorët e këtij qyteti. Burime pranë grupit hetimor dje bënë me dije se në ekzekutimin e 53-vjeçarit dyshohet se janë përfshirë tre persona. Bëhet fjalë për atentatorin dhe dy bashkëpunëtorë të tij. Sipas hetuesve të çështjes, dyshohet se autorët e ngjarjes së rëndë të ndodhur në orët e para të mëngjesit të së premtes të jenë vrasës me pagesë, nisur kjo edhe nga fakti që ata kanë mundur të zhdukin çdo gjurmë. Mësohet se njëri nga bashkëpunëtorët ka njoftuar vrasësin se Fatbardh Lici (baba i tre fëmijëve) do të ishte në lokal. Ndërsa, bashkëpunëtori i dytë ka pritur autorin pas krimit me makinën tip "Benz" (dyshohet të jetë vjedhur në Tiranë), e cila u gjet e djegur në Dobraq të Ri. Ndonëse po hetohet në disa pista për zbardhjen e ngjarjes, deri më tani pista kryesore e vrasjes së 53-vjeçarit (kunat i të "fortit" të Shkodrës, Lulzim Kulla) është ajo e gjakmarrjes nga Kurmemajit. Po të njëjtat burime pohuan se tre personat e përfshirë në atentat dhe që ende nuk janë identifikuar e kanë planifikuar me detaje të gjithë skenën e krimit. Kjo për faktin se jo vetëm qëlluan për vdekje 53-vjeçarin, por zhdukën provat dhe mundësinë të arratiseshin. Pavarësisht kësaj, blutë e qytetit verior në bashkëpunim me prokurorinë po hetojnë intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit.

**ATENTATI**  
Sipas burimeve policore, Fatbardh Lici ka qenë i vetëm i ulur në tavolinën jashtë lokalit, kur rreth orës 07:15 të së premtes, një person i maskuar është afruar deri rreth 20 metër larg vendit ku ndodhej ai. Autori ka nisur që të qëllojë në drejtim të 53-vjeçarit, ndërsa ky i fundit sapo ka dëgjuar krismat dhe ka parë se është objektivi i atentatorit, është ngritur nga tavolina duke tentuar që t'u shpëtojë plumbave. Autori e ka ndjekur atë duke e qëlluar deri sa e ka lënë të vdekur në vend. Lici është rrëzuar pranë tavolinës ku po pinte kafe për shkak të plumbave në drejtim të tij. Mësohet se viktimat e kishte të parkuar afër makinës e tij dhe ka tentuar të shkojë në drejtim të saj, por e ka pasur të pamundur. Autori i maskuar pasi ka kryer vrasjen, ka hipur në makinën e tij tip "Benz" dhe është larguar me shpejtësi. Sipas burimeve nga të pranishmit në vendngjarje, atentatori është larguar me mjetin e tij në drejtim të lagjes "Rus". Më



Viktima Fatbardh Lici



Vendi ku ndodhi ngjarja

15

**PERSONA**

Pas vrasjes në atentat të 53-vjeçarit Fatbardh Lici, policia ka shoqëruar dhe mori në pyetje 15 persona. Mësohet se pjesa më e madhe e të shoqëruarve ishin dëshmitarë, ose persona që mund të kishin dijeni për ngjarjen e ndodhur, por deri më tani nuk ka asgjë konkrete. Viktima ishte babai i tre fëmijëve, dy djemve dhe një vajze. Familja Lici hapi dyert e morrit, ndërsa 53-vjeçari u përçoll në banesën e fundit në orën 19:00 të së premtes së 10 gushtit.

**MESAZHI I ATENTATORIT**

Mustafa Lici ka qenë i vetëm në tavolinën kur po pinte kafën e mëngjesit, kur një person i maskuar është afruar deri rreth 20 metra larg vendit ku ndodhej ai. Atentatori para se ta qëllonte 53-vjeçarin me automatik tip "Scorpion", mësohet t'i ketë thënë viktimës "të fala". Të paktën kështu mësohet të jetë shprehur njëri prej dëshmitarëve në vendngjarje. Breshëria e madhe e plumbave në drejtim të tij rezultoi fatale, pasi nga të shtënat 53-vjeçari mbeti i vdekur në vend.

pas ka marrë rrugën drejt bustit të "5 Heronjve" në dalje të qytetit. Nga aty, autori dyshohet se është futur tek rruga e Dobraqit të Ri. Në segmentin e parikonstruktuar ka ecur rreth 100 metra, duke marrë kthesën në atë zonë në një rrugicë dytësore. Më pas ka ndalur mjetin dhe ka dalë jashtë. Menjëherë agresori i ka vënë flakën për të humbur çdo lloj gjurmë të mundshme të krimit.

**HETIMI**

Dyshimet kryesore për vrasjen e Fatbardh Licit janë për gjakmarrje edhe pse kjo mbetet në kuadrin e dyshimeve. Policia pas vrasjes së babait të tre fëmijëve ka rrethuar shtëpinë, në të cilën ka jetuar më përpara Astrit Kurmemaj. Ky i fundit është vrarë në vitin 2011 në Shkodër. Policia në atë kohë dyshoi se

mund të kishte lidhje Fatbardh Lici, por pas shoqërimit të këtij të fundit, u la sërish i lirë duke mos u dënuar për shkak se nuk kishte asnjë provë ndaj tij. Ndërkaq, policia po heton edhe në pista të tjera, me qëllim vrasjen e Fatbardh Licit, që mund të jetë ndonjë hakmarrje ndaj tij për shkak të konflikteve të mëparshme me persona të ndryshëm. Policia ka shoqëruar

rreth 15 persona, pjesa më e madhe dëshmitarë ose persona që mund të kenë dijeni për ngjarjen e ndodhur, por deri më tani nuk ka asgjë konkrete. Policia po punon për zbardhjen kësaj vrasjeje të ndodhur në Shkodër. Fatbardh Lici është vëllai i Mustafat Licit, ky i fundit anëtar në Këshillin Bashkiak të Shkodrës, me partinë Mendimi Dhathtë Liberal.

**Kontrolle për armë, 2 të arrestuar në Vlorë dhe Sarandë**

Pak ditë pas masakrës së Selenicës, policia e Vlorës dhe Sarandës ka arrestuar dy persona për armëmbajtje pa leje. Gjatë 24 orëve të fundit janë ushtruar kontrolle, në ambiente të hapura, kontrolle ndaj automjeteve dhe personave që dyshohet se mund të posedonin apo qarkullonin me armë, si dhe në lokale e banesa. Sërsullat i këtyre kontrolleve, dje policia e Vlorës, ka evidencuar dhe arrestuar në flagrancë shtetasin, Orgest A., 19 vjeç, banues në Vlorë. U krye arrestimi i tij pasi në lagjen "24 Maji", gjatë kontrollit në banesë u gjet dhe sekuestrua një armë zjarri pistoletë tip "Zastava", pa leje. Ndërsa një tjetër rast u konstatua dy ditë më parë nga policia e Sarandës në lagjen nr.1, ku gjatë kontrollit në ambientet e një lokali u gjet dhe u sekuestrua një pistoletë, 3 gr kanabis dhe u arrestua shtetas B.M., 38 vjeç, banues në Tepelenë. Materialet hetimore iu referuan prokurorisë, për veprimet të mëtejshme procedurale. Policia e Vlorës po vijon kontrollin për të evidencuar e goditur çdo rast të armëmbajtjes pa leje.

### Sebastian Vall tentoi të kalonte kufirin me autobus Trafiku i armëve, kapet me 19 pistoletë në pikën Kufitare të Muriqanit 21-vjeçari nga Suedia

**SHKODËR** - Një 21-vjeçar nga Suedia është arrestuar në pikën e kalimit kufitar të Muriqanit në Shkodër, pasi i janë gjetur dhe sekuestruar 19 pistoletë. Mësohet se i riu Sebastian Vall po udhëtonte si pasagjer në autobusin e linjës Kosovë-Gjermani. Sipas burimeve policore, ky është një rast që lidhet me trafikun e armëve nga Kosova drejt vendeve të BE-së. "Si rezultat i shtimit të kontrolleve duke përdorur edhe qentë

**ARRESTIMI**

Mësohet se i riu Sebastian Vall po udhëtonte si pasagjer në autobusin e linjës Kosovë-Gjermani. Sipas burimeve policore, ky është një rast që lidhet me trafikun e armëve nga Kosova drejt vendeve të BE-së.

antidrogë dhe antiexplosivë është bërë e mundur që të konstatohet dhe goditet një rast i trafikimit të armëve të zjarrit. Shërbimet e Policisë Kufitare në PKK Muriqan bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit Sebastian Vall, banues në Suedi. Në PKK Muriqan në dalje

gjatë kontrollit të detajuar në vijën e dytë, në çantën e 21-vjeçarit suedez, i cili udhëtonte si pasagjer në autobusin e linjës Kosovë-Gjermani, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 19 armë zjarri tip pistoletë, kalibër 7.65. Veprimet po vijojnë nga Special-



istët e Departamentit të Policisë Kriminale dhe të Policisë Shkodër për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të këtij rasti të trafikut të armëve. Materialet do t'i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprimet penale "Trafikimi i armëve dhe i municionit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Shkodrës.

Ndërmjetësi në Drejtorinë e Emigracionit: Qeveria helene e pranoi kërkesën tonë

Voltiza Duro

**P**as kërkesave të shogqatave të emigrantëve shqiptarë në Greqi, qeveria e shtetit helene vendosi që të shtyjë aplikimet me 6 muaj për nënshtetësinë greke. Në një intervistë për Gazeta Shqiptare, Fatos Malaj ndërmjetës kulturor pranë Drejtorisë të Emigracionit, njëkohësisht drejtues i organizatës Përkrahje-Arogi, tregon se cilat janë kategoritë që do të përfitojnë nga shtyrja e afatit si dhe iu bëën thirrje që të paraqesin aplikimet deri më 31 dhjetor 2018. Përkatesisht bëhet fjalë për të gjithë ata që në korrik 2015 kishin mbushur moshën madhore dhe ata që po atë kohë, kishin kryer studimet e larta. Gjithashtu, Malaj bëën me dije se kriteret që duhet të përmbushin emigrantët shqiptarë (që nuk përfshihen në kategoritë e sipërpërmendura) për të marrë pasaportën greke.

**Qeveria greke kishte vendosur që të linte si afat të fundit të aplikimeve për nënshtetësinë greke datën 9 korrik të këtij viti. Cila ishte arsyeja që reagoan shoqatat e emigrantëve për shtyrjen e afatit?**

Në mesin e muajit qershor, ne njoftuam se kush dëshironte të aplikonte për nënshtetësinë greke duhej ta bënte këtë deri më 9 korrik. Natyrisht, siç e theksonim qysh në fillim, fjala ishte për të ashtuquajturin brezi i dytë, pra për fëmijët tanë. Njoftimi ynë bazohej në shkresën urgjente të sekretarit të posaçëm për nënshtetësinë, që u drejtohej gjithë periferive dhe u kërkonte që të njoftojnë me çdo mjet e mënyrë të interesuarit se aplikimet do të pranohen ekskluzivisht deri më 9 korrik 2018. Si vërtetim për aplikimin brenda kësaj date do të merrej numri i protokollit që jep periferia apo fatura e postës apo e shërbimit korrier për dërgimin e aplikimit. Por kishte dy kategori specifike, që rrezikonin të mbeteshin jashtë dispozitave të nënshtetësisë, kështu që ne kërkuan shtyrjen e afatit të aplikimit. Menjëherë pas dhënies së këtij "ultimatumi", të paktën dy organizata emigrantësh, "2 Generation" dhe "Arogi", reagoan me insistim duke kërkuar që qeveria ta shtynte këtë afat, pasi këto dy kategori emigrantësh, nevojiteshin

# Shtyhet afati i aplikimeve për nënshtetësinë greke

Fatos Malaj: Cilat janë kategoritë që mund të përfitojnë



**Ministri Klossi takim me të rinjtë e Smile Albania në kampin e Jalës**

**T**ë rinjtë e Smile Albania, të mbledhur në kampin më të madh të buzëqeshjes në Jalë, u takuan me ministrin Blendi Klossi. Gjatë bashkëbisedimit me të rinjtë, ministri Klossi tha se duhet të rriten kapacitetet turistike dhe cilësia e shërbimit. "Ne duhet ta kemi shumë të qartë që deti Adriatik dhe deti Jon janë për shqiptarët e të dyja anëve të bjeshkëve dhe ata kanë gjithë mikpritjen nga të rinjtë shqiptarë dhe duhet jemi si një të tërë në këtë përpjekje tonë për një Shqipëri me shfrytëzim të plotë? potenciale turistike", tha ministri Klossi. Ai shtoi me tej se projekti Smile do të vijojë dhe pas sezonit turistik të verës për të qenë në shërbim të turizmit dhe mjedisit "Nuk buzëqeshim vetëm për të mikpritur, duhet të buzëqeshim në radhë të parë vetë. Të ndihemi mirë që jetojmë në një Shqipëri të fortë, në një Shqipëri të pastër, turistike dhe ambientale. Ndaj duhet ta mbajmë operacionin Smile edhe përtej gushtit" - u shpreh ministri Klossi në kampin jugor të Smile Albania. Nga të rinjtë e projektit, ministri Klossi kërkoi më shumë angazhim në ditët e mbetura të gushtit. Ndryshimi i mentalitetit dhe edukimit mjedisor janë për ministrin e Turizmit dhe Mjedisit pika kyçe në betejën për mjedisin.

I pranishëm në takim me të rinjtë ishte edhe kryetari i bashkisë Himarë, Jorgo Goro, i cili vlerësoi kontributin e të rinjve në pastrimin e bregdetit.

31

**DHJETOR AFATI I FUNDIT**  
Qeveria ka dhënë një shtesë afati, deri më 31 dhjetor të këtij viti, kështu që dy kategoritë që rrezikonin të mbeteshin jashtë dispozitave të nënshtetësisë, do të kenë mundësinë të aplikojnë për nënshtetësinë greke.

kohë që të grumbullonin dokumentacionin e nevojshëm.

**A u pranua kërkesa juaja nga qeveria e shtetit helene?**

Për fat të mirë, apeli jonë dhe reagimet intensive ndaj qeverisë greke nuk ranë në vesh të shurdhët. Qeveria ka dhënë një shtesë afati, deri më 31 dhjetor të këtij viti, kështu që dy kategoritë që rrezikonin të mbeteshin jashtë dispozitave të nënshtetësisë, do të kenë mundësinë të aplikojnë për nënshtetësinë greke.

**Si u bë dekretimi i këtij vendimi mbi shtyrjen e afatit të aplikimeve për nënshtetësinë greke? A ka një nen të posaçëm që e njeh këtë të drejtë për emigrantët shqiptarë?**

Shtyrja e afatit sanksionohet në një nen të vetëm, që përfshihet në një ligj, i cili u publikua në gazetën zy-

tare në fund të korrikut. Është neni 272 që përcakton: Në nenin 2 të ligjit 4332/2015, bëhet ky ndryshim: "Për shtetasit e huaj që gjatë hyrjes në fuqi të këtij ligji (të 2015-s) përmbushin kushtet e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 1B të Kodit të Nënshtetësisë Greke dhe tashmë kanë moshë madhore, u jepet afat deri më 31 dhjetor 2018 që të paraqesin aplikimin që parashikohet nga këto dispozita".

**Cilat janë kategoritë që do të kenë mundësinë të aplikojnë deri në fund të 2018-ës?**

Të gjithë ata që në korrik 2015 kishin mbushur moshën madhore dhe ata që po atë kohë, kishin kryer studimet e larta. Përkatesisht në dispozitat që u referohet amendamenti përfshihen: shtetas të huaj që më datën 9 korrik 2015 kishin

**APLIKIMI**

**Në dispozitat që u referohet amendamenti përfshihen:**

- Shtetas të huaj që më datën 9 korrik 2015 kishin mbushur moshën madhore dhe kishin përfunduar me sukses arsimimin në 9 klasë të nivelit të parë dhe të dytë, apo gjashtë klasë të nivelit të dytë, qoftë si të mitur, qoftë si të rritur.
- Shtetas të huaj që më datën 9 korrik 2015 kishin mbushur moshën madhore dhe kishin përfunduar me sukses arsimimin në shkollën e lartë AEI ose TEI, përderisa disponojnë dëftesën e lirimit nga shkolla e nivelit të dytë.

mbushur moshën madhore dhe kishin përfunduar me sukses arsimimin në 9 klasë të nivelit të parë dhe të dytë, apo gjashtë klasë të nivelit të dytë, qoftë si të mitur, qoftë si të rritur; si dhe shtetas të huaj që më datën 9 korrik 2015 kishin mbushur moshën madhore dhe kishin përfunduar me sukses arsimimin në shkollën e lartë AEI ose TEI, përderisa disponojnë dëftesën e lirimit nga shkolla e nivelit të dytë. Bashkatdhetarët që u përkasin dy kategorive të lartpërmendura, të shkojnë menjëherë dhe të paraqesin aplikimin, pse në rast të kundërt e humbasin të drejtën e mar-

rjes së nënshtetësisë greke mbi bazën e këtyre dispozitave.

**Cilat janë kushtet për të marrë nënshtetësinë greke për emigrantët që nuk përfshihen në kategoritë e sipërpërmendura?**

Kriteret për të marrë nënshtetësinë janë: nëse jeton 7 vjet ligjërisht në Greqi; nëse jeton 3 vjet rresht në Greqi dhe ke ardhur nga një vend i Bashkimit Europian; nëse je homogjen; nëse je refugjat politik; nëse ke buletin personal pa shtetësi; si dhe nëse ke një fëmijë, i cili është shtetas grek. Ndërkohë kërkesat formale për marrjen e shtetësisë greke me natyralizim janë: duhet të jeni në moshë madhore në kohën e deklarimit të natyralizimit; të mos jeni dënuar me burgim të paravokueshëm (përfundimtar), të paktën një vit në dekadën e fundit; të mos jetë në pritje një vendim deportimi (apelas) kundër jush; si dhe të keni titull qëndrimi të ligjshëm.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Datë 17.08.2018, Ora 16:00  
Shoqëria Përbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.  
Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajshme të debitorit Agron Shefqet Burhani dhe dorëzimitesë Hatibë Shefqet Burhani.  
"Apartamenti banori + Trull" me sipërfaqe 62 m<sup>2</sup>, nr.1 pasurisë 14/301, zona kadastrale 3574, e regjistruar në regjistrin hipotekor numër 2561 datë 07.10.1994, adresa: Lagja "15 Shtatori", pallati 53, shkalla 1, apartamenti 4, Tëpelë. Çmimi fillësar i ankandit të parë është në shumën 1 280 000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.  
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Datë 23.08.2018, Ora 16:00  
Shoqëria Përbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.  
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajshme të debitorit Enkelea Novaku dhe dorëzimitesë Adriatik Novaku:  
"Trull" me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup> dhe "Nëntërtesë" me 3 kate me sipërfaqe 90 m<sup>2</sup> secili, nr. i regjistruar 4/106, zona kadastrale 8581, vol. 13, faqe 69, adresa: Lagja Nr. 1, Pogradec. Çmimi fillësar i ankandit të dytë është në shumën 7 280 000 (shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.  
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

## Kapiteni Allka: Pasagjerët po trajtohen si skllëvër

### Shërri në portin e Durrësit, policia nis procedimin penal ndaj rojës italiane të sigurisë

**DURRËS** - Dy ditë pas ngjarjes së ndodhur në Portin e Durrësit, ku pasagjerët e një trageti u përfshirë në një sherr të madh me rojet e sigurisë, ka reaguar edhe policia e qytetit bregdetar. Sipas bluve, shkak për dhunën u bë vonesa e tragetit për disa orë, duke shkaktuar nervozizëm e shqetësim tek udhëtarët që prisnin në port. "Në lidhje me një incident që ka ndodhur më datë 11.08.2018 në sheshin e trag-

eteve në Port-Durrës, informojmë se konflikti ka nisur midis ekuipazhit të tragetit të linjës Bari-Durrës-Bari dhe pasagjerëve. Pasagjerët ishin acaruar pasi kishin disa orë që prisnin për t'i nisur për udhëtim, por trageti kishte pësuar defekt dhe kishte njoftuar se do të kishite vonesë në nisje", thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkaq, bëhet me dije se ka nisur procedimi penal në gjendje të lirë ndaj një 35-

vjeçari me inicialet I.M. (banues në Itali), me detyrë roje fizike i linjës Bari-Durrës-Bari, pasi është konfliktuar dhe ka goditur me sende të forta disa shtetas që do të udhëtonin me traget për në Itali. Sipas policisë ai akuzohet për veprën penale: "Plagosja e lehtë me dashje". Konflikti u shua me ndërhyrjen e punonjësve të Policisë së Kufirit Durrës. Skenat e rëndatë konfliktit që u shënuan në terminalin e trageteve në Dur-



rës si rezultat i vonesave të trageteve solli mbledhjen emergjente të komitetit të sigurisë në portin e Durrësit ditën e djeshme ku ishte i pranishëm dhe Prefekti i Qarkut, z.Roland Nasto. Kreu Ekzekutiv i APD-së, Afrim Bakaj dhe prefekti pohan se institucionet duhet të bashkëpunojnë për të shmangur ankesat e pasagjerëve. Nasto tha se lidhur me incidentin e regjistruar më datë 11 gusht në sheshin e trageteve në

Port-Durrës, ka filluar procedimi penal. "Pasagjerët po trajtohen si skllëvër. Në portin e Durrësit nuk ka asnjë tendë për hije as për makinat as për njerëzit. Nuk kanë ujë, tualet dhe detyrohen të qëndrojnë në pritje me orë të tëra", pohan kapiteni Taulant Allka dhe oficeri i sigurisë Dritan Prifti duke i bërë thirrje portit të marrë masa. Edhe agjencitë e lundrimit ngritën ankesa në drejtim të kushteve të munguara.

## SHKURT



### Shpërthen bombola e gazit shpëtojnë

**mrekullisht familjarët ELBASAN** - Një bombolë gazi ka shpërthyer në një banesë në Elbasan, por fatmirësisht pa lënë persona të lënduar. Sipas të dhënave zyrtare, ngjarja ka ndodhur në fshatin Bradashesh, në shtëpinë e shtetasit A.T., 55 vjeç. Me të marrë njoftim shërbimet e Policisë dhe zjarfikësja kanë mbërritur menjëherë në vendngjarje, ku kanë bërë të mundur shuarjen e zjarrit. Nga shpërthimi i bombolës së gazit nuk ka asnjë të lënduar, por vetëm dëme materiale.

### Rrëzohet në kanal in vaditës të fshatit, vdes 50-vjeçari

**PEQIN** - Mesditën e djeshme ka humbur aksidentalisht jetën një 50-vjeçar nga Peqini, pasi është rrëzuar në kanal in vaditës. Sipas policisë, ngjarja ndodhi në fshatin Lazarenj. Pasi u rrëzua, shtetasi B.K. për fat të keq është mbytur. "Rreth orës 12:30 jemi njoftuar se shtetasi B.K., 50 vjeç, banues në fshatin Shez, dyshohet se ka rënë aksidentalisht në kanal in vaditës në fshatin Lazarenj. Njësisia Administrative Pajovë, Peqin dhe është mbytur", njofton policia. Në vendngjarje ka shkuar grupi hetimor që po punojnë për gjetjen dhe nxjerrjen e trupit, si dhe sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Terror dhe në Gjirokastrë, 2 persona të maskuar grabisin lokalin në Parkun e Viroit

# Maskat tentojnë të vjedhin banesën në Korçë, dhunojnë pjesëtarin e familjes

Pronari i shtëpisë: Na sulmuan 4 persona të armatosur



## KORÇË/ GJIROKASTËR

Rikthehen maskat në Korçë dhe në Gjirokastrë. Mbrëmjen e së dielës, katër persona ende të paidentifikuar kanë tentuar të grabisin një banesë në fshatin Porodinë të Korçës. Mësohet se agresorët kanë hyrë në banesën e 38-vjeçarit me inicialet E.D. dhe kanë lënduar lehtë njërin prej anëtarëve të kësaj familjeje. Ndërsa mbrëmjen e së shunës, persona të maskuar kanë grabitur punonjësit e një lokali në Gjirokastrë. Ndërkohë që policia po punon intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të këtyre dy ngjarjeve.

### KORÇË

Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë Vendore të Korçës bëjnë me dije se rreth orës 22:30, maskat kanë tentuar të bastisin me armë banesën e shtetasit E.D. Gjatë tentativës së grabitjes, agresorët kanë ushtruar terror, por nuk kanë mundur të marrin asgjë dhe janë larguar nga shtëpia.



Foto ilustruese

Forcat e policisë, që shkuan menjëherë në vendngjarje morën në pyetje pronarin e shtëpisë, duke mësuar prej tij se autorët ishin të maskuar dhe të armatosur. Blutë ngritën pika të shumta kontrolli përreth zonës, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorëve, por edhe për të qartësuar rrethanat e ngjarjes.

### GJIROKASTËR

Sipas burimeve nga policia e Gjirokastrës, dy persona të maskuar kanë grabitur punonjësit e një lokali. Ngjarja ka ndodhur në orën 22:00 të së shtunës, ku dy agresorët u shfaqën në momentin që pronari po mbyllte

lokalin. Grabitësit goditën me mjete të forta 53-vjeçarin Adriatik B., duke i marrë 580 mijë lekë të vjetra dhe dy celularë 'iPhone 5S' dhe 'Samsung'. Ndërkaq, denoncimi është bërë të dielën, me 12 gusht. "Ngjarja ka ndodhur më 11 gusht, ndërsa denoncimi në polici është bërë më 12 gusht. Sipas punonjësve të lokalit, në orën 22:00 në parkun e Viroit, dy persona të maskuar u shfaqën pas tyre në momentin që po mbyllnin lokalin. Uniformat blu në Gjirokastrë janë duke hetuar për të identifikuar dhe arrestuar autorët", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Gjirokastrës.



## KËRKESË PËR OFERTË

### Paisje me mobilje

CEED Albania si pjesë e projektit të saj "Agro-Tourism Albania", kërkon të blejë mobilje të reja për mobilimin e ambienteve të fermave agroturistike të përgatitura si pjesë e projektit, kryesisht dhoma gjumi dhe ambiente ngrënie. Këto mobilje duhet të transportohen dhe montohen në fermat përkatëse në Bashkitë e Shkodrës, Malësisë së Madhe dhe Pukës.

Me qëllim mobilimin sa më estetik, projekti ka përgatitur materialet përkatëse me ndihmën e një arkitekti, të cilat përfshijnë foto dhe rendera.

Nëpërmjet këtij njoftimi CEED Albania kërkon të mbledhë oferta teknike dhe financiare mbi mundësitë e ofrimit të këtyre produkteve.

Të interesuarit duhet të dërgojnë në adresën: [info@ceed-albania.org](mailto:info@ceed-albania.org), një email me kërkesën e tyre për të marrë listen e artikujve që do të prokurohen si dhe detaje të tjera teknike, përfshirë renderat. Së bashku me këto materiale të interesuarit do të marrin edhe dokumentin e plotë të kërkesës për ofertë.

Aplikuesit duhet të jenë kompani të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe të paisura me të gjithë dokumentacionin e lejuar për ofrimin e këtij shërbimi.

## Bllokohet furgoni me 100 kg midhje në Vlorë

### AKU vijon kontrollet për sigurinë ushqimore, gjoba marketeve në zonat rurale

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka vijuar kontrollet në marketet e zonave rurale, me qëllim ndalimin e tregimit të ushqimeve të skuadur. Trupa inspektuese e AKU-së ka evidencuar në fshatin Memaliaj të Përmetit një subjekt me aktivitet "minimarket", e cili u kap në flagrancë duke treguar produkte të skuadur si: birra, reçel, kos, salcë kosi etj. Ndërsa në fshatin Duhanas të Beratit u konstatuan produktet: sallam, mish pule, salsicë, etj. me afat skadence të përfunduar. Ndaj dy



subjekteve është marrë masë administrative me gjobë. Ndërkohë, në këtë periudhë të temperaturave të larta e shtimit të volumit të tregtisë, trupa inspektuese e DRAKU, Vlorë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, ka ndaluar

një furgon, i cili shpërndante 100 kg midhje pa kushte frigoriferike dhe pa asnjë dokumentacion shoqëruar. Ndaj shtetasit Kristo Veizi u mor masë administrative gjobë si dhe asgjësim i menjëhershëm i produktit.

EKSPOZITA

# Diaspora, nga arbëreshët e Skënderbeut te shqiptarët e anijes "Vlora"

Në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Muzeu Historik Kombëtar në bashkëpunim me Muzeun e Kosovës çelën në Prishtinë ekspozitën "Unë jam shqiptar", ku shfaqen materiale fotografike mbi diasporën shqiptare. Kjo ekspozitë u organizua në kuadër të kalendarit të përbashkët kulturor ndërmjet dy qeverive në festimet e 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit dhe të 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, si ngjarjet të shënuara të kombit shqiptar.

Ceremoninë e hapjes së kësaj ekspozite e përshëndeti ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Kujtim Gashi, i cili tha se, "ekspozita trajton një përmbajtje kuptimplotë dhe barabartësisht të njëjtë si për Kosovën ashtu edhe për Shqipërinë, siç është diaspora shqiptare. Ekspozita të tilla janë dëshmi e një hapësire shumë të madhe që ekziston për të thelluar bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen". Në fjalën e tij të rastit, drejtori i Muzeut Kombëtar, dr. Dorian Koçi pasi bëri një përshkrim të shkurtër të ekspozitës tha: "Diaspora e re bën përpjekje të mëdha për t'u integruar me sukses në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të vendeve pritëse, ndikon në zhvillimet e Shqipërisë dhe shërben si urë lidhëse ndërmjet vendit amë dhe vendeve pritëse. Në shumë nga vendet mikpritëse emigrantët kanë themeluar shoqatat e tyre".

**IMAZHE E KOHË**

Ekspozita hapet në mënyrë kronologjike me fotografinë e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut, si përfaqësues i epokës që shënoi valëve të para të mëdha të emigrimit shqiptar. Viojnë arbëreshët e parë me ngulimet e tyre në Italinë e Jugut. Diaspora shqiptare dha kontribute të shquara në lëvizjet kombëtare në shtetet ku u vendos. Arvanitasit u dalluan si

*Shqiptarët që u dalluan në lëvizjet kombëtare nëpër botë, të ikurit që lanë gjurmë*



Ekspozita "Unë jam shqiptar" në Muzeun e Kosovës

luftëtarë të guximshëm të Revolucionit Grek të vitit 1821 dhe norxën nga gjiri i tyre figura të tilla si Bubulina, Teodor Kolokotroni, Andrea Miauli, Odise Andruco etj. Në Itali Garibaldi i quan arbëreshët heronj të lëvizjes çlir-

imtare italiane dhe për bashkimin e vendit. Gjatë pushtimit osman, sidomos në Rilindjen Kombëtare, kolonitë shqiptare mbajtën lidhje të vazhdueshme me atdheun dhe dhanë kontribute të shquara në lëvizjen kombëtare dhe shpalljen



e pavarësisë së Shqipërisë. Rilindësit e mëdhenj që nga Naum Veqilharxhi, Jeronim De Rada, princesa rumune me origjinë shqiptare Elena Gjika ose Dora D'Istria, Andon Zako Çajupi, Thimi Mitko, Fan Stilian Noli, Faik Konica ishin personalitete të shquara të diasporës në hartimin e programit të Lëvizjes Kombëtare shqiptare, në zhvillimin e arsimit dhe të kulturës, në krijimin e shoqërive patriotike etj. Kolonitë shqiptare vazhduan veprimtarinë e tyre edhe pas krijimit të shtetit shqiptar. Ato e mbështetën atë hap pas hapi në rrugën e gjatë të konsolidimit të tij, të afirmimit të botën ndërkombëtare për demokratizimin dhe lidhjet e tij me popujt e tjerë etj. Emigranti i parë i identifikuar në SHBA është moment i rëndësishëm në ekspozitë, duke vijuar me fotografi të shoqërive të para patriotike në Sofje, Bukuresht, Kajro, Stamboll e Vjenë. Diaspora shqiptare pasqyrohet nëpërmjet fotografive të protagonistëve të saj, fotografi të themelesve të shoqërive patriotike, si të Fan S. Nolit, Faik Konicës, Mit'hat Frashërit. Emigracioni i punës në Shqipëri arriti kulmin në fund të shek. XIX dhe fillimit të

shek. XX, të shkaktuar nga proceset e industrializimit dhe urbanizimit të shpejtë në shumë vende evropiane dhe në Amerikën e Veriut. Gjatë gjithë kësaj periudhe, një numër i madh i shqiptarëve emigruan për arsye politike dhe ekonomike, si: Gjon Mili, Stavro Skëndi, Xhon Belushi e Sten Dragoti. Në mars të vitit 1991, pas rënies së diktaturës dhe zgjedhjeve të para demokratike, vetëm pak ditë, më shumë se 24,000 shqiptarë lundruan drejt brigjeve të Italisë. Kjo ngjarje konsiderohej si një krizë kombëtare për Italinë dhe Shqipërinë. Këto ngjarje pasqyrohen me fotografi nga momentet e refugjatëve në Ambasadën Gjermane si dhe largimi i tyre nëpërmjet portit të Durrësit duke përdorur anijen "Vlora". Mijëra e mijëra qytetarë u larguan duke lënë pas atdheun e tyre, tokën, shtëpinë dhe të afërmit. Diaspora e re bën përpjekje të mëdha për t'u integruar me sukses në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të vendeve pritëse, ndikon në zhvillimet e Shqipërisë dhe shërben si urë lidhëse ndërmjet vendit amë dhe vendeve pritëse. Pjesa tjetër e ekspozitës, por jo më pak e rëndësishme, prezantohet nëpërmjet fotografive nga personalitetet e suksesshme shqiptare në vendet e emigrimit të tyre. Diaspora shqiptare në shumë raste e pasuruar me elementë të rinj dhe të shkolluar në perëndim dhe ndihmesë në pluralizmin e ideve dhe të gjithë opinionit publik. Ekspozita "Unë jam shqiptar" do të qëndrojë e hapur deri më 31 gusht 2018 në ambientet e Lapidariumit të Muzeut të Kosovës.

Gjatë vizitës në Muzeun e Kosovës, drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, dr. Dorian Koçi, zhvilloi edhe një takim me Ushtruesin e Detyrës së Drejtorit të Muzeut të Kosovës, Bislim Bislimi, ku u fol për thellimin e bashkëpunimeve të ndryshme mes dy muzeve, si edhe për organizimin e të tjera aktiviteteve shkencore apo dhe ekspozita.

fa.ni.



**NJOLLAT KAFE, PASOJË E MOSHËS APO NXIRJA DIELLORE**

# SUMMER

*pages*

SUPLEMENT I GAZETËS SHQIPTARE

E martë 14 Gusht 2018



**Alba Hoxha pozon me bikini, reagimi i Albi Nakos do ju habitë**



**Oriola Marashi u kthehet fotove 'hot'**

**BULEVARDI POLITIK**



- Grida Duma si një modele, deputetja surprizon me pamjen e saj
- Thaçi me Pacollin ngrenë doli në Shëngjin, Haradinaj është në Jalë
- Erla Mehilli bëhet nënë për herë të dytë, djali quhet Bind
- Ministri norvegjez anti-emigrant bie në dashuri me refugjaten



**Rrëfehët artisti: Besimi, arti dhe familja janë trinomi i së tërës**

## **ENRIS QINAMI:**

**I jam falënderues Zotit, ja si e kanë pritur muzikën time**

*"Gjithçka që ndodh është rezultat i vullnetit hyjnor"*

**Rrëfëhet artisti: Besimi, arti dhe familja janë trinomi i së tërës**

# Enris Qinami:

## I jam falënderues Zotit, ja si e kanë pritur muzikën time

*"Gjithçka që ndodh është rezultat i vullnetit hyjnor"*

Egla Xhemali

**S**ukses është të mbushësh shpirtin çdo ditë me paqe. Kjo arrihet në momentin kur je i destinuar të realizosh vepra të mira, të duash jetën dhe njerëzit. Besimi është ai që e hyjnizon njeriun. Nuk ka më bukur kur ai ndërthuret me muzikën. Ne patëm fatin të zbulonim të fshehtat e kësaj bote mrekullish. Për "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare" vjen një muzikant i veçantë, Enris Qinami, që njëllojësisht është dhe pedagog në Francë ku jeton dhe ushtron profesionin e tij. Lidhjen me besimin ai e sheh si një binom të pandarë me muzikën nga e cila frymëzohet për të prodhuar melodi për shpirtin. Vegla muzikore që ai përdor, sharkia nuk është e trashëguar nga familja, po një zgjedhje që është bërë në moshën e pjekurisë e mesa duket që prej asaj kohe ngulni rrënjë të një pasioni që ngelet i pashtershëm për të. Sipas tij, në muzikën tradicionale, estetika është në varësi të etikës. Në këtë lloj muzike, si në Shqipëri a gjetkë, kjo gjendje përçohet nëpërmjet përkujtimit të krijuesit, sepse pa përkujtim kjo rrugë është si një udhë pa udhë. Enisi i mëshon fort identitetit dhe kulturës së vendit, ndërthurur kjo dhe me qetësinë e shpirtit, besimin. Artistit i mungon gjithçka nga vendi i lindjes, Tirana, por na pohan se kujtimet janë pasuria më e madhe që ka marrë prej saj. Për të duartrokjet më të ngrohta janë vlerësimet që ka marrë prej njerëzve të panjohur, që janë rrënjësor thellë në zemër. Enrisi na tregon dhe për familjarët duke na thënë se janë gëjja më e shtrenjtë që ka. Ata kanë ndjekur dhe kanë mbështetur çdo hap të tij. Për të gjitha i është falënderues Krijuesit. Këtë verë ai ka zgjedhur të pushojë në Shqipëri. Së fundmi, Enrisi ndan me ne dhe projektet e fundit, angazhimin si pedagog dhe bashkëpunimet me artistë të ndryshëm nga e gjithë bota.

**Ju jetoni dhe ushtroni profesionin tuaj në Francë. Sa të vështirë kanë qenë hapat e parë atje?**  
Jetoj prej 17 vitesh në Francë ku punoj si pedagog i muzikës në "Ecole des Arts de l'Île-Saint-Denis", një qytezë-ishull buzë Senës, pranë



Parisit. Fillimet në Francë ishin të lidhura ngushtë me studimet, të cilat i ndoqa mbas mbarimit të studimeve në Tiranë pranë Liceut Artistik dhe Universitetit të Arteve ku dhe u diplomova në vitin 2001 në degën e kompozicionit muzikor. Po atë vit u nisa drejt Parisit për të vazhduar studimet nga ku dhe u diplomova për kitarë dhe për pedagogji muzikore. Hapat e parë kanë qenë të vështirë sigurisht, por në vështirësi fshihet vetë lehtësia.

**Pse keni zgjedhur pikërisht sharkinë? Ka qenë e trashëguar apo thjesht pasioni juaj?**

Në të vërtetë nuk jam unë ai që kam zgjedhur sharkinë, por ajo më ka zgjedhur mua, sepse kitarën e kisha zgjedhur në periudhën e ad-

oleshencës i shtyrë nga pasionet e moshës, ndërsa sharkinë në moshën e pjekurisë dhe me vetëdije të plotë edhe pse nuk e kisha të trashëguar nga familja. Muzika e traditës gojore zë një vend të veçantë nga pikëpamja e shprehjes dhe ndryshon shumë me zhanret e tjera muzikore, të cilat ndërtohen mbi idenë e estetikës muzikore si nevojë për t'ju përshatur një shije apo një tregu të caktuar në kohë dhe në hapësirë. Ndërsa në muzikën tradicionale, estetika është në varësi të etikës. Rrjedhimisht, çdo qëndrim muzikor korrespondon me një gjendje shpirtërore fillestare, e cila është edhe pikënisja drejt një udhëtimi i cili lind nga brendësia e njeriut. Ky udhëtim është ajo që

ne quajmë traditë, një proces i gjatë transmetimi kulturor dhe shpirtëror.

**A ju kanë komplimentuar për llojin e muzikës që prodhoni?**

Dijetari i madh, Mevlana Rumi ka thënë se "Dashuria është ura që lidh vetveten me çdo krijesë tjetër". Sa herë që dikush shpreh një fjalë të mirë, një urim apo një kompliment ajo është në të vërtetë një formë respekti e dashurie, që ju drejtohet dhe për aq kohë sa ajo është e singertë, krijon një dritë mirësie, rrezet e së cilës ngrohin çdo pjesë të qenies. Është kënaqësi kur shikon se njerëzit e duan dhe e vlerësojnë të mirën e të bukurën. Publiku qoftë i huaj, qoftë shqiptar, më ka pritur ngrohtë, kudo që kam qenë.

**Ka pasur ndonjë moment kur keni thënë që do hiqni dorë nga muzika?**

Jo, nuk ka pasur moment të tillë ku kam thënë se do heq dorë nga muzika.

**Motivet fetare janë të pranishme në muzikën që ju e luani me aq pasion. Si është pritur kjo nga publiku?**

Motivet fetare po aq sa janë elemente të dukshëm së jashtmi, janë edhe motivimi i vërtetë i brendshëm. Por, për ta kuptuar më së miri këtë gjë, më lejoni t'ju shpjegoj çila është ndjesia ime për atë çka quajmë në fe. Nëse njerëzit janë të tërë të kri-

juar nga një burim i vetëm, atëherë qëllimi i vetëm i tyre duhet të jetë njohja dhe dëshmimi i këtij burimi, pra me pak fjalë njohja e Krijuesit, e cila rrjedh nga njohja e gjithçkaje, që është pjesë e krijimit të tij, mbi të gjitha njohja e vetvetes. Udhëtimi për tek vetvetja është i gjatë dhe i mbushur me "kodra të mëdha udhëtimi". Poeti i madh Naim Frashëri na kujton se besimi i vërtetë nuk është i shkruar në asnjë libër, përveç se në zemrën e njeriut. Pra feja është besimi i vërtetë dhe unik ku ne drejtohemi tek përmbushja e qenies që mund të vijë vetëm nga njohja se kush jemi, duke e dëshmuar në çdo frymëmarrje të vërtetë në esencës tonë hyjnore, e cila arrihet nëpërmjet rrugës mistike të çdo feje apo besimi. Në muzikën tradicionale mistike të kahershme, si në Shqipëri a gjetkë, kjo gjendje përçohet nëpërmjet përkujtimit të krijuesit sepse pa përkujtim kjo rrugë është si një udhë pa udhë. Falë përkujtimit, i cili quhet dhikr në gjuhën e misticizmit, arrihet një gradë përqendrimi, i cili e ndihmon qenien të arrijë tek shikimi, dëgjimi dhe prekja e esencës së brendshme të tij, falë të cilës Krijuesit dhe krijesa shkrihen dhe bëhen një e vetme. Të gjithë ata që e hapin zemrën e tyre dhe lejojnë të hyjnë në të rrezet e dashurisë, e



## Alba Hoxha pozon me bikini, reagimi i Albi Nakos do ju habitë

**A**ta janë ndër çiftet më të përfolur të momentit. Mesa duket dyshja Alba Hoxha dhe Albi Nako kanë vendosur të mos fshihen më. Çifti është duke përfolur një romancë, që sa vjen dhe po forcohet më shumë. Kjo vihet re edhe në rrjetet sociale. Balerina nuk ka ditur të ndalet me postime në këto të ditë të nxehta. Ajo ka pozuar me bikinin ndanë pishinës. Përveç linjave perfekte, që ka bukuroshja bie në sy dhe komenti i Albit që i thotë "Unë di që do shihemi në 'Klan' për tjetër gjë". Dhe përgjigja e Albës nuk mund të mungonte duke shkruajtur vetëm një fjalë "Kërcim".



## Oriola Marashi u kthehet fotove 'hot'

**N**ëse ju kishin munguar pozat seksi të Oriola Marashit ju japim një lajm të mirë. Bukuroshja kthehet më përvëluese se kurrë. Në postimin e fundit që ka bërë në "Instagram" modelja duket mjaft bombastike dhe sensuale. E veshur me bikinin në ngjyrë leopard dhe duke ndezur një cigare ka lënë këtë mbishkrim në foto: "Nuk e ndeza vendin, thjesht ndeza një cigare!" Oriola është një nga pjesëtarët e grupit OTR që ka rrembyer zemrat e shumë ndjekësve në rrjetet sociale.



presin mirë këtë muzikë dhe duan të përjetojnë më shpesh momente të tilla.  
**Sa e ndjeni mungesën e vendit tuaj?**  
Në shoqëritë tona, fatkeqësisht pa struktura solide shpirtërore dhe materiale, ndjenja e mungesës dhe perceptimi i "vendit të tij" janë çështje komplekse, të cilat lidhen me identitetet e shumta që mbartin, qoftë individuale apo shoqërore. Përplekjet e njeriut për të qenë i lirë nga koncepti i mungesës apo frustracionit i të qenit larg vendlindjes, e ndihmojnë atë të rimëkëmbi identitetin e tij metafizik, për të gjetur vetveten në "atdheun e tij të origjinës". Do të thosha se më shumë se mungesa e vendit tim, më bren mungesa e asaj çfarë ishte thel-

bi i vendit tim dikur, të cilën nuk e gjej dot kollaj në këtë mëri ndryshimesh fizike dhe shpirtërore.  
**Cila është ajo gjë që ju lidh fort me Tiranën?**  
Gjithmonë më ka përmbytur gënia në qytetin e lindjes, Tiranën. Ndjej në të zërat e jehonave e të parëve, e kësaj muzike që ka qenë dhe është gëzim, hare, pasion e mall, e shprehur aq bukur në larminë e melodive, valleve falë fjalëve më të bukura për njerëzit, zogjtë, lulet, dhe gjithçka tjetër. Ajo që më lidh më shumë me Tiranën janë këto kujtime, të cilat janë pasuria më e madhe që mora me vete nga qyteti i lindjes.  
**Përveç muzikës, a keni ndonjë pasion tjetër?**  
Poeti beratas i shekullit të XVIII,

Sulejman Naibi, thotë në një vjershë të tij: "Cullufet e tua - lulet e zymbyllit/ Je vet' bukuria e kopshtit ku ke hy. Pra, ka hak bilbili të shikonj' me sy/ Ta lër trëndafilin, të këndonj' për ty." Këto vargje e ilustrojnë botën e pasioneve që kam sepse ato janë si një baheç ku çdo lule ka bukurinë dhe aromën e saj dhe do të doja ti këndoja siç duhet të tërave por në mungesë të kohës veçoj si pasione artin në përgjithësi, natyrën, misticizmin, dhe udhëtimet.  
**Do të donit të ndryshonit diçka nga rrjedha e kohës?**  
Jo, sepse gjithçka që ndodh është rezultat i vullnetit hyjnor. Urtësia e njeriut qëndron në pranimin e asaj që do të ndodhi, herët a vonë. Si mund ta kuptojmë këtë çështje

kur i japin rëndësi pamjeve dhe formave që duken vetëm me dritën e syrit? Pamja e vërtetë fillon kur njeriu mbyll sytë e trupit dhe hap sytë e zemrës, sepse dashuria shfaqet kudo, në dritë si në errësirë. "Etja e zemrës nuk zhduket me një pikë ujë, por një oqean i tërë nuk mjafton për të shuar etjen time. Verbëria është nën qepallën e syrit, sepse ato nuk janë të mjaftueshme për të parë realitetin. Kur zemra bëhet e pastër si uji qelibar, sheh në pasqyrën e shpirtit tërësinë e qenies". (Vargje të shkruar disa kohë më parë).

### A keni ndonjë peng?

Po, kam pengje. Jeta e njeriut në këtë botë është një udhë me plot mundime. Ai që jeton vetëm për këtë botë, ai ose aty do të mbetet ose dhe më keq do të heqë. Rruga drejt Zotit të Gjithësisë vërtet ka vuajtje e dhimbje, por ai që nuk i tejkalon ato si mundet të arrijë në përjetësi? Rruga e vërtetë është dashuria, dashuria pa pritje, ku ti vetë "vdes" që të jetojë veç dashuria. Dhe këtë gjë njeriu mund ta kuptojë vetëm në varësi të forcës që ai ka për të dashuruar.

### Çfarë mund t'ju kthejë përfundimisht në Shqipëri?

Më vijnë në mendje vargjet e Naim-it, të frymëzuara nga Mesnevia e Rumiut. "Pa dëgjo fyellin ç'thotë/ Tregon mërgimet e shkreta/ Qahet nga e zeza botë/ Me fjalë të vërteta. Që kur se më kanë ndarë/ Nga shok' e nga miqësija/ Gra e burra kanë qarë/ Nga ngashërimit e mija!" Ndonjëherë disa pyetje s'kanë përgjigje, sepse çdo përgjigje është një pyetje në vetvete.

### Cilat kanë qenë duartrokkitjet më të ngrohta që keni rrembyer?

Duartrokkitjet më të ngrohta janë fjalët e disa njerëzve të panjohur, që kanë hyrë në jetën time vetëm për disa caste, por në të vërtetë më duket se ende nuk kanë dalë dhe

fjalët e lotët e tyre i kam ende në vete.

**Çfarë raporti keni me familjarët?**  
Familja është gjëja më e shtrenjtë për mua. Kam fatin të jem baba i një vajze të mrekullueshme që hyn në klasë të parë, bir i dy prindërve të shkëlqyer dhe vëlla i një personaliteti të muzikës shqiptare, Olsi Qinami, që si dhe unë ka zgjedhur të jetojë jashtë vendit, në Angli ku jeton dhe punon si dirigjent dhe pianist. Më së shumti vera na mbledh në Shqipëri ku kalojmë momente familjare të paharueshme.

### Sa ju kanë mbështetur ata?

Familjarët më kanë mbështetur dhe vazhdojnë të më mbështesin vazhdimisht dhe plotësisht. I jam shumë mirënjohës Zotit për këtë gjë dhe përfitoj nga rasti t'i falënderoj nga zemra familjarët e mi.

### Ku keni zgjedhur të pushoni këtë verë?

Prej disa vitësh udhëtoj nëpër Ballkan, kryesisht në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Bosnje-Hercegovinë dhe përherë maniten me bukuritë, traditat dhe njerëzit në rajonin tonë. Kam shumë miq të mirë në këto treva bujare dhe i përsëhdes me mall. Me familjen shkojmë çdo verë diku pranë detit apo liqenit dhe këtë verë kemi zgjedhur detin dhe pishat e Golemit.

### Cilat janë projektet tuaja të fundit?

Projektet e fundit janë angazhimi i ri në punën si pedagog ku tashmë fitova edhe konkursin për të qenë titullar i postit që mbaj dhe pjesëtar i administratës të funksionit publik francez, si dhe projektet të ndryshme si muzikant në bashkëpunim me artistë të ndryshëm nga e gjithë bota dhe nga të gjithë horizontet.

Njollat kafe që shihni në lëkurën tuaj nuk janë thjesht pasojë e moshës, por mbi të gjitha e kohës së ekspozimit në diell.

**H**iperpigmentimi është një theksim i ngjyrit normal të lëkurës me përhapje difuze (nxirja) ose i lokalizuar në disa zona të veçanta (njollat), në origjinë të të cilit qëndron një çrregullim në akumulimin dhe shpërndarjen e pigmentit normal të lëkurës (melaninës).

**ÇFARË NDODH NË LËKURË?**

Një element i rëndësishëm karakterizues i lëkurës sonë është ngjyra apo pigmenti i saj. Përgjegjës për të janë disa pigmente të pranishme në kushte normale në lëkurën tonë dhe secili prej tyre është përcaktues për një kolor specifik si p.sh.:

- **Melanina** është përgjegjëse për ngjyrimet që variojnë nga e verdhë-kafe në të zeze, ndërsa hemoglobina është përgjegjëse për ngjyrimet në të kuqe.

- **Karoteni** është përgjegjës për ngjyrimet në të verdhë-portokalli.

Në kushte normale, rolin kryesor në pigmentimin e lëkurës sonë e luan melanina dhe qelizat përgjegjëse për prodhimin e saj (melanocitet). Melanocitet lokalizohen në shtresën bazale të epidermës (shtresa më e thellë e pjesës së sipërme të lëkurës). Ata prodhojnë melaninën, e cila më pas transportohet drejt qelizave më sipërfaqësore të lëkurës (keratinocitet), duke i dhënë ngjyrën asaj, si dhe kryen funksionin fotombrojtës ndaj rrezatimit diellor.

**DIELLI ËSHTË SHKAKU**


Për ta thjeshtuar, hidhni një sy pjesës së brendshme të kofshës suaj. Nuk ka njolla kafe. Pesë shenjat e plakjes së lëkurës janë njollat kafe, rrudhat, poret e zgjeruara, lëkura e lëshuar dhe shfaqja e enëve të dukshme të gjakut në fytyrë (kapilarë merimangë). Dielli është shkaku kryesor. Me kalimin e kohës, si pasojë e mbiekspozimit në diell, në tilla njolla shfaqen kryesisht në fytyrë, por edhe në trup. Lëkura jonë është përherë e më shumë subjekt i mjaft dëmtimeve nga dielli. Pigmenti i melaninës, i pranishëm në lëkurë e mbron atë në mënyrë natyrale ndaj rrezatimeve UV, por sidoqoftë, me kalimin e moshës, aftësia mbrojtëse natyrale ndaj rrezatimeve UV e lëkurës bie dhe për pasojë, njollat e moshës apo të diellit shfaqen më shpesh.

# Njollat kafe, pasojë e moshës apo nxirja diellore



**A JANË TË GJITHA E NJEJTA GJË?**

Ka tipa të ndryshëm njollash kafe, që shfaqen në lëkurë. Grupet kryesore janë njollat kafe nga dielli apo të moshës (solar lentigines) dhe qukat (ephelides). Njollat kafe apo të moshës janë më të mëdha, shfaqen kryesisht në fytyrë dhe duar, tek personat e moshës së mesme, si pasojë e dëmtimeve nga rrezatimi diellor. Ato kanë tendencë të persistojnë më gjatë dhe nuk zhduken gjatë dimrit. Shfaqen zakonisht tek personat me lëkurë të bardhë, por janë gjithashtu të shpeshta tek personat që nxihen lehtë dhe që kanë lëkurë të errët. Qukat janë njolla kafe të sheshta, që shfaqen në lëkurë dhe në pjesët e ekspozuara ndaj diellit që në moshë të vogël. Ato janë pasojë e grumbullimit të lokalizuar të melaninës në qelizat e lëkurës (keratinocite) dhe shihen kryesisht tek personat me lëkurë të bardhë dhe flokë të kuq ose biondë. Janë më evidente gjatë verës dhe zbehen dukshëm ose mund të zhduken gjatë dimrit.



Një grup të veçantë përbën Melasma ose Chloasma ose e njohur ndryshe si "maska e shtatzënisë". Janë njolla të errëta ose kafe të lëkurës, që shfaqen te gratë shtatzëna ose tek ato që marrin terapi hormonale zëvendësuese (kontraktive). Lokalizohen kryesisht në faqe, hundë, ballë dhe buzën e sipërme. Ato kanë tendencë të përkeqësohen me kalimin e kohës dhe të bëhen persistente edhe pas shtatzënisë.

**A JANË TË RREZIKSHME?**

Gjëja më e rëndësishme që mund të bëni kur shihni një njollë të pigmentuar në lëkurën tuaj është të mos e neglizhoni i atë. Nëse dalloni një njollë në lëkurën tuaj e sidomos nëse ka ndryshuar ngjyrën apo formën, ju duhet të konsultoheni me një dermatolog, i cili do të përcaktojë natyrën e saj dhe më tej trajtimin e duhur.

**A SHKAKTON NXIRJA E LËKURËS NJJOLA KAFE?**

Lëkura e nxirë nuk është një

lëkurë e shëndetshme. Nxirja është mënyra e trupit që na tregon se lëkura jonë është dëmtuar dhe si e tillë, ajo bën një tentativë për të mbrojtur veten nga dëmtimi i mëtejshëm. Ky dëmtim çon në shfaqjen e njollave të ndryshme në lëkurë.

**TRAJTIMI**

Për trajtimin e njollave kafe, dermatologët kanë në dispozicion një sërë preparatesh me aftësi depigmentuese. Ndër principet më të rëndësishme, përmendim arbutininë (hydroquinone-beta-D-glucozid), alfavitaminë (acid laktik, glikolik dhe laktobionik), acidin azelaik, acidin retinoik (Go gjatë shtatzënisë), acidin elagikoid, vitaminën C etj., të cilat gjenden kryesisht të formuluar në trajtë kremi, solucioni apo xhel. Ndërkohë që dermatologët, për të trajtuar hiperpigmentimet, përdorin sot edhe metoda të tjera, si: lazerin, krioterapinë, peelingun dhe mikrodermoabrazionin.

**KREMRA ME FILTËR SOLAR GJITHË**

**DITËN, ÇDO DITË**

Trajtimin të hiperpigmentimeve, dermatologët i bashkëngjisin pothuajse gjithmonë edhe kremrat fotombrojtës me SPF 30-50, që jo vetëm ruajnë efektin e agjenteve depigmentuese, por edhe sepse kjo do t'i mbrojtë ndaj dëmtimeve të mëtejshme dhe shfaqjes së njollave kafe. Edhe nëse ke lëkurë të dëmtuar nga dielli, qoftë edhe shumë evidente, nuk është kurrë shumë vonë për t'u mbrojtur. Kujdes! Pjesa më e madhe e dëmtimit nga dielli ndodh kur ngasim makinën. Xhami i makinës bllokton 100% rrezet UVB (të cilat shkaktojnë djegien e lëkurës) dhe aspak ato UVA, rrezet shkaktojnë të plakjes së lëkurës dhe të dëmtimeve nga dielli. Duhet theksuar se çdo rast me hiperpigmentim përbën një rast specifik dhe si i tillë, duhet trajtuar në mënyrë specifike dhe vetëm nga një mjek dermatolog. Dermatologu është trajtuesi i vetëm që merr përsipër të trajtojë problemin dhe pasojat që mund të rrjedhin nga trajtimi.

## Grida Duma si një modele, deputetja surprizon me pamjen e saj

Është padyshim nga deputetet më të hijshme në Kuvendin e Shqipërisë dhe ky fakt i është vënë shumë herë në dukje. Por këtë radhë, Grida Duma surprizon. Deputetja demokrate ndodhet në Itali në një ceremoni martesore nga ku dalin fotot me një fustan të gjatë të zi dhe tepër elegante. Një dekolte fine mbështjelle në tyl ia shton hijeshinë fustanit, ndërkohë që zonja Duma më shumë se sa një deputete, duket si një modele.



## Thaçi me Pacollin ngrenë dolli në Shëngjin, Haradinaj është në Jalë

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka preferuar bregdetin e Jalës në Vlorë, presidenti Hashim Thaçi është fotografuar këtë fundjavë në Shëngjin. Presidenti i Kosovës shoqërohet nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm, Behgjet Pacolli. Thaçi ka vendosur një kapele në kokë, por shihet mirë që është ai. Nderkohë, ministri i Jashtëm ka postuar edhe foto në "Facebook". "Drekte e këndshme në Shëngjin me Presidentin e R.K, Hashim Thaçin". Me ta ka qenë edhe Baton Haxhiu, analisti i cili mbështet tezën e presidentit Thaçi.



# BULEVARDI

Na merrni seriozisht! 😊

## POLITIK



## Erla Mëhilli bëhet nënë për herë të dytë, djali quhet Bind

Erla Mëhilli është bërë nënë për herë të dytë, duke sjellë në jetë sërish një djalë. Lajmin e ëmbël e ka dhënë vetë ish-zëdhënësja e Partisë Demokratike me anë të një postimi në "Instastory". Erla ka postuar një foto të djalit të saj të madh, së bashku me vogëlushin e saj, që erdhi në jetë vetëm dy ditë më parë, më 12 gusht. Erla ka zgjedhur ta quajë Bind, domethënia e të cilit është personifikimi i perëndisë ilire të ujërave, Bind (siç kishin grekët Poseidonin ose romakët Neptunin). Në burimin Privilica pranë Bihac janë gjetur altarët kushtuar Bindit (faltore ku fisi ilir Japodët sakrifikonin dhite për nder të tij. Kujtojmë që ish-zëdhënësja e PD-së u bë nënë për herë të parë në vitin 2014 dhe sollti në jetë një djalë, të cilin e pagëzoi me emrin, Akid..



## Ministri norvegjez anti-emigrant bie në dashuri me refugjaten

Ministri norvegjez i Peshkimit më përpara ka qenë një ksenofob, fetë dhe kulturat e ndryshme nuk duhet të përzihen, duke kërkuar jo pak herë largimin e të huajve nga shteti i tij. Por më pas, ai takoi atë, ish-"Miss Iranin", Bahareh Letnes, një refugjate në vendin e tij, e cila sot është e fejuara e tij. Në vitin 2008, ajo ishte në gjendje të merrte statusin e refugjatit në vendin skandinav falë dhe këmbënguljes së nënës së saj adoptive shkruan "Repubblica.it". Pavarësisht distancës, lidhja që Letnes mbante me vendlindjen ishte e fortë, duke marrë pjesë në disa konkurrues bukurie, duke fituar edhe disa trofe si "Miss Irani" në 2013-ën, "Miss Globe" në Iran në vitin 2014 dhe "Miss Grand International" në Iran në të njëjtin vit. E nga një konkurs në tjetrin, ata takohen dhe mes tyre lindin shkëndijat e para.



Lista e tretë me pronarët që do të kompensohen për tokat e sekuestruara në '45-ën

Ornela Manjani

# Buxheti, 15 miliardë lekë për pronarët, 5 mijë përfitues në të gjithë vendin

## ATP ka miratuar kompensimin për dosjet 2001-2014

Qeveria ka miratuar një fond prej 15 miliardë lekësh, të cilat do të shpërndahen për të paguar 5 mijë pronarë, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit të pronës dhe s'kanë marrë deri tani asnjë këst. Fondi është i ndarë në tri vite 2019-2022, i cili rritet progresivisht vit pas viti. Në projektbuxhetin afatmesëm është miratuar fondi për vitin 2019 në vlerën 4,9 miliardë lekë, për vitin 2020 në vlerën 5,3 miliardë lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 5,4 miliardë lekë. Sipas ligjit në fuqi, pronarëve që u është njohur e drejta për kompensim do të marrin 20% të vlerës në lekë dhe pjesën tjetër 80% kompensim me

tokë. Ndërkohë pronarët mund të aplikojnë për të përfituar nga skema për pagesa të përshpejtuara.

### TRI AFATET

Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqind-

ja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht ren-

dit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i

kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese që shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit finan-

ciar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

### PËRFITUESIT NË TË GJITHË VENDIN

32	Dibër	DIELLI, TEUTA SHEHI (URUÇI)	4,301,186
33	Elbasan	LUMNIS ÇELA	-80,809,858
34	Fier	Shpresa Mina	
35	Fier	Drita Meta	18,044,856
36	Fier	Koçi Stroni	9,669,750
37	Fier	Rexhep Kuçi	3,578,561
38	Gjirokastrë	At.Thanas Qerimi	
39	Vlorë	Gëzim Braka	
40	Berat	Alfred Shabani	5,481,000
41	Berat	Enrieta Lako	7,028,422
42	Berat	Petraq Marini	
43	Fier	Viktor Zaka	27,330,400
44	Fier	Nuri Koreshi	5,014,240
45	Gjirokastrë	Ismail Kuka	16,662,681
46	Gjirokastrë	Sokol Musa Mane	8,489,600
47	Korçë		768,000
48	Lezhë	Brahim Leknikaj	
49	Korçë	Drita Zeqir Xhimanki	500,000
50	Korçë	Fadile Pallani (Rovi)	5,451,040
51	Berat	Pëllumb Veçani	
52	Korçë		
53	Berat	Jorgji Xhaxha	3,532,200
54	Tiranë	BAJRAM,KADRI ALIMEHMETI	10,514,133
55	Korçë	Gjenci Ligor Xhufka	4,506,300
56	Korçë	THOMA ALUSHI	16,465,000
57	Vlorë	Aranit Gega	1,054,825
58	Vlorë	Shpetim Sharra	
59	Elbasan	MERJEME ISMAILI	
60	Korçë	Eqerem Vesel Bajram	1,231,600
61	Lezhë	Agustín Lucaj	652,538
62	Elbasan	ISMETE GRIPSHI	
63	Gjirokastrë	Vangjel Jorgo Tasi	844,200
64	Gjirokastrë	Vasil Dede	-2,784,192
65	Gjirokastrë	Dhimiter Vasil Dede	5,824,640
66	Vlorë	Lavdie Qesari	-20,779,850
67	Gjirokastrë	Lefteria Bako	-69,752
68	Berat	Sami Cufe	1,290,384
69	Gjirokastrë	Vangjel Dhimiter Kacifa	-117,248
70	Vlorë	Dejvin Sharra	-122,746,891
71	Berat	Veli Salilari	21,524,090
72	Berat	Mustafa Xherimeja	8,047,935
73	Korçë	Bilal Hysi	
74	Korçë	Kike Qamil Mankolli	810,000
75	Durrës	Bashkim Belegu	48,752
76	Korçë	LULE NAUNI(MEHMETI)	
77	Tiranë	Vath Nuredin Ibra	6,580,000
78	Fier	Agim Velaj	17,405,550
79	Korçë	Valentina Trebiska	0
80	Tiranë	FLUTURA SOKOLI	11,384,730
81	Korçë	Isuf Selim Limonas	4,633,000
82	Korçë	Zhaneta Koste Nasi	68,921
83	Korçë	Qamiran Tahir Klomollari	
84	Gjirokastrë	Avdul Kadri dhe trashegimtarët e tjerë	Kazma -5,916,544
85	Dibër	Ndue Lalaj	
86	Tiranë	SHYQYRI HYSKJA	73,665,900
87	Berat	Iskra Myftari	42,432,000

88	Berat	Koci Beqollari	958,608
89	Gjirokastrë	Dashamir Gega	-12,896,143
90	Gjirokastrë	Hiqmet Hajri Hodo	374,535
91	Korçë	Gaço Bola Lola	848,600
92	Durrës	Sulejman Kapedani	5,696,000
93	Durrës	Sulejman Kapedani	23,751,000
94	Durrës	Sulejman Kapedani	7,120,000
95	Berat	Agron Ago	72,270,030
96	Berat	Gjylishah Shkurti (Vrioni)	8,853,641
97	Durrës	Mehmet Kasmi	31,680,000
98	Korçë	Eqerem Vesel Bajrami	18,660,000
99	Dibër	Veli Çipuri	-10,424,011
100	Dibër	Hysni Çipuri	-4,083,789
101	Dibër	Ali Çipuri	-2,186,683
102	Dibër	Ali Çipuri	-4,713,584
103	Fier	Agim Jaupaj	1,967,385
104	Korçë	MYNEVER LUFO (HADRI)	479,400
105	Korçë	Petraq Nase	378,018
106	Gjirokastrë	Jorgji Mit'hat Lahe	-124,124
107	Dibër	Kaplan Stojku	250,355
108	Gjirokastrë	Foto Andonija	1,175
109	Korçë	Irma Tomco	680,000
110	Elbasan	ARBEN HOXHA	3,760,000
111	Gjirokastrë	Barjam Mehmetaj	-8,705
112	Durrës	Erqan Hysni Tivari, Vezir Barolli	5,205,200
113	Elbasan	BEDRI BEHELULI	-6,204,618
114	Lezhë	Llesh Geg Perla	8,942,065
115	Kukës	Bajram Ahmet Baboçri	
116	Kukës	Ramadan Bek Baboçri	
117	Korçë	Dhori Janaq Bendo	3,180,000
118	Gjirokastrë	Shpetim Alite	161,910,400
119	Gjirokastrë	Shpetim Alite	
120	Elbasan	NAJDA PEPEKAJ	2,680,440
121	Gjirokastrë	Niqifor Miltiadh Gjoka	-171,728
122	Korçë	Lumke Duci (Hibo)	6,000,120
123	Korçë	Aslan Shefki Sulçe	10,491,000
124	Tiranë	FADIL ZELA	1,144,800
125	Gjirokastrë	Jorgji Kulla	-347,495
126	Korçë	Fatmir Qamil Pallani	
127	Korçë	Fatmir Sefedin Metko	
128	Elbasan	ETHEM LULJA	2,733,200
129	Durrës	Mahmut Bobrati	
130	Korçë	Kostandin Thimi Peco	400,000
131	Korçë	Agim Hasan Shalli	8,815,000
132	Korçë	Jordan Xoga	2,399,000
133	Tiranë	AFERDITA XHEPA (HUTA)	10,060,000
134	Korçë	XHUVI PELTEKU	-36,998,115
135	Berat	Ervin Selman Numani	301,176
136	Berat	Agron Veli Spahiu	3,772,755
137	Korçë	Ramadan Haxhi Mukollari	376,320
138	Durrës	Luljeta Çelkupa	
139	Durrës	Luljeta Çelkupa	
140	Durrës	Luljeta Çelkupa	
141	Durrës	Luljeta Çelkupa	10,586,728
142	Berat	Jorgji Toli Myzeqari	1,015,000
143	Berat	Dhimitër Petro Gjini	
144	Kukës	Drita Ali Duki	
145	Kukës	Qemal Hajredin Gjana	

146	Berat	Qemal Hysen Bega	9,551,300
147	Gjirokastrë	Vasil Thomollari	168,000
148	Gjirokastrë	Vasil Thomollari	5,817,952
149	Gjirokastrë	Vasil Thomollari	896,000
150	Korçë	Vangjel Koço	
151	Berat	Sefedin Fuga	2,888,690
152	Berat	Spiro Butka	812,000
153	Berat	Petraq Angjellar Simsia	4,082,608
154	Elbasan	SPIRO BICI	4,571,820
155	Gjirokastrë	Skender Nelaj	28,700
156	Korçë	Bardhyt Maellari	-32,180,574
157	Korçë	PETRIT KRISTAQ KOLE	-45,182,205
158	Fier	Luto Behari	10,537,300
159	Fier	Ramadan Merka	73,867,400
160	Fier	Hekuran Gjyshia	3,279,640
161	Vlorë	Besnik Harizaj	
162	Kukës	Sazan Shemsi Deda	
163	Elbasan	FATMIR BUFI	
164	Berat	Dhimitër Qyli	1,092,624
165	Berat	Mitri Arapi	0
166	Berat	Kozma Llambi Stasa	11,409,615
167	Elbasan	SHABAN XHEMALI	1,161,610
168	Tiranë	BARDHYL GORANI	48,113,289
169	Korçë	Vasilqaj Petraq Kolaci	850,000
170	Korçë	THIMI ROBO	19,800
171	Gjirokastrë	Bashkim Zace	-16,081,314
172	Lezhë	Gjon Llesh Tusha	
173	Lezhë	Pjeter Preng Jaku	
174	Gjirokastrë	Sefer kaco	
175	Lezhë	Zef Ndue Dudi	1,600,940
176	Korçë	Stavri Vasil Kosta	2,409,600
177	Durrës	Sinan Ganaj	96,950
178	Elbasan	LUFTARAKE QATIPI	1,410,000
179	Tiranë	Najada Hoxha	3,458,448
180	Gjirokastrë	Trashegimtarët	173,360
181	Gjirokastrë	Kujtim Bejra	850,200
182	Shkodër	Bedri Bushati	15,480,000
183	Tiranë	GEZIM SULSAROVA	8,220,800
184	Korçë	Zyfi Xhevit Avdoli	10,295,710
185	Dibër	Lek Rica	634,410
186	Gjirokastrë	Jorgo Qirjaqi	91,200
187	Gjirokastrë	Reit Zeqaj	2,576,448
188	Korçë	NASHILDA SHYTI	14,650,680
189	Korçë	BASHKIM JASHARI BEKIM GUXHOLLI	1,536,000
190	Tiranë	IDA KRIPA (AGAJ)	71,634,061
191	Fier	Gjergji Dhima	5,824,000
192	Gjirokastrë	Luan Islami	5,054,735
193	Korçë	Ylber Duro	124,000
194	Korçë	AGRON ORHANI	
195	Korçë	Çelnik Capo	-2,339,372
196	Fier	Vasilefsku Stamo	58,113,900
197	Fier	Illirjan Gjoni	1,099,538
198	Fier	Shefit Zotaj	
199	Fier	Osman Jazo	12,623,000
200	Durrës	Mirushë Gobja (Sheqerja)	
201	Fier	Fasli Zdrava	
202	Gjirokastrë	Xhavid Omari	
203	Gjirokastrë	Elmaz Blliku	

2,856,000			
204	Gjirokastrë	Gramoz Blliku	
1,116,304			
205	Korçë	EQEREM BAJRAMI	14,310,048
206	Gjirokastrë	Trashegimtarët	
207	Gjirokastrë	Elisabeta Kruja	8,512,000
208	Tiranë	BASHKIM BEKTESHI	142,732,800
209	Gjirokastrë	Nado Dudumi	
210	Gjirokastrë	Kristaq Nasi	0
211	Korçë	Alfred Molla	2,484,096
212	Elbasan	LULJETA HALILI	3,535,628
213	Dibër	MIRVET NURAJ	72,657
214	Shkodër	Kujtim Marashi	
215	Korçë	Flora Apostol Bica	710,000
216	Fier	Sabire Halili	41,217,300
217	Korçë	Agim Danglli	1,749,380
218	Vlorë	Filip Sota	489,600
219	Berat	Jorgji Karaja	28,420,000
220	Berat	Destimona Maksut Zhiti	11,236,050
221	Korçë	Nardi Martini	345,154
222	Elbasan	JORGJISANTO	
223	Elbasan	JORGJISANTO	
224	Korçë	Dhimitraq Vasil Ballauri	
225	Dibër	NDRECMENGA	
226	Lezhë	NDRECMENGA	1,812,726
227	Dibër	NDRECMENGA	474,240
228	Durrës	Eqerem Dedeja	
229	Durrës	Eqerem Dedeja	
230	Korçë	Vangjel Koço	2,300,000
231	Korçë	Robert Papi	-32,820
232	Durrës	Fuat Bilali, Mustafa Fani, Syrry Fani	328,855,200
233	Durrës	Petrit Gjeçi	0
234	Korçë	Kostaq Filip Kajno	1,900,000
235	Durrës	Shpëtim Metani	
236	Durrës	Shpëtim Metani	8,646,660
237	Vlorë	Vladimir Gjomeza	0
238	Korçë	Lumturije Shkulaku	5,100,000
239	Korçë	Illirjan Roshanji	
240	Korçë	Donika Spiro Ristani	800,000
241	Berat	Mehdi Dervishi	
242	Korçë		2,334,528
243	Berat	Përparim Alizoti	
244	Berat	Dhimitër Kolovani	28,420,000
245	Berat	Eqerem Risilia	125,460,000
246	Tiranë	ETHEM RRAKLLI	1,579,200
247	Tiranë	ETHEM RRAKLLI	8,225,000
248	Berat		-8,423,107
249	Berat	Eliane Tullon	11,171,374

250	Berat	Tefta Ndini Bufi	2,917,200	339	Gjirokastrë	Kristo Noto73,800	427	Gjirokastrë	Kujtim Çobani	513	Korçë	Ali Qazim Dule	915,088			
251	Berat	Theodor Lili Gjogu	1,756,860	340	Gjirokastrë	Gramoz Blliku	965	428	Dibër	HAJRULLAH NASUFI	514	Durrës	Vath Tonuzi	523,160		
252	Durrës	Hysni Vogli 636,400	341	Durrës	Sherif Koçi	2,373,000	429	Korçë	Sali Qamil Tanasica	4,352,000	515	Korçë	Ali Qazim Dule	523,160		
253	Durrës	Hysni Vogli 118,400	342	Durrës	Sherif Koçi	4,071,000	430	Korçë	Arben Shushi	400,000	516	Gjirokastrë	Dashmirë Cuberri			
254	Gjirokastrë	Hasan Xhelaj		343	Durrës	Sherif Koçi	3,510,000	431	Korçë	Lumturije Meço	-2,090,720	517	Korçë	Klara Aleko Bibolli	3,071,000	
255	Korçë	-402,862,700	344	Gjirokastrë	Sefer Kaso	369,600	432	Kukës	Rexhep Sallah Cena		518	Korçë	Petrina Panariti	650,000		
256	Korçë	Anida Agim Kordha	484,000	345	Korçë	Vasillaq Nasi Pallari	16,586,430	433	Gjirokastrë	Irinofilo Jorgaqi	-1,280	519	Korçë	ALI DULE		
257	Gjirokastrë	Kristi Cela	678,048	346	Gjirokastrë	Qemal Hasanbegaj	164,619	434	Tiranë	SHABAN ABDYL TAHIRI		520	Durrës	Ylli Rameta	0	
258	Gjirokastrë	Telat Zhuzhuni	12,160,000	347	Gjirokastrë	Harallamb Gazhani		435	Gjirokastrë	Aristotel Paguna	9,120	521	Shkodër	Guljem Gjon Serreqi		
259	Vlorë	Ervin Lelo	2,937,600	348	Gjirokastrë	Stavro Rafti	115,416	436	Gjirokastrë	Besnik Skenduli		522	Shkodër	Guljem Serreqi		
260	Durrës	Seit Kura		349	Tiranë	KARROCI	197,752	437	Gjirokastrë	Engjellushe Tuqi		523	Shkodër	Guljem Gjon Serreqi		
261	Korçë	Illa Kristaq Pazolli	171,060	350	Berat	Agron Dyrmo, Perparim Dyrmo		438	Tiranë	NAIM TARJA	17,920,000	524	Berat	Sadik Xhaferaj	3,260,304	
262	Korçë	EMIL MBORJA	3,160,000	351	Fier	Hysen Korçari	8,736,000	439	Elbasan	XHEZAR DOSKU	1,009,548	525	Shkodër	Teuta Gjylil, 1776,060		
263	Korçë	Floresha Guxholli	-10,471,212	352	Gjirokastrë	Jani Thomollari	55,296	440	Korçë	Eliverta Lubonja	1,627,000	526	Shkodër	Guljem Serreqi		
264	Korçë	Astrit Ferit Rexhollari		353	Gjirokastrë	Edmond Kokalari		441	Korçë	Nikollaq Tona	1,888,380	850,500	527	Shkodër	Guljem Serreqi	
265	Elbasan	ZHANETA DERVISHI	2,258,202	354	Lezhë	Pal Vata	12,694,800	442	Tiranë	EQEREM DEDEJ	14,476,000	528	Shkodër	Teuta Salim Saraci		
266	Durrës	Xhevdet Tropini		355	Lezhë	Fadil Tahir Dushku		443	Korçë	Valbona Hyllmi Pandillil	100,000	2	Gjirokastrë	Orest Cabeli		
267	Durrës	Xhevdet Tropini		356	Lezhë	Gjergj Pal Shyti	8,360,000	444	Korçë	Pertef Dilka	33,812,100	1,070,300	3	Korçë	Ali Qazim Dule	
268	Durrës	Xhevdet Tropini	5,085,000	357	Lezhë	Preng Filipati	205,800	445	Korçë	Ylson Haxhi	31,280,000	4	Gjirokastrë	Pavlo Andon Mici	252,095	
269	Durrës	Xhevdet Tropini		358	Tiranë	Hilda Basha (Bendo)	6,720,000	446	Korçë	SILLVER PLASA	1,368,900	5	Korçë	Ali Qazim Dule	490,600	
270	Durrës	Xhevdet Tropini		359	Tiranë	Hilda Basha (Bendo)	42,560,000	447	Korçë	LIRI IDRISLLARI	17,650,000	6	Korçë	Burbuqe Sadikaj	774,528	
271	Durrës	Mustafa Tropini		360	Durrës	Andon Ilija Tapia	14,292,000	448	Korçë	Qani Dishnica	6,810,000	7	Gjirokastrë	Mihal Koco Bisbiqi		
272	Vlorë	Pjetera Çika	3,630,000	361	Berat	Ndoni Boce	7,741,800	449	Tiranë	HAMZA ÇOPA	13,160,000	946,656	8	Durrës	Xhumaje Guza	
273	Vlorë	Pjetera Çika		362	Elbasan	ARIF SHYTI	1,108,890	450	Tiranë	LILIKOVI	8,693,000	9	Durrës	HILDA BASHA	9,336,320	
274	Durrës	Nezmi Metalla	1,985,000	363	Elbasan	ZVLYF PASHJA	403,965	451	Berat	Dine Mullita	267,960	10	Durrës	Ibrahim Muharremi(Hyka)		
275	Durrës	Mustafa Tropini		364	Gjirokastrë	Paskal Konomi	1,352,470	452	Korçë	Ilazar Dhimetri Piluri	800,000	2,067,471	11	Durrës	Ibrahim Muharremi(Hyka)	
276	Fier	Liri Çela	37,391,000	365	Durrës	Bledar Kurti		453	Vlorë	Dejvin Sharra	-19,930,632	5,273,028	12	Gjirokastrë	Kristo Papa	
277	Fier	Spiro Stergio	12,912,000	366	Berat	Agron Dyrmo, Perparim Dyrmo	26,177,053	454	Berat	Kozma Pushi	3,723,832	5,862,184	13	Korçë	Sotirajq Bimbi	178,752
278	Elbasan	JORGJI SANTO	2,664,000	367	Korçë	Syrja Qemal Pasho	6,130,800	455	Korçë	AXHI DOKOLLARI	570,240	14	Gjirokastrë	Vasil Kosta Qiqi	3,841,040	
279	Gjirokastrë	Vito Hila	-209,800	368	Durrës	Nexhmi Kosova	10,123,500	456	Elbasan	ADOR DIBRA	42,733,872	15	Korçë	Safet Zet Berberi	-43,467,948	
280	Korçë	Sofika Mihal Rrodhe	-13,272,500	369	Tiranë	BELOSHAI		457	Korçë	Beqir Topciu	0	16	Gjirokastrë	Nasho Kosta Gagali		
281	Gjirokastrë	Liko Londo		370	Berat	Nikollas Llongoraj	87,843	458	Shkodër	Guljem Serreqi	836,550	2,905,152	17	Elbasan	HYSEN KOVAÇI	
282	Korçë	DONIKA BLACERI	384,000	371	Durrës	Lin Priska		459	Tiranë	SKIFTER KARAZI	-5,179,000	18	Gjirokastrë	Hasan Xhelaj		
283	Fier	Ymer Mezini	667,120	372	Durrës	Bashkim Merkaç, Genciana Çurçiali		460	Vlorë	Muhedin Bego	-34,342,896	19	Korçë	Bashkim Myrteza	20,995,000	
284	Fier	Mirije Muço	42,979,200	373	Durrës	Bashkim Merkaç, Genciana Çurçiali	5,955,000	461	Korçë	Njazi Bylykbashi	21,380,680	20	Durrës	Rexhep Qerimi	11,963,595	
285	Korçë	Ferzi Zet Blaceri		374	Korçë	SPIRO GJANCI	900,000	462	Korçë	Dhimitri Ilo Deti	925,000	21	Durrës	Fatos Bardhi, Myslym Zenuni		
286	Gjirokastrë	Neklo Kuci	-16,873,060	375	Korçë	Haki Feti Haxhillari	3,989,704	463	Elbasan	LIRIJAN DASHI	2,284,756	22	Durrës	Fatos Bardhi, Myslym Zenuni		
287	Korçë	Ligor Visi	6,873,800	376	Gjirokastrë	Cajup Shehu		464	Berat	Myrteza Salillari	22,323,098	23	Tiranë	Hilda Basha (Bendo)	7,854,784	
288	Korçë	Pavli Mato	603,648	377	Dibër	Asllan Hoxha	-32,549,001	465	Berat	Nuri Shahu		24	Durrës	Mustafa Tropini	17,025,000	
289	Korçë	MUHARREM NIAZI MULLA	4,898,250	378	Korçë	Ferik Berberi	-10,097,145	466	Gjirokastrë	Eda Dushallari		25	Berat	Ajet Arapi	36,666,400	
290	Berat	Ahmet Qojle, Ali Bardhoshi	2,104,197	379	Berat	Zalo Qato		467	Durrës	Vasil Vava (Kasapi)	121,192,500	26	Fier	Abdy Kumani		
291	Fier	Pellumb Kurteshi	6,429,100	380	Elbasan	TASIM, QEMAL, AQIQ XHIKA		468	Fier	At.Dhimiter Rredhi	186,527,432	27	Fier	Agim Lalaj	30,148,360	
292	Fier	Tefta Demeci	11,432,500	381	Berat	Fadil Nallbani	1,141,959	469	Gjirokastrë	Seit Bendo	3,936,200	28	Durrës	Murat Xheladini	1,475,500	
293	Gjirokastrë	Tasim kokaj	5,923,344	382	Korçë	Tomor Arolli	8,006,400	470	Gjirokastrë	Ikonom Vasil Thomollari	4,423,500	29	Durrës	Murat Xheladini	5,448,000	
294	Korçë	QANI DEMIRI		383	Durrës	Xhumaje Guza		471	Gjirokastrë	Gramoz Blliku	153,255	30	Durrës	Murat Xheladini	3,405,000	
295	Korçë	Rozalina Vangjo Bardhyli	16,263,360	384	Durrës	Sali Kadrimi	1,687,632	472	Gjirokastrë	Gramoz Blliku	153,255	31	Berat	Neim Salaj	203,000	
296	Elbasan	NICA KONDULI	2,808,080	385	Durrës	Adriatik Gjashta	-30,274,400	473	Korçë	Arben Berberi	61,210	32	Korçë	Eqerem Kllomollari	8,355,660	
297	Berat	Fetos Zeko	24,388,000	386	Durrës	Xhavit Xhafa		474	Korçë	Skënder Qamil Mallkazi	1,662,226	33	Korçë	Diana Fallo	250,000	
298	Durrës	Miranda Rruga	46,280,000	387	Korçë	Adriana Kosta Andon	300,000	475	Korçë	Skënder Qamil Mallkazi	1,662,226	34	Korçë	Grigor Kastriot Zoraj	3,300,000	
299	Korçë	FERIT ZALO AHMETI	830,000	388	Korçë		300,000	476	Shkodër	Guljem Serreqi	9,072,000	35	Shkodër	Guljem Serreqi	3,240,000	
300	Tiranë	SHKENDIE LLAGAMI	2,016,000	389	Durrës	Avdulla Mema	5,850,000	477	Shkodër	Guljem Serreqi	3,110,400	36	Korçë	Teqi Berberi	-10,964,352	
301	Durrës	Muhamet Hida	19,815,000	390	Durrës	Avdulla Mema	49,080,000	478	Korçë	Reis Refat Dokollari	362,880	37	Fier	Kosta Daka		
302	Korçë	Hyrije Riza Lila	4,273,728	391	Fier	Loreta Rezhda	473,000	479	Berat	Kozma Nova	42,918	38	Fier	Ali Kosova		
303	Elbasan	ARJAN GURAZIU	39,564,840	392	Korçë	Nexhat Halila	-6,927,265	480	Fier	Shefki Zoto		39	Berat	Halit Bushi	32,661,482	
304	Durrës	Burbuqe Haveriku	25,450,500	393	Korçë	Illa Bode	-30,984,456	481	Fier	Luçi Dano	8,870,006	40	Vlorë	Veli Harizaj		
305	Durrës	Dode, Tom, Gjok Ujkaj	66,783,000	394	Elbasan	ALEM SHA HOXHA	1,190,992	482	Korçë	VASIL DEMIRI		41	Berat	Aleksandër Kallidremxhiu		
306	Durrës	Gjelosh Ujkaj		395	Elbasan	ALEM SHA HOXHA	6,887,664	483	Korçë	Vangjel Sotir Nunka	551,732	3,400,250	42	Korçë	Aurel Pelteku	5,719,750
307	Durrës	Hamdi Mati		396	Elbasan	SULEJMAN MUSTAFI	375,815	484	Korçë	Arben Shushi	551,732	43	Fier	Hijmet Patozi	8,000	
308	Berat	Rashela Sollaku		397	Korçë	XHEVAT FETO	34,881	485	Korçë	Arben Shushi	551,732	44	Korçë	Grigor Mulla	800,000	
309	Korçë	VASHI, TUSHI LLLAKMANI	418,176	398	Korçë	Mitika Burnazi	31,680	486	Korçë	Ylvie Goxholli	1,573,650	45	Shkodër	Neeritan Saraçi	1,215,000	
310	Durrës	Sali Elezi	2,465,450	399	Fier	Aferdita Sulka		487	Gjirokastrë	Lefterja Bako	66,228	46	Gjirokastrë	Mihal Baxheli	10,144	
311	Berat	Rashela Sollaku	3,349,500	400	Gjirokastrë	Arjeta Nuri Ceka		488	Shkodër	Guljem Serreqi	1,080,000	47	Gjirokastrë	Kristaq Pullo	1,529,120	
312	Berat	Rashela Sollaku	72,065,000	401	Korçë	ILIRJAN QIRAXHI	8,200,000	489	Korçë	ARBEN ZHAMO		48	Gjirokastrë	Vladimir Pelivani	100,100	
313	Durrës	Besnik Shehu	19,254,500	402	Elbasan	ILIA MEMA	36,364,710	490	Korçë	Rita Engjellush Kucana	23,079,200	49	Korçë	Illa Bode	0	
314	Korçë	Osman Hoxha	15,847,000	403	Elbasan	EDUARD SHMILI	4,084,480	491	Korçë	Rita Engjellush Kucana	23,079,200	50	Shkodër	Guljem Gjon Serreqi	2,430,000	
315	Gjirokastrë	Jani Thomallari		404	Gjirokastrë	Gramoz Blliku	1,277,300	492	Korçë	Cijeta Sami Panariti	41,100,000	51	Berat	Engjell Myteveli, Gjylis Shah rioni	6,739,600	
316	Gjirokastrë	Mit Cani	2,255,232	405	Korçë	Nafije Cacani	6,685,100	493	Tiranë	ALIMEHMETI	194,210,100	52	Berat	Gonilda Kreku, Mirela Nose	803,136	
317	Korçë	Muazes Tefik Agolli (Backa)	4,183,200	406	Shkodër	Valdet Ago (Trashani)	527,682	494	Fier	Caush Kociu	19,860,932	53	Gjirokastrë	Antigoni Mezzini	11,070	
318	Korçë	Vladimir Kasem Buzo	1,800,000	407	Gjirokastrë	Nevila Konomi	1,344,000	495	Korçë	Maksim Trojani	1,680,000	54	Korçë	Eqerem Bezati	0	
319	Durrës	Muhamet Buzo	15,723,000	408	Shkodër	Guljem Serreqi		496	Durrës	Besim Bakalli	4,338,495	55	Berat	Lambi Salillari		
320	Durrës	Hamdi Osmani	26,178,597	409	Dibër	LAHIM SHEHU	361,790	497	Durrës	Besim Bakalli	5,421,829	56	Tiranë	KLODJAN PAJUNI		
321	Durrës	Hamdi Osmani	5,434,848	410	Shkodër	Guljem Serreqi	957,645	498	Durrës	Besim Bakalli	2,960,350	57	Korçë	Diana Llluka	265,000	
322	Durrës	Abedin Morina	13,685,000	411	Shkodër	Guljem Serreqi	687,492	499	Korçë	SAMI KADILLI	5,098,626	58	Korçë	FUAT BACI		
323	Korçë	Vangjel Kristaq Koco	1,500,000	412	Dibër	Lahim Shehu	-1,719,473	500	Durrës	Kristaq Toli	4,984,000	59	Kukës	Destan Sul Elezaj		
324	Berat	Cezar Koshi	1,167,057	413	Durrës	Abdulla Islam Keta	53,400,000	501	Durrës	Rifat Dakavelli	8,861,834	60	Durrës	Xhemile Haxholli	5,902,000	
325	Fier	Ramadan Baro	807,000	414	Lezhë	Lazer Llesh Gega		502	Durrës	Rifat Dakavelli	397,000	61	Durrës	Xhemile Haxholli	30,849,000	
326	Fier	Sanije Hebija	38,063,500	415	Durrës	Vasil Vava (Kasapi)	9,968,000	503	Durrës	Muhamet Gjyzeli	17,479,600	62	Durrës	Rustem Pojana	39,228,740	
327	Fier	Enver Lici	13,104,000	416	Durrës	Zenun Hoxha	287,000	504	Durrës	Muhamet Gjyzeli	17,479,600	63	Shkodër	Guljem Gjon Serreqi	14,040,000	
328	Korçë		1,398,046	417	Durrës	Xhafer Loci		505	Korçë	Lytfi Kadillli	-4,235,528	64	Durrës	Frano Koka	15,919,700	
329	Berat	Pali Foni Pyze	5,795,650													

Opinioni **i Ditës**

# Qyteti dhe shëndeti publik...

Nga Përparim Kabo

(vijon nga faqja 1)

...anglez, nga analistë dhe studiues të ndryshëm vihet në pah se ai ka jetuar fëmijërinë në një qytet buzë detit, ku erërat sillnin aromën e rëndë të fabrikave të linoleumit. Vendbanimi tij ishte një provë sakrificë për familjen e tij. Fëmijëria dhe rinia e tij të vështira, por jeta dhe kontributi tij janë suksese dhe vlera. Një model si edhe thotë ai vetë për sjelljen e tij: "Nëse doni një kalë pune, e jani, ja ku jami". Po shtetarët tanë, ku jetojnë, si kanë jetuar, çfarë fëmijëria kanë pasur, a janë ata "kuaj pune"? Vështirë të themi po. Në antropologjinë urbane kur do të identifikosh një qytet, mund të thuhet: "Qytet i banueshëm, qytet ku jetohej shëndetshëm, qytet i zhurmshëm, qytet me klimë jo të mirë ku të gërryhen lagështia, qytet pa rregull, anarkik, qytet i paqë frymëzues, ku bashkëjeton historia me modernen, qytet që ia vlen të jetosh dhe investosh, qytet që nuk banohet më sepse ka humbur tiparet dhe kushtet e domosdoshme të jetesës normale dhe të shëndetshme. Ka qytete që mbipullohen, siç ka qytete që braktisen. Ka qytete me të shkruar, por pa të ardhme. Ka qytete me tradita që konservohen siç ka edhe qytete me ritme marramendëse ndryshimi. Ka qytete që e kanë ruajtur identitetin, siç dhe takohen qytete të shpërfytyruara, të deidentifikuar.

Kur Tirana u shpall kryeqyteti i vendit nga Kongresi Lushnjës në janar të vitit 1920, habia ishte pezull. Përse jo Elbasani, një qendër me traditë dhe zhvillim në disa shekuj dhe ku së fundmi ishte edhe një shkollë e mesme, Normalja e Elbasanit. U mendua të ishte edhe Kruja. Joshte historia, jehonat e saj, heroi kombëtar. Pse jo Shkodra, qendra më e zhvilluar e vendit me traditë romake dhe veneciane, me një Kushtetutë, si edhe kishte qenë dikur statuti i Shkodrës. Edhe Durrësi mund të ishte kryeqytet. Princ Vidi në 6 muajt e tij të qeverisjes e shpalli kryeqytet, pa çka se kur vizitoi Vlorën, tha së paku dy gjëra: "Ky qytet duhet të bëhet një Hong Kong i dytë" dhe pas dy ditëve qëndrim tek preku nga afër patriotizëm e atyre njerëzve, belbëzoi: "Sa gabim që nuk e shpalla Vlorën kryeqytet. Ndjenja e adhtetarisë këtu qenka vërtet e fortë dhe e ushqyer nga shpallja e pavarësisë". Por ja, befasi Kongresi Lushnjës e shpalli Tiranën kryeqytet dhe askush nuk e kundërshtoi, nuk e paragjyko, nuk e refuzoi. Zona kishte histori, traditë, por nuk ishte e zhvilluar. E vetmja gjë që jepte arsye ishte shtrirja mes dy lumenej lumit të Tiranës dhe lumit të Ishmit. Për një qytet, lumi është jetë sepse sjell ujë për të pirë, për t'u larë e pastruar, është i nevojshëm për punë në bujqësi dhe me rëndësi për klimën dhe mikroklimën. Lumunjtë disiplinon ujëra e përrenje apo rëqeve që fryhen nga shirat dhe kështu krijohet rrjeti ujqor, që edhe pa dorën punëtorë dhe shkenore të njeriut, por me atë primitivitet dhe intuitiv, ai ka ditur të ndërtonte në shekuj një dialog mirëkuptimi mes shoqërisë dhe ujërave. Nga studimet hidroteknike të realizuara në vitet '80-të të shekullit të kaluar, fusha e Tiranës



është e pasur me ujëra të nëndeshme. Mjafton të shposh 8-11 m dhe takon në ujë. Kjo u provua edhe kur u hap gropa e madhe që mori emrin "Gropa e Hajdin Sejdisë" pas godinës së Pallatit të Kulturës. Sipas njerit nga specialistët më të mirë që kemi për digat dhe basenet, liqenat dhe rezervuarët (u provua aftësia e tij edhe kur plasi diga e liqenit, vetëm inxhinieri me inicialet N.N. i bëri derman dhe e mbylli) përmbytja e fundit e ambienteve të Bibliotekës Kombëtare nuk ka ardhur vetëm nga vërshimet nga sipër. Parkingu që është ndërtuar nën sheshin "Skënderbej" ka zhvendosur ujëra të nëndeshme duke i spostuar më tej, duke shtuar densitetin e tyre dhe pas shirave të bollshëm, ato fryhen dhe shpërthejnë nga poshtë-lart. Para disa vitesh ky fenomen ndodhi edhe në Rumani, ujërat e nëndeshëm shpërthyen dhe dolën në sipërfaqe. Por le të rikthehemi tek historia. Tirana u caktua kryeqytet sepse fusha ishte e pjerrët nga veriperëndimi dhe kullonte nuk mbante ujë. Vetëm disa zona që nuk e kishin këtë morfologji krijonin pellgje të ndenjura. Qyteti rrethohej nga kodra të buta dhe të gjelbëruara, e mbi të gjitha për karshi ishte Mali i Dajtit, një monument kulturor dhe një "mushkri" për jetën e banorëve. Nga mali rridhte uji i pastër i pijshëm, që më vonë u shndërrua në ujësjellësin e disiplinuar të qytet, me një cilësi që siç edhe shpreheshim dikur, "është i ftohtë si brisik, të than duart". Ky ambient geografik jepte mundësi për jetë të shëndetshme në bashkëjetesën mes njeriut dhe natyrës. Spitali që u ndërtua nga nëna mbretëresha Geraldina ishte tipik fushor në mes të pyllit, sipas modelit austro-hungarez. Edhe sot ka të tillë në Hungari. Edhe spitali tjetër ndërtuar në periudhën e komunizmit, që u njoh si Sanatoriumi i Tiranës, u ndërtua në kodrat e Saukut, në një hapësirë ku mushkëria të mbushej me oksigjen.

**Ndërtimet në kohën e Mbretërisë së mbretit Zog, projektuar dhe realizuar nga studio projektimi dhe ente të punëve botore të nivelit më të lartë të kohës, i dhanë Tiranës pamjen e një qyteti europian duke e shkëputur nga fizonomia dhe pamja orientale.** Sivjet mbushen 90 vite nga shpallja e Mbretërisë. Nuk e di nëse Bashkia e Tiranës ka në plan aktivitetet me rastin e këtij përvjetori të historisë së vendit dhe enkas të historisë së qytetit. Tirana e periudhës së komunizmit u zgjerua edhe si qendër banimi, edhe si qendër administrative, por u shndërrua edhe në qendër industriale e tregtare, arsimore dhe kulturore, shëndetësore dhe rezidenciale për trupin diplomatik të akredituar. Ndërtimet ishin të ulëta 2-3-4-5 kate

dhe vitet e fundit të atij sistemi tektuk edhe 6 kate. Sigurisht, sipërfaqet e banimit ishin të vogla dhe jo të mjaftueshme. Ka rëndësi të pohojmë se kushtet urbanistike, kriteret dhe parametrat u respektuan. Distanca mes godinave, largësia, e drejta e dritës dhe ajrit nuk u shkëlën nga projektuesit. Korridorët e ajrit veri-jug dhe lindje-perëndim funksiononin. Era e freskët në mëngjes herët vinte nga kodrat e Liqenit Artificial dhe përfundonte në Rrugën e Kavajës dhe gati në Rrugën e Durrësit. Që një banesë të jetë e shëndetshme, çfarë do të duhet të plotësojë? Jetëgjatësia u shtua, popullsia u rrit. Tani pas 28 vitesh ndryshime demokratike, me ekonomit tregu kemi të drejtë të pyesim: **Tirana, çfarë lloj qyteti është...?!** Pas një rrokopje me kishka e me ngrehina pa vlerë, tani Tirana e viteve 2000, e mijëvjeçarit të ri, çfarë lloj qyteti është apo së paku është projektuar të jetë? Kjo është pyetja që i bëra në zyrën e tij kryebashkiakut Erion Velija në një takim para po thaj më shumë se një vit. Ai në fillim heshti. Pastaj më tha, "se po vëmë dorë kudo, sepse qyteti kishte rënë në gjumë, po thaj në letargji, punët publike ishin ndaluar dhe qyteti po mbytej". "E shoh - i thash - por kjo nuk ju pengon që të ideoni udhërrëfimin dhe trasen për 50 apo 100 vite se ku do shkojë qyteti Tiranës. Do jetë qytet rezidencial apo turistikokulturor? Do jetë vetëm qendër banimi apo edhe industrial e manufakturor?! Dhe më tëj i përmenda shembullin e zotit Boris Jonson, i cili drejtoi Bashkinë e Londrës. Ai caktoi objektivin. Londra nga "banks city" (qytet i bankave pra i jetës monetare) do të shndërron në "Green City" (qytet gjelbër). I përmenda rolin e madh të ish-presidentin amerikan, Teodor Rusvlet në fillim të shekullit XX për ndërtimin e parqeve natyrore në USA dhe kujdesin për natyrën. Ai më dëgjoi në heshtje. Follëm edhe për ujën e pijshëm. I kumtova se pa ujën e pijshëm në rubinetat për çdo njeri, pavarësisht se ku jeton, nuk i mund të shkohet në BE dhe i bëra prezent ekspertiencën hungareze dhe atë kroate. Më bëri me dije se po punohej në bashkëpunim me kompaninë më të njohur hungareze për pastrimin dhe cilësinë e ujit të pijshëm, duke përdorur e ujën e lumit Danup, i cili është disa i rëndë, sepse lumi është fushor dhe rrjedh shumë ngadalë. Më vonë mësova se në një takim pune ku u paraqitën projektet për zhvillimin e ndërtimeve të Tiranës aktiviteti kishte nisur me një provokim disi jo bindës. Një logo në mes të ekranit njoftonte për Tiranën si qytet i gjelbër dhe njëkohësisht u paraqitën projektet për zënie e hapësirave për ndërtime masive kudo dhe ngado. E gjitha kjo

ndërhyrje pa një konsultim referendar me publikun, me komunitetet dhe banorët e Tiranës. Qyteti dhe i gjelbër, edhe me njolla të reja betoni, pa kursyer më as edhe më të voglin truall apo hapësirë publike për brezat që do të vijnë. **Nuk ka qytet të gjelbër atje ku sistematikisht shtohet klaustrofobia urbane. Pallatet ekzistuese ku sigurisht jetojnë ata që nuk blenë dot apartamente të reja, pra shtresat në nevojë ose të varfra të shoqërisë janë tani në kushte shumë të rënda. Sipërfaqja e tyre e banimit është e vogël e kohës së komunizmit. Rreth e rrotull godina të larta e të stërlarta që u zënë frymën, u pengojnë dritën, u ngushtojnë hapësirën, u marrin ujën me cisternat që kanë nën tokë, si të thash atë njerëz janë të burgosurit e një moderniteti që po vret shëndetin e qytetit në shumë hapësira.** Mbjellja e pemëve është një gjë shumë e dobishme për banorët e sotshëm dhe për brezat që do të vijnë. U mbollën 100 mijë pemë apo më pak, kjo është një gjë që verifikohet sepse ka harta, protokolle dhe tregues që identifikojnë. Për të jetuar shëndetshëm duhen pyjet komunalë, ato mes godinave dhe billoqeve të banimit, por është me shumë vlerë toka e gjelbër, dheu që nuk mbulohet me pllaka, beton apo me asfalt. Në Tiranë prej dy dekadash është punuar keq. Është zvogëluar sipërfaqja truall, dhë. Toka e absorbon më mirë të neqhtit dhe thith ujërat. Provo të shkosh pranë zonës së Liqenit atje në hyrje ku është Garda e Republikës, e ndjen menjëherë. Ajri është më i lehtë se ka më shumë oksigjen dhe temperatura është disa gradë më e ulët. Nëse merr rrugën drejt Librit Universitar e ndjen se ajri bëhet më i rëndë dhe temperatura ndjeshëm më e lartë. A ka matje se sa sipërfaqe tokë dhe kemi për frymë dhe sa sipërfaqe të mbuluar me material të ngurtë, mermër, granit, pllaka shtrimi apo asfalto beton? Duhet të ketë buletin ambiental dhe protokoll për këtë tregues. Nëse vendos për të ndërtuar, duhen caktuar standardet dhe kriteret në lidhje me të cilët të shprehen sociologët-urban, mjekët infektionist, ambientalistët dhe inxhinierët e mjedisit së paku. Në objektivat e mijëvjeçarit, krahas ujit të pijshëm është objektivt ruajta e fondit të tokës, që dëmtohet nga zënia barbare me ndërtime duke mos menduar për brezat që vijnë, nga gërryerja dhe rrëshqitjet e dheut që matet me metër kub/ton. Si qytetar, unë pyes ku është protokoll matjes së këtij treguesi, ku është buletini për vitshëm që duhet të botojë zyra apo departamenti përkatës në Bashkinë e Tiranës?! Objektivi të i mijëvjeçarit është: "Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit. Synimi 7A: Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit; kundërshtimi i humbjeve të burimeve mjedisore. Synimi 7B: Zvogëlimi i humbjes së biodiversitetit, duke arritur deri në vitin 2010, një reduktim të ndjeshëm në normën e humbjes. (Jemi në vitin 2018. Unë ju pyes zoti Velija, a mund të na thoni sa është humbur nga biodiversiteti në territorin e Bashkisë së Tiranës?) Proportioni i sipërfaqes së tokës të mbuluar nga pyjet. Emetimet e CO2, gjithsej, për frymë dhe për \$1 GDP. Konsumimi i substancave që zvogëlojnë ozonin. Përqindja e

rezervave të peshkut brenda kufijve të sigurt biologjik. Përqindja e burimeve totale të ujit të përdorur. Proportioni i zonave tokësore dhe detare të mbrojtura. Përqindja e specieve të kërcënuara me zhdukje. Synimi 7C: Përqindja deri në vitin 2015, përqindja e popullsisë pa qasje të qëndrueshme në ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime bazë. Përqindja e popullsisë me qasje të qëndrueshme në një burim të përmirësuar të ujit, urban dhe rural. Përqindja e popullsisë urbane me qasje në përmirësimin e kanalizimeve. Synimi 7D: Deri në vitin 2020, të ketë arritur një përmirësim të ndjeshëm në jetën e të paktën 100 milionë banorëve të lagjeve të varfra. Përqindja e popullsisë urbane që jeton në lagjet e varfra. Bazuar në këtë strukturë, me banorët e Tiranës duam të jemi të informuar sa tokë humbasim, sa pyje, sa ujëra, sa biodiversitet? OKB organizon takimet botërore për ujën dhe për tokën, siç edhe ka qenë samiti në Danimarkë dhe ai në Meksikë. Çfarë kemi marrë në prej vendimmarrjes së tyre? Në cilat projektet jemi përfshirë, në mënyrë individuale apo si partner rajonal a më gjerë? A paraprin Tirana si qendra më e madhe e vendit në respektimin e vendimeve të Konferencës së Johannesburgut, gusht 2000, sepse në si shtet e kemi firmosur këtë marrëveshje dhe e kemi ratifikuar në Parlament. Në vitin 2020 mbushen dy dekada. Unë si qytetar i RSH propozoj që e para Bashkia e Tiranës, por edhe ajo e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Vlorës, Kukësit, Sarandës, Fierit, Elbasanit etj., etj. të përfshihen në konferencën e qytetit me objekt studimin dhe raport-dhënie "Pas 20 vitesh çfarë është bërë me objektivat e mijëvjeçarit". Më tej mund të shkohet në një Konferencë Kombëtare me tematikën: "Shqipëria e shekullit XXI." Nëse nuk punohet kështu as zhvillim nuk ka, as partneritet, as seriozitet, por edhe as shëndet publik. Ka sheshe me pllaco ku të blas vapa, ka sheshe që mbulojnë trashëgiminë historiko-arkologjike si në (Durrës ku arkeologu e pushtetit lokal arriti kulmin). Po le të marrim një element e të jetuarit shëndetshëm. Cilësia e ajrit... Ajri në Tiranë (zona e qytetit, jo rrethinat) është goxha e ndotur me tymra, me gazra, me helme, me grimca të ngurta. Nuk e dimë nëse ka buletin të përvitshëm që raporton gjendjen. Matja e bëhen dhe nga cilët ent? Me çfarë ndjenje përgjegjësie? Ku certifikohen këto matje? A shpallen dhe analizohen, a nxirren përfundime? A përcaktohen detyra dhe a ndërhyhet për rregullime e përmirësime? Cilësia e jetës varet drejtpërdrejt nga cilësia e ajrit, sepse pa ajrin që na jep oksigjenin, gjaku nuk e kryen dot funksionin edhe nëse qarkullojnë në trup. Me ajër të ndotur shkaktohen sëmundjet e hipertensionit dhe ato kardiovaskulare, astma dhe alergjitë. Në Tiranë qarkullojnë ende automjetet që lëshojnë jo tym, por blözë. Policia Bashkiake përpara se të vërë gjoba për parkim të gabuar apo ndonjë shkelje tjetër, të ndjekë dhe të ndalë autobusë apo autovetura që ndotin keq ajrin e qytetit. Duhet të ketë protokoll marrëveshjeje dhe bashkëpunim mes bashkisë dhe organeve kompetente, që kanë për detyrë matjen e parametrave të gazrave. Ai që toleron apo korruptohet, helmon qytetin, vret jetën, dëmton shëndetin e pleqve dhe fëmijëve. Cilësia e karburantit të shumë për të dëshruar. Sa e mbush mbajtësin e karburantit në

Opinion i Ditës

# Vetingu, shëmtia dhe rimëkëmbja e drejtësisë shqiptare

Nga Elvis Zaimi

(vijon nga faqja 1)



...përmirësimin e drejtësisë shqiptare. Në këtë kuptim, duhet pranuar si një e vërtetë aksiomatike se përmirësimi i drejtësisë shqiptare do të ketë ndodhur atëherë kur ajo të jetë më cilësore, dhe kur të trajtojë realisht gjyqtarët e këtij vendi në mënyrë të barabartë përpara ligjit.

Deri më sot reforma në drejtësi është zhvilluar kryesisht përmes procesit të vetingut, i cili ndonëse është parashikuar të ketë tre komponentë, verifikimin e thelluar të pasurive, integritetit të figurës, dhe afësisë profesionale të magistratëve shqiptarë, kryesisht është zhvilluar përmes verifikimit të pasurimit të paligjshëm të kësaj kategorie të nëpunësve shtetërorë.

Ashtu siç pritej, dhe pa surprizuar askënd, verifikimi i pasurimit të gjyqtarëve zbuloi banalitetin e të keqes së sistemit të drejtësisë, në radhët e të cilit, madje edhe në nivelet më të larta të gjyqësorit, shërbejnë individë, të cilët nuk bëjnë përjashtim nga morali i përgjithshëm i shoqërisë dhe administratës shqiptare, të përfshirë në manovra ordinarie për t'i krijuar vetvetes komfortin e jetës dhe të një mirënjehjeje të pamerritur, duke abuzuar me detyrën e gjyqtarit dhe prokurorit në kurriz të drejtësisë. Pra, analiza dhe diskutimi i shkaqeve se përse gjyqtarë të niveleve të larta, erdhën në vëmendje të opinionit publik duke u bërë butaforikë me justifikimet e tyre mbi të ardhurat nga okokat e se-bepeve familjare, nga puna si emigrant jashtë vendit, dënimet penale të cilat ata i kishin mbajtur të fsheshura, apo akrobaci për të përfutur kredin të buta si të pasthëna, nuk paraqet ndonjë interes as intelektual, por as edhe për publikun.

Ajo që paraqet interes është "abuzimi i organizuar" me drejtësinë që ka ndodhur në radhët e gjyqësorit, mad-

je edhe jashtë tij, në bashkëpunim "të fshehtë" me segmente të caktuara të politikës. Në këtë kuptim, procesi i vetingut zbuloi një fenomen tipik shqiptar, i cili kërkohet të adresohet në mënyrë adekuate. Nëse në vende të tjera të botës flitet për të ashtuquajturin "miscarriage of justice", pra për raste individuale kur për shkak të gabimeve që kanë të bëjnë me keqzbatimin e ligjit material, procedural, dhe të vlerësimit të provave, gjykatat kanë arritur në vendime përfundimtare të gabuara, kryesisht në lidhje me "dënimin e padrejtë të të pafajshmeve", në Shqipëri është rasti të flitet për "failure of justice", d.m.th për dështimin masiv të sistemit gjyqësor në bërjen e drejtësisë, që konsiston në mosdënimin e fajtorëve realë, dhe në dënimin e pamerritur të shumë të pafajshmeve. Kjo domethënë se, procesi gjyqësor penal, i cili luhetet ndërmjet dy objektivave madhorë; atij të respektimit të procesit të rregullt ligjor, me qëllim mosdënimin e asnjë "të pafajshmi" dhe "kontrollit të kriminalitetit" duke siguruar dënimin e çdo "fajtori të vërtetë" dhe dhënë siguri për jetën në komunitet, ka dështuar sistematisht në

realizimin e të dyja këtyre objektivave. Procesi gjyqësor penal është kthyer në një parodi, ku në shumë raste "procesi i rregullt gjyqësor" dhe jurisprudenca e GJEDNJ kanë shërbyer për të nxjerrë në pafajshëm kriminelë dhe "peshq të mëdhenj" të korrupsionit, ndërkohe që drejtësia penale ka pësuar fiasko në kontrollin e kriminalitetit, d.m.th në dhënimin ndaj çdo fajtorit real të dënimin të merituar.

Çdo vend dhe shoqëri e qytetëruar nuk mund të pajtohet me këtë situatë, pra me dështimin e sistemit të drejtësisë në administrimin e drejtësisë penale, që d.m.th se, ndërsa sot që flasim reforma në drejtësi është një sipërmarje e papërfunduar; kjo reformë nuk duhet të ketë objektiv të saj vetëm bërjen e drejtësisë në të ardhmen, por duhet të jetë edhe parapërcaktues. Kjo nënkupton se reforma duhet të korrigjojë dhe rivlerësojë në vend sa më shumë padrejtësitë e të shkruarës, dhe për këtë qëllim reforma nuk nënkupton vetëm ristrukturimin e metodave të qeverisjes së gjyqësorit, por edhe reformën e politikave penale dhe ndryshimin e përfaqësues faktorit njerëzor që punon në sistemin e drejtësisë. Drejtësia pe-

nale në të shkuarën ka lënë në baltë veçanërisht shtresat shoqërore të pa-privileguara, duke tronditur thellë besimin tek parimi i sigurisë juridike, d.m.th sistemi aktual i drejtësisë penale nuk jep garanci efektive se çdo i pafajshëm do të deklarohet i tillë dhe se çdo fajtor do të marrë ndëshkimin e merituar. Kjo është racionalja popullore që i jep besueshmëri dhe legjitimitet demokratik drejtësisë penale, të cilës sot asaj i mungon, por që duhet të jetë një nga objektivat e reformës. Nga kjo perspektivë, me tepër sesa propagandimi në publik i ndëshkimit të gjyqtarëve të shkarkuar nga vetingu, ndaj të cilëve janë mbledhur të dhëna për korrupsion, më i nevojshëm paraqitet rivendosja e besimit tek shteti normativ dhe drejtësia. Gjyqtarët e korrupsionit nuk surprizojnë askënd, ata janë pjesë e shoqërisë shqiptare, e zhvilluar në mënyrë oportuniste pikërisht në kushtet e mungesës së një sistemi efektiv drejtësie, të cilët vetingu i ka vendosur në një pozitë të mjerueshme pikërisht për zellin e tyre për të shërbyer. Në të vërtetë, shumica e popullit shqiptar dhe opinionit publik, ka bindjen se korrupsioni dhe pasurimi i paligjshëm i politikaneve, është shumë herë më i dukshëm dhe i përhapur sesa ai i gjyqtarëve.

Sigurisht që gjyqtarët e shkarkuar dhe të përfshirë në korrupsion duhen ndëshkuar ligjërisht, njëjloji si çdo zyrtar tjetër shtetëror që abuzon me detyrën, por mbitheksimi i korrupsionit të gjyqësorit, në kushtet e vakumit institucional të krijuar me daljen jashtë funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, dhe të një ekzekutivi të fortë dhe të mbështetur nga një mazhorancë parlamentare e plotfuqishme, rrezikon ta kthejë idenë e "vetingut" në të vetmen ide të reformës në drejtësi, pra në një ide "populiste dhe moralizuese", duke vënë në rrezik shtetin normativ, në radhë të parë parimin e ndarjes së pushteteve.

Misioni i vetingut, si një procedurë kushtetuese disiplinuese në "rrump-

allën" e gjyqësorit shqiptar, ka qenë t'i hapë rrugën reformave ndërtuese në drejtësi, duke krijuar parakushtet për ndërtimin e një drejtësie të re, me koncepte dhe mentalitet të ri perëndimor. Në këtë drejtim hapi i parë dhe më i logjikshëm, është rishqyrtimi i të gjitha vendimeve të dhëna nga gjyqtarët e shkarkuar, duke evidentuar të gjitha ato vendime që "ofendojnë sensin e drejtësisë". Gjithashtu, duke mbetur në domenin e politikave reformatore dhe jo të argumenteve teknike mbi parimin e gjësë së gjyqar apo të pafajësisë, është imperative që "shkelja me këmbë" që i kanë bërë idesë së drejtësisë vetë gjyqtarët e korrupsionit të korrigjohet sa më parë. Shqipëria duhet të miratojë një ligj të posaçëm për rishqyrtimin kritik të të gjitha vendimeve penale të krimet tronditur ndërgjegjen e këtij vend, dhe mbajmë peng progresin e tij. Koncepti i "miscarriage of justice", pra i gabimeve gjyqësore është një fenomen gjërisht i pranuar në juridiksonet perëndimore të viteve të fundit, duke ndërtuar edhe mekanizma institucionale për korrigjimin e tij. Rasti i Shqipërisë, siç pranohet gjërisht si një vëzhgim kyç sociologjik, prezanton një fenomen më akut, atë të dështimit masiv të drejtësisë penale në përmblshjen e misionit të saj në shoqëri. Pra, është krejtësisht legjitime ideja, pavarësisht kompleksitetit dhe delikatesës në vënien e saj në zbatim, se duhen rihapur dhe rishikuar të gjitha ato procedura gjyqësore penale, në lidhje me të cilat ka argumente të mjaftueshme se si rregdojnë e keqzbatimin të ligjit material dhe procedural penal, jo vetëm janë dënuar padrejtësisht "të pafajshëm", siç është rasti tipik në Perëndim, por edhe kur janë deklaruar si të pafajshëm me vendime penale të formës së prerë kriminale dhe zyrtarë të lartë. Kjo nuk nënkupton anashkalimin e parimit të gjësë së gjyqar apo krijimin e një shkalle tjetër gjyqësore. Më së shumti, ajo duhet të përfaqësojë një "përgjigje të jashtëzakonshme" që sistemi ligjor shqiptar duhet t'i japë pikërisht problemit të shumëpërhapur të abuzimit të procedurave gjyqësore, duke i ripsërshtuar ato sa herë që arsyehet dhe sensi i drejtësisë "urdhërojnë" ripsërshtimin e tyre, dhe që burojnë nga e njëjta situatë problematike që e detyroi pikërisht parlamentin shqiptar të miratonte kryerjen e një tjetër reforme unike dhe të jashtëzakonshme, atë të vetingut.

shpërndarësin e tij, të ndizet në tabelën përball treguesi që makina megjithëse e re, po mbytet nga gazrat. Kjo ndjehet edhe kur e mbush makinën me benzinë apo naftë jashtë Shqipërisë. Ajo është më e lirë dhe punon shumë më normal. Karburanti jashtë standardeve ndot, vret jetën, nuk të lejon të jetosh shëndetshëm. Po pse në qytetin e Tiranës në çdo shesh apo qendër ku ka lëvizje të dendur të mjeteve dhe njerëzve nuk ka matës publik të temperaturës, të oksigjenit, të gazit karbonik, të azotit, të lagështirës? Këto shërbime publike janë kudo në Europë. Nuk bëhesh qytet europian duke vënë në qytet ibrik gjigant për të pirë ujë dhe pas dy vjetësh ata zhdুকun pa nam e pa nishan. Grumbullimi automjeteve në qendër si në parkingun në sheshin qendror dhe rreth tij, që me gjasa edhe do shtohen me ndërtimet e reja rrokaqelëse, lëshojnë gazra. Nuk mjafton ai oxhaku që i nxjerrë jashtë. Aritmetika është e thjeshtë. Pemët dhe shkurret në zonë, a mjaftojnë që ta përthithin gazin karbonik? Dhe një pyetje tjetër. Ku jemi ne, Republika e Shqipërisë me projektin e BE-së për zvogëlimin e emetimit të gazit karbonik deri në

20%? A ka projekt? Po plan veprimi a ka? Ka matje, ka ndërhyrje, ka ndryshim të pritshëm? Unë nuk di të ketë. Nëse dikush di ju lutem të na vini në dijeni. Ajri mungon në Tiranë. Zona e qytetit është dëmtuar rëndë, sepse korridoret e ajrit janë zënë. Po pse nuk ushtrohen gjoba për shkelje të tilla deri në vendim shembjeje godine? Interesi publik për të jetuar shëndetshëm duhet të jetë i pari si prioritet? Mjafton të hipësh në malin e Dajtit dhe të shohësh tymin kancerogjen që lëshohet nga dëgja e plehrave në Sharrë... Madje dëgjuam nga zoti kryeministri se ai lanfildit Tiranës do të shërbejë për Tiranën dhe Durrësin. Diçka e pamotivuar si ide. Nuk e imagjinoj po si do të vijmë mbetjet nga Durrësi në Tiranë, me tren me makina apo me karroca? Shqipëria europiane ka nevojë për një strategji kombëtare dhe për stacione rajonale në nivel bashkie për mbledhjen dhe çaktivizimin e mbetjeve. Reforma territorial, ku e ka masterplanin për këtë detyrim? A mendon kush? A ka studime? Për ditë shohim në kronikat televizive njerëz të revoltuar pikërisht për situata të tilla që vrasin shëndetin publik. Ajri është i ndotur në Tiranë sepse antenat që lëshojnë valë

elektromagnetike janë vendosur edhe në mes të qytetit, se shumë klinika mjekësore apo stomatologjike janë brenda në pallate. Bashkia duhet të ketë protokollin dhe kushtet për instalimin dhe funksionimin e tyre, me qëllim mbrojtjen e jetës së banorëve. Nëse nuk e bën, është njësoj përgjegjëse për këtë krim që ndodh çdo ditë kundër shëndetit publik. Ajri është i ndotur se mbetjet urbane janë ende në rrugë. Duhet nisur ndërhyrja që çdo banesë të ketë kazanët brenda të ndarë në tre mbajtës, biologjike, plastike, letrarkarton. Përgjegjësit e pallateve së paku atje ku ka të tillë dhe paguhen me këtë detyrë duhet të merren. Me ka bërë përshtypje në një pallat në Budapest. Në kafin përderes të gjithë banorët kanë shishet dhe objektet të tjera plastike. Pasi i grumbullonin, ato shiteshin dhe të ardhurat shkonin për investime në godinë. Edhe diçka tjetër. Restorantet, baret, dyqanet nuk duhet të hedhin mbeturinat e tyre po në kazanët ku i hedhin banorët. Mbjetet e tyre janë disa herë më shumë si peshë dhe si volum. Ata duhet të kenë mbajtësit të ndara sipas natyrës së mbetjeve brenda ambienteve. Makinat që ua tërheqin atyre janë enkas në një orë të caktuar dhe me tarifa të veçanta që përcaktohen nga lloji shërbimit

dhe kosto e tij. Cilësia e shërbimeve ushqimite dhe higjiena, si janë në Tiranë? Kudo ka mangësi. Bashkia dhe shërbimet e saj duhet të mos lejojnë asnjë kafeteri apo restorant që të lajë gotat dhe enët në lavamanë si edhe ndodh rëndomë. Duhet të kenë kudo pjatolarëse. Ja përse hepatit lodrojnë në Shqipëri. Bashkia duhet të bashkëpunojë me shërbimin stomatologjik për sëmundjet frekuentet të gojës sepse këta njerëz marrin dhe nxjerrin frymë, ulen e pinë kafë dhe me atë filxhani p i edhe tjetri. Duhet jo vetëm banjat publike (me matje një për 12 persona dhe jo ca kabina Toi-Toi, që tani edhe nuk duken më janë zhdukur), por edhe duhet publike për njerëzit e rrugës, për ata në nevojë, sepse ai hipën në autobus, hynë në dyqan, shkon në ambulancë apo spital si i rrezikuar dhe dëmtor dhe tjetrin. Bashkia nuk duhet të lejojë shijtë ushqimesh në rrugë por edhe rrobash të përdorura që kutërbojnë erë të tmerrshme. Higjiena dhe kultura e saj si higjiena e trupit dhe gojës, e veshjes dhe jetesës mungon shpesh si kulturë publike. Programet edukuese dhe ato të shkollave, shoqërisë civile dhe shtresave në nevojë e pa të ardhura ekonomike duhet të jenë reale,

konkrete dhe të matshme. Higjiena e qytetit. Rrugët duhen larë dhe dezinfektuar. Po ashtu, trotuarët duhen fshirë larë dhe dezinfektuar, aq më tepër që kafshë pa zot qarkullojnë në Tiranë, por edhe ato me zot gjithçka e bëjnë në trotuare. Feçja dhe urina e tyre është tejet e rrezikshme për njeriun e mënyrë të veçantë për femijët. Shëndeti publik lidhet dhe me nivelin e zhurmave. Tirana është në shumë zona qytet anormal, me histori dhe çmenduri antikomunitare. Zhurmat e kalojnë disa herë normën e lejuar të decibelevë. Kurse ndriçimi me gjithë ndryshimet të shumë për të dëshiruar. Ka keqkuptim në lidhje me ndriçimin. Ai trajtohet si llamba kundër errësirës dhe jo si element që dimensionon qytetin edhe në orët e errësirës. Le të shohin Parisin natën dhe Stokollin. Mbase e kujtojmë se duhet të dalim nga koha kur shqiptari zgjohej me diellin dhe flinte po me diellin, në një jetë pagane. Qyteti i pandriçuar është i frikshëm dhe jo i shëndetshëm, është i pasigurt dhe jo funksional, është tipik për atë shoqëri që e ka të mbyllur mendjen në një "kuti të zezë", ku gatuhet vetëm zymtësia. Historia vazhdon...!

Kreu i lëvizjes Vetëvendosje: Thaçi do të jetë larg Gjykatës së Posaçme

**T**ë shumta kanë qenë bisedimet, dhe vijnë të jenë, lidhur me kufijtë e Kosovës me Serbinë. Ndërkohë që ditën e djeshme një opinion e ka dhënë edhe kryetari i lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një intervistë për zërin e Amerikës. Ai tha se synimet për korrjigjim kufijsh apo shkëmbim terriroresh, janë të gabuara dhe mund të kenë pasojë të dëmshme. Kurti, gjithashtu, shprehu se debatet e fundit më shumë lidhen me tendencën e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, që të jetë sa më larg Gjykatës së Posaçme. Ai shtoi se është kundër idesë që për ta bashkuar Kosovën me Shqipërinë, të falet veriu i Kosovës.

**Zëri i Amerikës: Z. Kurti, në Kosovë kanë shpërthyer debatet rreth marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e marrëdhënëve me Serbinë, posaçërisht pasi që presidenti Hashim Thaçi hodhi idenë e korrjigimit të kufijve. Si e shihni ju këtë propozim?**

Albin Kurti: Synimet për korrjigjim terriroresh ose shkëmbim terriroresh janë synime të gabuara, që do të kenë pasojë të dëmshme. Korrjigjimi i kufijve bëhet për arsye minore që maten prej dhjetëra apo qindra hektarësh maksimalisht, por kurrsesi me një krahinë të tërë siç është ajo e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit. Korrjigjimi i kufijve bie tek regjistri i demarkacionit dhe këtë të enjte bëhen saktësisht gjashtë muaj prej se presidenti Thaçi ka nënshkruar marrëveshje me homologun e tij malazez Vujanović për korrjigjimin e kufirit me Malin e Zi. Ai nuk e bëri me Malin e Zi, kemi marrëveshje të nënshkruar dhe asnjë hap në terren dhe tashmë po kalon në korrjigjimin e radhës. Për bindjen time, ajo çfarë po ndodh më shumë ka të bëjë me tendencën e tij që të jetë sa më larg Gjykatës së Posaçme që e ka imponuar vetë se sa që Kosova të jetë më afër shtet ndërtimit apo integrimi evropian.

**"Zëri i Amerikës": Presidenti Thaçi thotë se ideja e tij përjashton ndarjen e Kosovës dhe përfshinë bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën. Përse duhet kundërshtuar një gjë e tillë?**

Albin Kurti: Ai (presidenti) ka qenë dy mandate kryeministër dhe ka pasur shansin që referendumin e vitit 1992 të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit ta vë në jetë me hapa politik e qeveritar. Nuk e ka bërë këtë gjë. Tashmë është në kuadër të logjikës së shkëmbimit terriroresh. Për bindjen time, funksioni i shkëmbimit terriroresh është veç se të huajësimit shpirtëror i shqiptarëve prej veriut të Kosovës dhe në anën tjetër tjetërsimi i atij veriu prej shtetit të Kosovës. Kur thua, dua shkëmbim terriroresh, kjo i bie që hequr dorë nga veriu ndërkohë që Luginën e Preshevës nuk ta jep Serbia. Unë jam në veçanti i brengosur për shkak se diskutimet për shkëmbime terriroresh

# Debatet për kufijtë, Kurti: Bisedimet janë më afër luftës se paqes

"S' duhet të shkatërrojmë Kosovën për ta bashkuar me Shqipërinë"



nga përvoja e hidhur e historisë më të re të Ballkanit, tregon se shpie më parë në zhvendosje të popullsisë se sa në

ndryshim të kufijve. Ne e dimë shumë mirë se si dialogu për terrirore është më afër luftës se sa paqes.

## Thaçi: Luginja e Preshevës po na mbështet. Të jemi bashkë pa dallime

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi jo vetëm që nuk heq dorë nga ideja për korrjigjim kufijsh, por në një farë mënyre e bën të drejtë bashkimin e tri terrirore me shqiptarë në Serbi me Kosovën. Në një status në "Facebook" Thaçi falënderon liderët dhe qytetarët e Luginës së Preshevës që po përkrahin, siç thotë ai, qëllimet e përbashkëta. Madje ai apelon që kjo e drejtë e bashkimit të Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës të bashkëjohet pa dallime. "Edhe njëherë i falënderoj liderët dhe qytetarët e Luginës së Preshevës që po përkrahin arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta për bashkimin e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës me Kosovën, në kuadër të korrjigimit të kufirit mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo e drejtë duhet të na bashkojë pa dallime partiake, ideologjike dhe bindjesh tjera, qoftë nga pozita institucionale, e shoqërisë civile apo e opozitës", shkruan Thaçi.



## Politikat e Ballkanit, Merkel e preferuara e shqiptarëve

### Kancelarja gjermane e prerë: S'ka ndryshim kufijsh, prioritet hyrja e Bosnjës në NATO

**P**as zhurmës së madhe të bërë lart e poshtë lidhur me kufijtë e Kosovës me Serbinë, një tjetër figurë e huaj e politikës ka reaguar. Kësaj radhe ka qenë vetë Kancelarja gjermane, Angela Merkel e cila duket se është shprehur kundër idesë së Presidentit të Kosovës Hashim Thaçi për ndryshim kufijsh. Gjatë një takimi me kryeministrin e Bosnjës e Hercegovinës, Kancelarja Merkel tha se ka tendencën të caktuar në Ballkanin Perëndimor dhe se po flitet për rivendosje të kufijve, gjë e cila, sipas mendimit të saj nuk mund të bëhet, shkruan rel. "Ekziston një perspektivë evropiane për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor: Bosnja dhe Hercegovina përpiqet të bashkëhet me Bashkimin Evropian, prandaj është dashur që t'i përgjigjet qindra pyetjeve dhe ne kemi inkurajuar qeverinë që të përgjigjet në këto pyetje



shtesë", tha Merkel. Merkel, gjithashtu, bëri të ditur se prioritet është anëtarësimi i Bosnje dhe Hercegovinës në NATO. Kryetari i Këshillit të Ministrave të Bosnje dhe Hercegovinës, Denis Zvizdic gjatë vizitës së tij në Gjermani u takua me Kan-

celaren Angela Merkel dhe pas takimit të tij ai bëri të ditur se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë perspektivë dhe mbështetje nga shteti i Gjermanisë. Ndërkohë që nga ana tjetër në një sondazh të bërë, Angela Merkel është liderja e

huaj që simpatizohet më shumë nga shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë. Në këtë përfundim arrin një anketim i agjencisë së njohur të sondazheve 'Gallup International' për popullaritetin që liderët botërorë kanë në shtete të ndryshme të botës. 82% e të pyeturve në Shqipëri dhe 77% e të pyeturve në Kosovë kanë mendim pozitiv për Kancelaren gjermane. Për numrin e simpatizantëve të Merkelit, Shqipërinë e kalon vetëm Vietnamit me 1% më shumë. Aq popullore sa në Shqipëri e Kosovë, ajo nuk është as në vendin e saj ku pëlqehet nga 54% e pyeturve. Pas Merkelit, simpatinë e shqiptarëve e ka marrë Papa Françesku. Në sondazhin e zhvilluar në 55 vende të botës, më popullor është Papa Françesku që ka një mbështetje 56%. Mes 12 liderëve, më pak i vlerësuar është Hasan Rohani i Iranit me një nivel vlerësimi 24%. Anketimi përfshin periudhën Tetor - Dhjetor 2017.

**SHKURT**


**"Gallup", shqiptarët duan më shumë Merkelin, e Putinin më tepër se Trump**

Angela Merkel është liderja e huaj që simpatizohet më shumë nga shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë. Në këtë përfundim arrin një anketim i agjencisë së njohur të sondazheve 'Gallup International' për popullaritetin që liderët botërorë kanë në shtete të ndryshme të botës. 82% e të pyeturve në Shqipëri dhe 77% e të pyeturve në Kosovë kanë mendim pozitiv për Kancelaren gjermane. Për numrin e simpatizantëve të Merkelit, Shqipërinë e kalon vetëm Vietnamit me 1% më shumë. Interesant është fakti se presidenti rus Vladimir Putin simpatizohet më shumë nga shqiptarët se ai amerikan Donald Trump. Diferenca është me 1% në favor të Putinin. Megjithatë duke qenë edhe kombi më proamerikan në botë, Trump gëzon më shumë mbështetje mes shqiptarëve sesa në të gjithë vendet e tjera të rajonit. Ndërsa Vladimir Putin në Ballkan mbështetet më së shumti nga serbët dhe grekët.

**Anglezët ndryshojnë qëndrim: Duam të rrimë në Europë**

Më shumë se 100 zona zgjedhore në Britaninë e Madhe që votuan për t'u larguar nga BE tani mbështesin lëvizjen që kërkon një referendum të dytë për të qëndruar brenda unionit. Kjo u vu re në një studim nga 'Observer'. Analiza, një nga vlerësimet më të plota të ndjenjës së Brexit që nga referendumi, sugjeron se ndryshimi është nxitur nga dyshimet midis votuesve laboristë që mbështetën largimin. Si rezultat, tendenca është më e rreptë se veri të Anglisë dhe Uellsit - krahina të laboristëve të cilën ndjenja e 'Brexit' duket se po ndryshon. Hulumtuesit në kompaninë analitike të konsumatorëve Focalldata përpiluan të dhëna duke modeluar dy sondazhet të YouGov me më shumë se 15,000 njerëz, të kryera para dhe pas publikimit nga Theresa May të marrëveshjes së propozuar për 'Brexit' më 6 korrik. 632 zona në Angli, Skoci dhe Uells u shqyrtuan për studimin. Ajo gjeti se 112 kishin kaluar nga "Largimi" në "Qëndrim" në BE. Analiza e re sugjeron se tani janë 341 zona me mbështetje mbijetese nga shumica, nga 229 që ishin në referendum. Një zonë ka ndërruar përkrahjen në Skoci dhe 97 në Angli, ndërsa 14 nga 40 zonat zgjedhore në Uells kanë ndryshuar nga pro "Brexit" në kundërshtim të tij.

**Fjalëkryqi (1)**



- 37. Janë legjendat.
- 38. Nuk ka akoma një bebe.
- 39. Fillojnë mirë.
- 40. Janë brinjë në skuadër.
- 42. Shkruhet i shtati.
- 44. Nget edhe ajo e mirë
- 47. Mbahet në gisht.
- 48. Janë numrat 1, 3, 3...

**VERTIKAL**

- 1. Kanë shpatë të tilla.
- 2. Janë edhe ato polare.
- 3. Janë zoriçet.
- 4. Janë male në Rusi të tilla
- 5. Eshhtë nusja me vello.
- 6. Një rreth pa ekstreme.
- 8. Në kryt të titujve
- 9. Diku në qendër.
- 10. Markë cigaresh.
- 13. Janë rëfimet e të pandehurit.
- 14. Janë penjtë për gjergjef.
- 16. Mbarojnë fare.
- 18. Janë shtitë e... provimëve.
- 20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
- 21. Vitet pa kufij.
- 22. Një fjalë për tutje.
- 24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- 25. Eshhtë e akuzuara... injorante
- 26. Baldwin
- 27. Një pjesë e kandidatëve.
- 28. Krenar pa çift.
- 30. Grazia Cucinotta.
- 32. Paul këngëtar.
- 33. Janë pëshjtellat.
- 35. Inicialet e Moravia-s.
- 37. Pak makinacione.
- 38. Samuel bomber kamerunas.
- 40. Markë makine koreane.
- 41. Emte Kombëtare Durrës.
- 42. Fillojnë kurat.
- 43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
- 45. Ekstreme në liter.
- 46. Fillojnë lejen.


**HORIZONTAL**

- 1. Eshhtë babëzia.
- 8. Burton regjisor.
- 11. Skllavia e Abrahamit.
- 12. Një ditë në mbledhje.
- 14. Tyson i boksit.
- 15. Rrethojnë ringun.
- 17. Beson pa kufij.
- 19. Zola që shkroi Nana.
- 20. Eshhtë ankimim.
- 23. Pak elementare
- 24. Janë me para në bankë.
- 26. Matet pa kufij.
- 27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
- 28. Një zog i verdhë.
- 29. Inicialet e Moravia-s.
- 31. Oytet gjerman.
- 34. Një zonjë që ha gurë.
- 35. Pak analogji.
- 36. I ka plasur të paturpit.

**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**

- 1. Sateliti i Uranit.
- 6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
- 11. Tiran pa kufij
- 12. Në krye të armatës.
- 13. Një Ibrahim violinist.
- 14. Qendër ditore.
- 15. Mund të jenë fotografikë.
- 17. Inicialet e Einstein.
- 18. Një mbishkrim në kryq.
- 20. Janë si vite.
- 21. Thurman aktore.
- 22. Të parat në irritim.
- 23. I preu Seneka.
- 25. Fillojnë ilustrimet
- 26. Isaac Asimov.
- 27. Një Vladimir kompozitor.
- 28. Janë në modë.
- 30. Janë zyrtar... qeveritare
- 32. Me të nxjerrin trarë.
- 35. Një shklop, thupër.
- 37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
- 39. U thyen në Salamina.
- 40. Një raport shumë i ngushtë.
- 41. Nota e di-aponzit.
- 42. Fund heroi.
- 43. Një top në rrjetë.
- 45. Gjysma alarmi.
- 46. Herët pa zë.
- 47. Sampras i tenisit.
- 48. Me to bëjnë triko.



- 49. Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
- 50. Janë kokrrat e lisit.

**VERTIKAL**

- 1. I famshëm ai i Sizifit.
- 2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
- 3. Fillojnë rastësisht.
- 4. Një pjesë e napolitanëve.
- 5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
- 6. Mund të jenë kundërajtore.
- 7. Lindin në kokë.
- 8. Gjysmë shtegu.
- 9. Hidhen të parat.
- 10. Eshhtë njeriu i përsosur.
- 13. Një fjalë për tutje.
- 15. Fundi i një samurai.
- 16. Mbyllen me epilog.
- 17. Bel i maupassant.
- 19. Inicialet e Redford.
- 23. I manifeston nxënësi papërgatitur.
- 24. Në hyrje të tokës.
- 26. Pak impresioniste.
- 27. Janë metrat në sipërfaqe
- 29. Hapat një për ajër.
- 30. Gjysmë krenar.
- 31. Një hidrokarbur.
- 33. Vrau Hektorin.
- 34. Një film i rixhiruar.
- 36. Kupat pa kufij.
- 38. Inicialet e Nolte aktor.
- 41. Ullmann aktore.
- 43. Një brilantinë moderne

- 44. Hotel pa kufij.
- 46. Ekstremë në hall.

**HOROSKOPI**

**DASHI**

Përpunimi të gjeni kohë për veten tuaj dhe të qetësoheni, pasi keni kaluar disa vështirësi. Përfshirja në grup do të ishte shumë argëtuese, por nga ana tjetër, edhe e shtrëngët. Dikush që ju i besoni nuk do t'ju tregojë të vërtetën rreth një qëshijeje.

**DEMI**

Ka gjasa që të nervozoheni për shkak të disa problemeve. Bëni mirë të merrni disa pushime dhe të udhëtoni. Përgjegjësitë familjare do të mten, çfarë do t'ju shkaktojë tension. Përpunimi të mos stresoheni. Sa i përket anës ekonomike, sot do të fitoni mijafutshëm të ardhura.

**BINJAKET**

Sjellja juaj e mirë do të vlerësohet, tekrsa disa persona do ta vënë në dukje këtë. Bëni kujdes se me kë do të bashkëpunoni financiarisht. Disa ndryshime që mund të bëheni në pamje do të mërzisin familjarët tuaj. Sa i përket anës romantike, nuk do të jetë dita juaj me fat, pasi do të mërziteni nga fjalët e ashpër të partnerit/partneres suaj.

**GAFORJA**

Ka gjasa që të çliroheni nga një sëmundja prej së cilës vuani prej kohësh. Do ta keni të vështirë të shmangni disa persona që iu bëjnë të ndihni keq. Kalojeni kohën e lirë, duke shkuar diku me partnerin/partneren tuaj.

**LUANI**

Përpunimi ta shijoni më shumë jetën. Shmangia e shqetësimeve duhet të jetë hapi i parë për të arritur këtë. Mos bëni shpenzime të kota për disa gjëra, të cilat nuk janë të rëndësishme. Sot do të bëheni nostalgjikë dhe do të kaloni disa momente shumë të bukura me partnerin/partneren tuaj.

**VIRGJERESHA**

Miq të besnikë do t'ju bëjnë të lumtur. Do t'ju vijin ndërmenë ide të reja brilante, të cilat do t'ju sjellin të ardhura shumë të mira. Ka gjasa që sot të takoni dikë që do t'ju mbushë zemrën. Sa u përket çifteve të martuara, do të përjetoni një ditë shumë të pazakontë.

**PESHORJA**

Sot bëni kujdes me shëndetin! Eshhtë dita perfekte për të blerë disa sende, të cilave do t'u rritet vlera me kalimin e kohës. Zënkua me një fqinj do t'ju prishë humorin, megjithatë mos e humb qetësinë, sepse kjo mund ta përkeqësojë edhe më tej situatën.

**AKREPI**

Shqetësimet dhe stresi i tepët mund t'ju shkatërojnë shëndetin. Duhet të shmangni konfuzionin dhe irritimin, pasi kjo mund të ndikojë edhe në shëndetin mendor. Ka gjasa të zhgënjeheni, pasi do të zbuloni që një person që ju i besoni shumë, nuk është aq i sinqerë sa duket.

**SHIGJETARI**

Duhet të bëni sa më shumë ushtrime fizike. Shmangni ushqimet e ndyrshme dhe pikante. Qëndroni larg thashethemeve. Çiftet e martuara do të përjetojnë një situatë mjaft të vështirë. Sot do t'ju telefonojë dikush, të cilin e prisni prej kohësh.

**BRICJAPI**

Elasticiteti dhe guximi do t'ju bëjnë të ndiheni shumë mirë dhe do t'ju ndihmojë të përballeni me situata të ndryshme, sado të vështirë të jenë. Njëditë me të cilët jetoni nuk janë shumë të lumtur me ju, pavarësisht se përpunimi t'i kënaqni ata. Përpunimi të mos zbuloni informacione konfidenciale.


**UJORI**

Bëni kujdes kur të kaloni rrugën, pasi neglizhencia e dikujt mund t'ju dëmtojë. Sot ka gjasa të përdorni aftësitë tuaja të fshetrura për të dhënë më të mirën gjatë ditës. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat.


**PESHQIT**

Disa persona mund të mendojnë se jeni të vjetër për të mësuar diçka të re, por kjo nuk është aspak e vërtetë. Mendohuni gjatë para se të investoni dikur. Familjarët do të mërziten sot me ju për shkak të sjelljes suaj të paparashikueshme. Mos merrni vendime të rritura, për të cilat do të pendoheshi në të ardhmen.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

4				3	6				
9				7	4	2			
	6								8
		5			2				
		7		2		1			
8					5				
			1	9		3			
7	4					9	1		
1	8			6					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

9	6	3	1	2	5	7	4	8	
7	4	2	3	6	8	9	1	5	
5	8	1	4	7	9	2	3	6	
8	3	6	5	4	2	1	7	9	
1	9	5	7	3	6	8	2	4	
2	7	4	8	9	1	5	6	3	
3	1	9	6	5	7	4	8	2	
6	2	7	9	8	4	3	5	1	
4	5	8	2	1	3	6	9	7	

**KRIPTOSKEME**

12	S	A	15	F	O	14	4	14	7	4	15
4	11	4		1	8	12	2	3	14	5	10
10		1		4	1	2	8	10	6	4	7
4	7		1	7	5	8	9	4	2	10	4
15	3	1		6	2	10	5	2	6		12
7	1	11	13	5		1	5		17	15	1
17	3	10	13	3		4	4	4	10	6	3
4		2	4	7		11		6	10	4	2
12	1	5	16	4	10	5		4	4		8
14	4	7	4		8	14	5		17	3	10
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	5
2	4	2	5		4	1	2	8	10	6	2

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

S	A	F	O	M	A	M	L	A	F
A	N	A	K	O	S	T	U	M	E
R	K	A	K	T	O	R	I	A	L
A	L	K	L	E	O	P	A	T	R
F	U	K	I	T	R	E	T	I	S
B	U	R	G	E	K	I	B	F	K
B	U	R	G	U	A	A	R	I	U
A	T	A	L	N	U	R	A	T	A
S	K	E	D	A	R	E	A	A	O
M	I	L	A	O	M	E	B	U	R
A	N	A	L	I	T	I	K	E	L
T	A	T	E	A	K	T	O	R	I

**Thënie të mënçura**

- - Misteri i jetës nuk është një problem për t'u zgjidhur, por një realitet që ne duhet të përjetojmë.
- - Një optimist sheh një mundësi në çdo fatkeqësi. Një pesimist sheh një fatkeqësi në çdo mundësi.

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.  
8. Burton regjisor.  
11. Skllavia e Abrahamit.  
12. Një ditë në mbledhje.  
14. Tyson i boksit.  
15. Rrethojnë ringun.  
17. Beson pa kufij.  
19. Zola që shkroi Nana.  
20. Eshhtë ankimim.  
23. Pak elementare  
24. Janë me para në bankë.  
26. Matet pa kufij.  
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.  
28. Një zog i verdhë.  
29. Inicialet e Moravia-s.  
31. Oytet gjerman.  
34. Një zonjë që ha gurë.  
35. Pak analogji.  
36. I ka plasur të paturpit.

**FJALËKRYQI (2)**

HORIZONTAL

1. Sateliti i Uranit.  
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.  
11. Tiran pa kufij  
12. Në krye të armatës.  
13. Një Ibrahim violinist.  
14. Qendër ditore.  
15. Mund të jenë fotografikë.  
17. Inicialet e Einstein.  
18. Një mbishkrim në kryq.  
20. Janë si vite.  
21. Thurman aktore.  
22. Të parat në irritim.  
23. I preu Seneka.  
25. Fillojnë ilustrimet  
26. Isaac Asimov.  
27. Një Vladimir kompozitor.  
28. Janë në modë.  
30. Janë zyrtar... qeveritare  
32. Me të nxjerrin trarë.  
35. Një shklop, thupër.  
37. Eshhtë Shqipëria e madhe.  
39. U thyen në Salamina.  
40. Një raport shumë i ngushtë.  
41. Nota e di-aponzit.  
42. Fund heroi.  
43. Një top në rrjetë.  
45. Gjysma alarmi.  
46. Herët pa zë.  
47. Sampras i tenisit.  
48. Me to bëjnë triko.

VERTIKAL

1. Kanë shpatë të tilla.  
2. Janë edhe ato polare.  
3. Janë zoriçet.  
4. Janë male në Rusi të tilla  
5. Eshhtë nusja me vello.  
6. Një rreth pa ekstreme.  
8. Në kryt të titujve  
9. Diku në qendër.  
10. Markë cigaresh.  
13. Janë rëfimet e të pandehurit.  
14. Janë penjtë për gjergjef.  
16. Mbarojnë fare.  
18. Janë shtitë e... provimëve.  
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.  
21. Vitet pa kufij.  
22. Një fjalë për tutje.  
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.  
25. Eshhtë e akuzuara... injorante  
26. Baldwin  
27. Një pjesë e kandidatëve.  
28. Krenar pa çift.  
30. Grazia Cucinotta.  
32. Paul këngëtar.  
33. Janë pëshjtellat.  
35. Inicialet e Moravia-s.  
37. Pak makinacione.  
38. Samuel bomber kamerunas.  
40. Markë makine koreane.  
41. Emte Kombëtare Durrës.  
42. Fillojnë kurat.  
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.  
45. Ekstreme në liter.  
46. Fillojnë lejen.

